

Gusht 2022
Numri: 173
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ARTI I TË JETUARIT



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



ARTI I TË JETUARIT SI MYSLIMAN

— Mehmet Lutfi Arslan —

Një nga cilësitë më dalluese të të qenët njeri është të bësh pyetje. Bërja e pyetjeve na ndan nga krijesat e tjera, ndërsa bërja e pyetjes së duhur na ndan nga njerëzit. Me vetëdijen lind pyetja e parë dhe, kush i shkon pas kësaj pyetjeje? Nuk është e mundur që të gjithë të rendin pas pyetjes. Përse na është dhënë një trup, mendje dhe zemër që askush tjetër nuk i ka? Është e vështirë të përballemi me këtë pyetje, sepse vetëm Zoti (xh.xh.), mund ta dijë se çfarë synon për ne. Ja pra, jeta është një udhëtim për të zbuluar atë që Zoti di dhe dëshiron prej nesh. Të vish në jetë është të shkosh patjetër në këtë udhëtim.

Udhëtimi i zbulimit është rraskapitës. Devijuesit vijnë gjatë rrugës. Ne nuk jemi të mbrojtur as nga vetja jonë. Brenda nesh është një armik. Ai përpiqet të na kthejë nga rruga dhe është vazhdimisht në pritë. Adhurimi është përcaktimi i hartës së rrugës që na çon tek ajo që kërkon Zoti prej nesh në këtë rrugëtim të vështirë. Kjo hartë është po aq origjinale sa vetë njeriu, po aq unike sa ai vetë. Fundi i rrugës mund të jetë një dëshmi e ndritur që mahnit shikuesin dhe të gjithë ata që do të marrin ndihmë për hartën e tyre. Po ashtu mund të jetë edhe një errësirë e mjegullt që e çon shikuesin në errësirë dhe në gropa të pa fundme...

Adhurimi është përcaktimi i hartës së përgjegjësisë. Komentet që bien në kanavacën e jetës nga duart, gjuha, sytë, mendjet dhe zemrat tona tregojnë se ku arrijmë dhe e gjejmë veten. Në këtë aspekt, adhurimi është një veprimtari ndërtimore dhe aftësia për të bashkuar të afërmin me të largëtin, siç nënkuptohet nga fjala hyjnore «Sa rob i mirë që ishte». Secili duhet të paraqesë punën e tij më të mirë me atë që ka, të bëjë interpretimin e tij dhe më pas të japë një llogari për pikturën, penelin, bojën dhe kanavacën. Ata që e japin mirë këtë llogari janë artistët e artit të të jetuarit si mysliman.

Arti i të jetuarit si mysliman është emri i të jetuarit në pozitën e pëlqimit duke gjetur punën, sti-

lin, metodën dhe mjedisin më të dobishëm. Vetëm zemra, e cila ka fituar cilësinë e pastërtisë, mund ta kryejë me sukses këtë detyrë të ekuilibrit, e cila kërkon t'i japësh hakun gjithçkaje në këtë jetë. Zemra “selim” është zemra që e njeh Allahun, e njeh dhe e zbaton fenë, e shijon atë që e zbaton, e bën atë shije të dominojë çdo pjesë të trupit të tij dhe vazhdon në këtë gjendje me durim. Poseduesi i kësaj zemre është një fatlum i cili ia ka dalë mbanë për ta bërë markë të tij Kuranin dhe Sunetin, të cilët janë udhërrëfyes të natyrshmërisë njerëzore.

Arti i të jetuarit si mysliman është një trajnim i vetëdijes se pse merr frymë. Kjo kërkon një proces edukimi. Kjo është arsyeja pse kanë ekzistuar hallkat e edukimit që kanë rrjedhur që nga koha e të Nderuarit tonë, i cili është mëshirë për botët. Aspirimi për një edukim të tillë nën mbikëqyrjen



e një edukuesi, e kthen menjëherë në një shkollë vendin në të cilin ndodheni. Mësimet e nxënies, admirimit dhe frikës së marrë prej andej, kthehen në gdhendje të ecurisë së zemrës drejt Mikut më të Lartë. Kombinimi i mrekullueshëm i perceptimit, kënaqësisë dhe zbulesës e bën poseduesin e atyre gdhendjeve një mishërim të artit të të jetuarit në mënyrë myslimane.

Arti i të jetuarit si mysliman është të fitosh meritë për dëshmi. Zoti (xh.xh.), na ka bërë një bashkësi mesatare që të mund të jemi dëshmitarë për njerëzit e tjerë. Edhe Pejgamberi, alejhi's-salam, është dëshmitar për ne. (Shik. Bekare, 143) Jetët she-mbullore të jetuara me dëshminë e Profetit (a.s.), janë argument edhe e dëshmisë për Zotin, edhe e dëshmisë së Zotit. Dëshmitarët e adhurimit janë njerëzit, kurse dëshmitarët e njerëzve janë robërit. Të jesh rob është dëshmia më e madhe, kurse të kujtohesh me një dëshmi të tillë është lumturia më e madhe.

Arti i të jetuarit si mysliman është një gjendje e vetëdijes që del nga bashkimi i mendjes dhe zemrës. Vetëdija fillon me njohjen. Ajeti: **“Dije se nuk ka zot tjetër përveç Allahut.”** (Muhamed, 19), e lidh edhe shtyllën më themelore, tevhidin, me diturinë duke thënë «fa'lem/dije». Të dish nuk do të thotë vetëm të dallosh mes të dobishmes dhe të dëmshmes, por edhe të zgjedhësh atë më të dobishmen midis dy të dobishmeve. Truku është të mbledhësh atë që i përshtatet disponimit tënd në një mënyrë të bukur dhe të lehtë. Edhe pse personi që del nga ky edukim është po aq i veçantë sa ai vetë, në thelb ka disa preferenca që mund t'i emërtojmë si parime të artit të të jetuarit si mysliman:

1. Zgjedhja e parë është të kurorëzoni privilegjin e individualitetit me bekimin e drejtësisë. Zemra e pastër gjen paqe vetëm mes atyre që janë si vetja. Vetmia është vetëm për Allahun (xh.xh.). Mund të jetë e lehtë të gjesh të vërtetën, por është e vështirë të qëndrosh i vërtetë, të jetosh drejt dhe të jesh i vërtetë. Kjo është e mundur vetëm me shoqërinë e atyre që e kanë kthyer drejtësinë dhe durimin në një mënyrë jetese. Për këtë arsye është urdhëruar që së bashku me takvanë (devotshmërinë) të jemi bashkë me të sinqertët (Shik. Teube, 119). I mençuri e di vendin e tij, cakun e tij dhe kufirin e tij në këtë botë. Ai i jep përparësi të qenët me njerëzit e duhur, sepse dëshiron ta kalojë kohën e tij në punën e duhur dhe në mënyrën e duhur. Shenja e të mençurit është qëndrimi i tij në anën e të mençurve.

2. Zgjedhja e dytë është të kërkosh detyrën para së drejtës. Në një kohë kur të gjithë janë të shqetësuar për të drejtat e tyre, vënia e detyrës në vend të parë është një nga gjërat më korrekte për të bërë në këtë botë ku kemi ardhur pa e merituar. Gjithçka që kemi këtu është e dhuruar. Ardhja është një bekim, jeta është një bekim, Islami është një bekim, të qenët umet i Njeriut më të mirë është një bekim. Bekim pas bekimi të cilët nuk mund të numërohen. Ai që kërkon detyrën e tij, jo të drejtën e tij, herët apo vonë do ta marrë të drejtë e tij dhe do të udhëzohet në një rrugë ku do ta gjejë këtë të drejtë.

3. Zgjedhja e tretë është të mos vonoheni për të rendur pas caktimit dhe kësmetit tuaj. Pëlqimi për atë që jepet është thelbësor, por nga ana tjetër nuk duhet ngurruar të bëjmë përpjekje për të rritur përfitimin. Ngurrimi është dobësi, kurse përpjekja për të ecur përpara është forcë: “Besimtari i fortë është më i dashur dhe më i mirë tek Allahu se besimtari i dobët. Në fakt, te të dy ka mirësi. Përpiqu për atë që është e dobishme për ty. Kërko ndihmë nga Allahu dhe mos u trego i dobët. Nëse të ndodh ndonjë fatkeqësi, mos thuaj: “Po ta kisha bërë këtë, nuk do të më ndodhte kjo!” Por thuaj: “Allahu e ka caktuar. Çfarëdo që Ai dëshiron, do të bëhet realitet!” Sepse fjala “nëse” i hap derën punës së shejtanit.” (Shik. Muslimi, Kader, 34.)

4. Zgjedhja e katërt është ta bësh falënderimin ndaj Zotit një linjë bazë të karakterit. Falënderimi më i madh është të qenët i kënaqur më atë që të është dhënë. Vetëdija për mirësinë është falënderim. Mirësia më e madhe është jeta e dhënë bashkë me Islamin. Të duash një jetë të tillë është të duash Allahun (xh.sh.). Të rilindësh me çdo diell që lind do të thotë të jesh i kënaqur me atë që Ai dëshiron. A ka falënderim më të mirë sesa të perceptosh ekzistencën, të ndjesh kënaqësinë e frymëmarrjes thellë deri në palcë dhe të jesh mirënjohës ndaj Atij që e ka dhënë atë?

5. Zgjedhja e pestë është t'i shtosh entuziazmin mirënjohjes ndaj Zotit. Jeta është një ecje. Vitaliteti është thelbësor në këtë ecje. Ecja nuk është as pompoze, as me shtirje, por është me emocion dhe entuziazëm. Entuziazmi është një shkëlqim lavdërimi dhe mirënjohjeje ndaj Zotit që reflektohet nga çdo qelizë prej nesh. Përtej ecjes pa u lodhur në rrugën e jetës; sa bukur është të jesh përfaqësuesi konkret i së bukurës, së mirës dhe së vërtetës, të ndjesh gjatë gjithë kohës ngazëllimin e kësaj, të shikosh në horizont me botëkuptimin “gjithmonë ri-

lindemi, kush lodhet prej nesh"! Meqenëse drejtimi është për në shtëpinë e paqes (xhenet), meqenëse shkuarja është në përjetësi, atëherë në këtë ecje entuziazmi është thelbësor.

6. Zgjedhja e gjashtë është të jesh aspirues i mirënjohjes dhe entuziazmit. Kjo do të thotë të jetosh me përpjekjet për të përfituar dhe për t'ua mundësuar edhe të tjerëve të përfitojnë. Është e nevojshme ta shtojmë jetën me të cilën jemi të kënaqur. Meqenëse jeta është kapitali ynë i vetëm nga i cili mund të përfitojmë, nuk mjafton ta mbrojmë atë dhe të shqetësohemi për të, por duhet ta shtojmë. Përgjigja më e mirë ndaj atyre që përpiqen ta minojnë atë, duke na zhgënjyer në këtë mënyrë, është një përpjekje për t'i shumëfishuar jetët e markuara me mirënjohje dhe entuziazëm. Veprat e mira që bëhen me vetëdijen e ihsanit e ndihmojnë këtë. Ihsan do të thotë ta bësh veprën për Allahun sikur e sheh Allahun dhe në një cilësi të denjë për Allahun. Allahu i bekon veprat e bëra me konsistencën e dashamirësisë (ihsanit). Ajo vepër bëhet vepër e përhershme. Vepra e përhershme është të rritë njerëz të markës së vet, duke shumëfishuar fjalën, kuptimin dhe sekretin e saj.

7. Zgjedhja e shtatë është ta jetosh jetën në bosh-tin e pëlqimit. Arti i të jetuarit si mysliman është

një përpjekje për të qenë i kënaqur nga Zoti dhe për të kënaqur Zotin (xh.xh.). Kënaqësia e Allahut është detyra më e rëndësishme. (Shik. Teube, 72.) Kënaqësia e Tij është e fshehur në mirësinë e Tij. Mirësia më e madhe është Islami. Të jesh i kënaqur me Islamin është të jesh i kënaqur me Të. Të jesh i kënaqur me Të është kushti i parë për të arritur pëlqimin e Tij.

Pastaj vijnë njerëzit. Edhe pëlqimi i tyre është gjithashtu i rëndësishëm. Arti i të jetuarit si mysliman kërkon vlerësimin e pëlqimit të njerëzve. Vlera është si në aspektin e të qenët të njëjtë në krijim ashtu edhe në dëshminë e tyre. Ne jemi dëshmitarë të tyre, por më e rëndësishmja është se ata janë dëshmitarë për ne. Ne i shohim mirë dhe përpiqemi që ata të na shohin të mirë, sepse dëshmia do të jetë një gjykim për njëri-tjetrin me vulën "absolute".

Pëlqimi ynë gjithashtu është i rëndësishëm. Adresuesi i thirrjes "O shpirt që ke arritur prehjen", është jo vetëm ai që ka kënaqur Zotin, por edhe ai shpirt i kënaqur prej Tij. Kënaqësia e njeriut është të bindë zemrën e tij. Me sinqeritet, dashuri dhe entuziazëm duhet të dëshirojmë edhe atë që na dërgoi në botë me vullnetin e Tij. Kushti i parë për këtë është që çdo mëngjes të fillohet jeta me këshillën e Profetit: "Jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si Profet." Zemra nuk i dëgjon urdhrat, por e dëgjon Krijuesin e saj. Nëse jemi të kënaqur me Të, Ai do të na mundësojë të bëjmë një jetë me të cilën do të jemi të kënaqur me Të.

Më në fund, edhe krijesat duhet të jenë të kënaqura me ne. Kafshët, bimët, sendet e pajetë, me pak fjalë, gjithçka duhet të përfitojë nga ekzistenca jonë, të paktën të mos lëndohen nga ne. Një njeri që jeton në një horizont të tillë pëlqimi, është një burim bollëku dhe frymëzimi për mjedisin dhe kohën e tij. Të gjithë ata që merren me të janë të lumtur. Ai është shpërblyer me shërbimin në rrugën e pastër dhe të ndritur të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.

Zoti na e mundësoftë të gjithëve të gjejmë linjat tona të veçanta në artin e të jetuarit si mysliman. Kudo që të kthehemi, dera hapet që andej. Atyre që u djeg zemra për këtë lutje, duhet ta ndiejnë gjithashtu shpresën se do ta arrijnë një pozitë të tillë. Shprehja: "Sa rob i mirë që ishte!", është një qëllim ëndërr që shkëlqen në horizontin e shpirtit tonë me këtë shpresë. Zoti ynë bujar, me adhurimin e të Cilit jemi nderuar, na e mundësoftë ta arrijmë!



JA LATIF!..

- Xhel-le Xhelaluhu -



— Dr. Adem Ergyl —

Shprehja me një fjalë e butësisë, finesës dhe mirësjelljes është sjellja prej zotërie. Kjo sjellje është veshja e personalitetit. Me fjalë të tjera, është zbulimi dhe stolia e personalitetit tonë. Megjithatë, kjo nuk është një rrobë që vishet nga jashtë dhe që mund të hiqet herë pas here, por një shenjë perfeksioni (pjekurie) që del nga brenda jashtë. Në infrastrukturën (bazën) e këtyre mirësive gjendet sinqeriteti, largpamësia, vizioni, dituria dhe urtësia. Me fjalë të tjera, sjellja prej zotërie është pamja e jashtme e shndërrimit të mendjes së shëndoshë, zemrës së shëndoshë dhe shijes së mirë në fjalë, sjellje, qëndrime dhe moral. Pjesa e secilit nga një sjellje e tillë prej zotërie është e ndryshme në raport me aftësinë, edukimin dhe bindjen e tij.

Një emër tjetër i Zotit është «el-Latif» -xhel-le xhelaluh-. Dijetarët tanë tërheqin vëmendjen për kuptimet e tij të thella dhe të gjera. Si përmbledhje, ky emër është hyjnor dhe ka kuptimin si «Të shohësh dhe të dish gjithçka që është delikate, e përpiktë dhe e fshehtë, dhe me këtë njohuri t'i plotësosh fshehurazi nevojat e pafundme të të gjitha qenieve, për të cilat ato as nuk janë të vetëdijshme, por në mënyrën më të bukur me hirin, dhembshurinë dhe bujarinë e Tij.

Çfarë fatmirësie e madhe është të jemi robër të hijshëm, të devotshëm dhe të sjellshëm në tokë të Zotit tonë, i Cili është «el-Latif», sepse, siç shprehen të urtët tanë, qëndrueshmëria e adhurimit tonë është në përpjesëtim me faktin sesa mund të dëshmojmë shfaqjen e emrave të Tij hyjnorë mbi ne në mënyrën më të bukur.


Po, Ai siç është «el-Latif», është edhe «el-Bedi» -xhel-le xhelaluhu- i Cili e krijon gjithçka në mënyrën më të bukur dhe unike. Ai gjithashtu e krijoi

njeriun në formën më të bukur dhe kërkoi prej tij që t'i bëjë veprat e tij në formën më të bukur. Robi besimtar duhet të paraqesë një personalitet të matur, të hijshëm dhe të sjellshëm, i cili gjithmonë kërkon më të mirën në fjalët, veprat, moralin e tij dhe veçanërisht në stilin e thirrjes drejt Allahut. Njerëzit që ngrihen kundër të tjerëve me cilësi të tilla si vrazhdësia, çorganizimi, vulgariteti dhe ashpërsia e panevojshme, nuk mund të përfshihen në klasën e robërve të veçantë të lavdëruar nga Rrahmani (i Gjithëmëshirshmi).

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, gjithashtu ka dashur që sahabët dhe umeti i tij të piqen në vatrën e dëlirjes dhe edukimit, të zbukurohen me stolinë e mirësjelljes, butësisë dhe hijeshisë dhe pothuajse të vihen re në mesin e njerëzve me këto aspekte. Një herë ai u tha shokëve të tij para një udhëtimi:

“Tani do të shkoni te vëllezërit tuaj. Vishni rrobat tuaja të bukura. Kujdesuni mirë për kafshët tuaja. Le të keni një pamje që bie në sy mes njerëzve, si një «nishan» i bukur në një fytyrë të bukur. Allahu nuk i pëlqen fjalët dhe sjelljet e shëmtuara dhe pamjen e pakëndshme.” (Ebu Davud, IV, 57, Hadithi nr: 4089.)

Nuk mund të thuhet se bota e brendshme e njerëzve që e kanë bërë çrregullimin profesion edhe pse kanë mundësi dhe që nuk i rregullojnë shtëpinë ku jetojnë, orënditë që përdorin, zyrën në të cilën punojnë, makinën me të cilën lëvizin duke i mbajtur ato të pastra, të rregullta dhe me gusto, janë gjithashtu të pastra dhe paqësore. Po, nuk është e drejtë ta bëjmë pasion synimin e kallëpit dhe formës, të cilin mund ta përshkruajmë si admirim të pamjes së jashtme. Por ngaqë jemi robër të Allahut dhe



i përkasim umetit të të Dashurit të Allahut, kemi përgjegjësinë për të qenë ashtu siç kërkojnë mirësjellja, hijeshia dhe edukata në mjedisin ku jetojmë si domosdoshmëri e vlerave tona me në qendër besimin, e pozitës sonë sociale dhe e cilësisë sonë e të qenët një krijesë e nderuar.

Thënia e Zotit (xh.xh.): «**Nëse përshëndeteni me përshëndetje, përgjigjuni në një (mënyrë) më të mirë ose përgjigjuni me të njëjtën.**» (Nisa, 86), është njëra nga shenjat që tregojnë se Zoti gjithmonë i inkurajon robërit e tij të jenë më të lartë në mirësjellje dhe delikatesë.

Fakti që në Kuranin Fisnik na përcillet metoda e mirësjelljes së Ibrahimit, alejhi's-selam, i cili i thoshte babait të tij mohues kur i fliste: “Baba i dashur, baba i dashur!” (Shik. Merjem, 41-47), si dhe përcjellja e dashurisë dhe mëshirës së Lukmanit, alejhi's-selam, kur i dha këshilla djalit të tij duke i thënë: «Bir i dashur!» (Lukman, 13), duhet të jetë një shenjë e delikatesës dhe ndjeshmërisë që nevojitet të posedohet nga besimtarët.

Në këto paralajmërime të Zotit tonë, i cili tërheq vëmendjen se si duhet të ecin besimtarët¹, mënyrën e të folurit² që duhet t'i kushtojnë vëmendje kur flasin me bashkëbiseduesit e tyre, fjalët që duhet të zgjedhin³ madje edhe tonet e zërit të tyre⁴, mund të shihet se çfarë dimensionesh përfshin vullneti i Zotit tonë në lidhje me mirësjelljen që Ai dëshiron të shohë te robërit e Tij.

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, i cili nuk e pëlqeu gjendjen e një njeriu me flokë dhe mjekër të çrregullt, ka thënë: “*Ai që ka flokë, le t'i nderojë ato.*”⁵, domethënë, le t'i mbajë të pastër, t'i krehë dhe t'i mbajë bukur, sigurisht që nuk ka synuar një umet të dobët, por një umet të nderuar që i kushton kujdes rregullit, rendit, harmonisë dhe shijes së mirë.

Sjellja prej zotërie është edhe një petk gjendjeje që ngjall dashuri, admirim dhe respekt në zemrën

e bashkëbiseduesit, edhe një armaturë që e mbron poseduesin e saj nga shumë sulme të ulëta. Një ngjarje tregohet si më poshtë:

Në periudhën e udhëheqjes së Sulltan Mahmudit II. ishte një njeri që quhej «Halet». Ai u gjend pranë shumë individëve të rangut të lartë që punonin si administratorë në nivelin shtetëror të periudhës, në mënyrë që të trajnohej. Karakteristika e tij më dalluese ishte smira dhe zilia. Ai nuk qe dot i dobi-shëm për asnjë nga menaxherët me të cilët punoi. Vetëm bashkëpunoi me grekët e Fenerit dhe ndante me ta sekretet e shtetit kundrejt përfitimeve. Ai u hidhte baltë të gjithë atyre që e pengonin të ngrihej në grada dhe pozita.

Ndonëse Osman Efendiu, i cili shërbeu si arkëtar në Perandorinë Osmane, shquhej për ndershmërinë dhe sinqeritetin e tij, ai nuk mundi të shpëtonte nga mllefi dhe zemërimi i këtij personi. Ndërsa personi në fjalë po pushonte në shtëpinë e tij një ditë, shërbëtorët e tij i thanë se kishte ardhur Osman Efendiu. Halet Efendiu, i cili u ngrit shpejt nga vendi ku ishte shtrirë, e përshëndeti në derë Osman Efendiu dhe e nderoi. Ai iu përgjigjet pyetjeve të tij me shumë kujdes dhe kur deshi të largohej, përsëri e përcolli deri te dera. Shërbëtorët e tij u habitën dhe e pyetën:

“Zotëri, na falni për kureshtjen. Ne e dimë që ky njeri nuk ju pëlqen aspak. Nëse do të kishit mundësi, do ta mbysnit në një lugë ujë. Në fakt, ju ia keni marrë gjithçka që kishte në dorë ky njeri. Pra, cila është arsyeja e këtij respekti që shfaqët ndaj Osman Efendiu?”

«Ju keni të drejtë. Ia kam marrë gjithçka, por nuk ia hoqa dot dinjitetin dhe sjelljen prej zotërie këtij njeriu. Nuk mund të mos ndihem i detyruar ta respektoj këtë njeri.”⁶

Me shpresën për të qenë robër që i japin një she-mbull të mirë në sjellje mjedisit ku jetojmë, me adhurimin, humanizmin, mirësinë dhe hijeshinë tonë, i lutemi Zotit të Plotfuqishëm që të na japë mendje të shëndoshë, zemër të shëndoshë dhe shije të mirë duke thënë «Ja Latif!»

1. Shik. Furkan, 63.

2. Shik. Isra, 53.

3. Shik. Bekare, 104.

4. Shik. Lukman, 19.

5. Ebu Davud, IV, 74, Hadithi nr: 4062.

6. Rasul Kesenzheli, Veliler ve Hükümdarlar - Evliatë dhe Udhëheqësit, fq. 345; Ibrahim Refik, Erdemler Kitabı - Libri i Virtyteve, fq. 66-67.

MJETET DHE QËLLIMET

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Njerëzit që përpiqen për t'i shërbyer Islamit dhe për t'u bërë myslimanë të devotshëm, gjithmonë e kanë tërhequr dashurinë dhe respektin e shoqërisë. Pas një kohe të shkurtër, të dashuruarit pas përshpirtjes i rrethojnë ata. Por sidoqoftë, një xhemat apo një lëvizje fetare, sado e madhe që të jetë, nuk është e pagabueshme. Për këtë arsye, çdo lëvizje apo xhemat fetar që del në pah, duhet të

bëjë kujdes në çështjen e rishikimit të metodave që përdor në ushtrimin e aktivitetit të vet.

Siç shprehet edhe imam Gazaliu, nganjëherë fillohet puna me nijet të mirë, por më vonë nijeti mund të prishet, ose në fillim mund të ketë nijet të keq, por më vonë nijeti mund të rregullohet. Një punë e filluar me nijet të pastër, nuk ka garanci se do shkojë mirë. Përgjatë gjithë historisë mistikët kanë shfaqur kujdes maksimal në lidhje me këtë çështje. Personat që largoheshin nga Kurani dhe Suneti, së pari janë kundërshtuar nga miqtë e tyre. Ndërmjet këtyre, Imam Rabbani zë një vend të veçantë, sepse ai nuk ka hezitur qoftë edhe një çast për t'i nxjerrë në pah gabimet e mistikëve dhe metodat e gabuara që ata kanë përdorur.

Njëri prej gabimeve që bëhet fjalë është shndërrimi në profesion i qasjes në “shikimin e bukurisë së Zotit në bukurinë e krijesave”. Disa mistikë, kalimin e njeriut nga metafora te e vërteta e kanë quajtur si “të arrish nga dashuria e Lejlës te dashuria e Zotit”. Shprehja: “Metafora është ura e së vërtetës”, është bërë mbështetja e mistikëve në këtë çështje. Imami e shpjegon kështu këtë çështje në letrën e gjashtëdhjetë e gjashtë të vëllimit të tretë të Mektubatit të tij:

“Ti duhet ta dish se metafora është hija e së vërtetës. Në hije gjendet një rrugë e madhe që shkon te e vërteta. Disa të mëdhenj e kanë thënë në këtë kuptim fjalën: “Ai që njeh veten, njeh edhe Zotin.” Sepse njohja e hijes e shpie njeriun te njohja e objektit që e formon hijen. Sepse hija ekziston në sajë të atij objekti. Andaj, e nxjerr në pah edhe objektin nga i cili formohet vetë.”

Sipas Imamit, rreziku këtu mund të jetë te fakti se mistikët nganjëherë qëndrojnë vetëm te metafora, domethënë, e lënë synimin dhe kapen pas mjetit. Kjo arrin deri në atë gradë saqë pasuesit të ndonjë lëvizjeje fetare i merren mendtë kundrejt bukurisë së metaforikes. Si rezultat, metaforikja ia pret rrugën që e çon te Zoti, në vend që ta shpinte tek Ai. Nisur nga frymëzimi që ka marrë prej hadithit, imami thotë se njeriu mund ta shohë diçka vetëm një herë. Nëse e shikon dy herë, kjo e çon atë në gabim metodologjik:

“Edhe kjo nuk duhet të harrohet se, ura e së vërtetës është shikimi i parë, siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut (a.s.): “Shikimi i parë është shikimi yt.” Ndërsa rreziku më i madh në këtë çështje –Allahu na ruajtë- është se, nëse besimtari kaplohet nga metaforikja, ndërkohë që shkon drejt së vërtetës dhe hedh shikimin e dytë, atëherë metaforikja, lëreni që s’bëhet urë për tek e vërteta, por bëhet një shejtan që e pengon në rrugën që e shpie tek ajo. Madje, kjo e thërret atë si një idhull për ta adhuruar dhe i kurdis kurthe për ta larguar nga rruga e vërtetë. Për këtë arsye, Lajmëtari më i Vërtetë, i cili është i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë për ta shpjeguar dëmin e shikimit të dytë: “Shikimi i dytë është kundër teje.” Çfarë gjëje mund të jetë më e dëmshme se ajo që e largon besimtarin nga Allahu i Lartësuar dhe e preokupon atë me gjëra të humbura?

Në komentimin e ajetit fisnik: “Thuaju besimtarëve që t’i ulin shikimet!”, i cili ka ardhur veçanërisht për besimtarët që janë të huaj për njëri-tjetrin, shprehet se çdo lloj shikimi apo lidhjeje që e pengon njeriun ndaj Allahut Teala është e ndaluar me këtë ajet. Për fat të keq, ana më interesante e kësaj pune është se disa mistikë injorantë e kanë kuptuar plotësisht ters këtë ajet dhe janë kapluar nga dëshira për ta vështruar bukurinë e Zotit te fytyrat e njerëzve. Por kjo, siç shprehet edhe në hadithin fisnik, është imoralitet i syrit dhe një vepër e ndaluar.

Disa mistikë të papjekur dhe të pamend, nuk kanë arritur dot ta kuptojnë thelbin e kësaj shprehjeje. Për këtë arsye, kanë gabuar dhe e kanë ngatërruar çështjen. Ndërkohë që dëshironin që kjo gjë të ishte mjet apo qëllim për të arritur te Zoti, u lidhën pas pamjeve të bukura dhe u mashtruan nga bukuritë e tyre. Këta injorantë pandehin se bukuria e formave është bukuria e Allahut Teala. Në këtë mënyrë, mendojnë se preokupimi me këto forma është i njëjtë me preokupimin ndaj Zotit dhe pandehin se shikimi i atyre formave është i njëjtë me shikimin e Zotit. Sipas Imamit, këto lloje mendimesh janë plotësisht të gabuara dhe jashtë kufijve të Ehli Sunetit.

Të pandehurit se bukuria e Allahut Teala është e njëjtë me bukurinë e krijesave të Tij, është mëkat i madh, sepse bukuria e Tij është mbi çdo lloj përfytyrimi. Imami përpigjet ta shpjegojë me gjendjen e Musait këtë çështje: “Djegia dhe copëtimi i malit Tur dhe të fikëtit që i ra Musait (a.s.), edhe pse ishte në pozitë të lartë, për shkak të një shfaqje të Allahut të Madhëruar, është e vërtetuar me Kuran. Ndërsa mistikët për të cilët po flasim, me mendjet e

tyre shterpa, pohojnë se Allahun e Lartësuar mund ta shikojnë gjithmonë dhe pa ndonjë pengesë të krijesat e Tij.

Allahu i Madhëruar është shumë larg shpifjeve që thonë këta të pacipë. Çfarë e pandeh Allahun Teala ky grup njerëzish të mangët? Si mund ta përfytyrojnë bukurinë e Zotit (xh.sh.)? A nuk e kanë dëgjuar ata se sikur të binte në këtë botë një fije floku e hyrive të xhenetit, të cilat janë prej krijesave të Allahut Teala, bota nuk do errësohej asnjëherë dhe nuk do kishte natë për shkak të rrezatimit dhe ndriçimit të asaj fijeje floku? Në këtë letër të tij, Imam Rabbani e ka hetuar deri në detaje njërin prej gabimeve në të cilat kanë rënë mistikët. Ai, në Mektubatin e tij, i ka kritikuar mistikët edhe për shumë gabime të tjera si ky dhe ka treguar të vërtetën e çështjes. Madje, ka kritikuar edhe mistikët që kanë marrë edukim mistik për vite të tëra. Si përfundim, nga çdo lloj lëvizjeje apo grupi fetar mund të dalin njerëz që i kuptojnë gabim hadithet dhe si rezultat përpigjen t’i arrijnë qëllimet e tyre me metoda të gabuara. Në një mjedis ku nëpërkëmben dispozitat e qarta të Kuranit dhe Sunetit, nuk është e lejuar që robi t’i bindet robtit.

Nisur nga kjo, çdo grup duhet t’i analizojë mendimet dhe veprimet e tij nën dritën e Kuranit, Sunetit dhe ixhmasë (konsensusit të dijetarëve). Veçanërisht në këto ditë të vështira që po përjetojmë, të gjithë individët, lëvizjet apo grupet islame duhet ta rishikojnë veten e tyre dhe të pendohen për metodat dhe veprat që janë larg shpirtit të Islamit, por që bëhen në emër të fesë, sigurisht nëse kanë bërë prej këtyre.

Të mos harrojmë se, përveç të Dërguarit të Allahut (a.s.), asnjë mistik, dijetar apo njeri i devotshëm nuk është i mbrojtur nga gabimi. Përgjatë historisë islame ka pasur shumë lëvizje me qëllime sublime, por që kanë devijuar më vonë. Sepse, për shejtanin është e rëndësishme të devijojë jo injorantët, të shkujdesurit dhe të devijuarit, por dijetarët dhe njerëzit e devotshëm. Metoda që shejtani përdor më shumë në këtë çështje është se ai i përzien qëllimet me mjetet dhe u prin grupeve ekstreme që të veprojnë me fanatizëm. Allahu Teala na mbajttë larg nga çdo lloj ekstremizmi dhe mos na ndaftë nga dijetarët e mëdhenj.

Shkrimin tonë le ta përfundojmë me lutjen e imamit: Paqja e Zotit qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin dhe që i mbahen fort rrugës së Muhamed Mustafasë (a.s.).



ÇËSHTJA BAZË NUK ËSHTË TË SHIKOSH, POR TË ECËSH PËRPARA

— Mehmet Emin Okur —

Ajo që i bën të mëdhenj ata që ndiqen nuk është ndjekja dhe turmat që grumbullojnë pas tyre, por fundi i rrugës drejt së cilës ata udhëheqin. Për të mos devijuar nga rruga, është e nevojshme të keni një niyet dhe ndërgjegjësim duke e kuptuar qëllimin e vërtetë ndërsa ndiqni ato gjurmë.

Ka një mësim metode që mund të merret nga të gjitha gjendjet, sjelljet, fjalët dhe veprimet e të mëdhenjve. Përderisa të njohurit e këtyre na bëjnë të vetëdijshëm, pasimi i tyre na mban në rrugën e takimit me Zotin (xh.xh.). Ndonjëherë ne shohim gishtat e atyre udhërrëfyesve, jo vendin që ata tre-

gojnë. Kjo mund të jetë një sprovë për ne, madje edhe përvetësimi i shenjës për veten tonë mund të jetë diçka e tillë. Për këtë arsye, qëllimi i kujtimeve të të mëdhenjve është që të shkojmë te qëllimi kryesor pa ngecur te vetvetja dhe te gishtat.

Duke qenë se ka një ndryshim midis shikimit dhe vështrimit, gjëja kryesore nuk është thjesht t'i shohim ata të mëdhenjtë, por të përfitojmë prej tyre dhe të ecim në mënyrën siç na tregojnë ata, domethënë të përparojmë. Çështja kryesore nuk është të shohësh, por të ecësh përpara.

Sigurisht, shumë njerëz mund të kenë hasur në manifestime të ndryshme individualisht ose në situata të veçanta, por ajo që do të shpjegohet dhe do të ndahet në përgjithësi është të zbulohen anët që kanë të bëjnë me umetin dhe rrugën, ashtu siç bëri Musa Efendi në librin e tij për Sami Efendiun.

Synimi ynë për të ndarë disa kujtime për Musa Efendiun është vetëm të zbulojmë atë që kemi parë, megjithëse nuk kemi nivelin e manifestimeve të veçanta, as kuptimin dhe vetëdijen për t'i kuptuar plotësisht shenjat.

* * *

Pasi e pyeti një të afërm: «A e di se cila është mirësia më e rëndësishme e njeriut, bir?», përsëri i tha vetë: «Është liria e tij.» Liria e vërtetë është t'i dorëzohesh poseduesit të vërtetë, duke zbërthyer çdo lidhje që do të parandalojë adhurimin. T'i afrosheshtij do të thotë të ngjitesh në shkallët e lirisë. Liria absolute nuk mund të kuptohet pa arritur tek Ai.

* * *

Ai u thoshte një emër të përshtatshëm për fëmijën atyre që i shkonin me dorëzim të plotë dhe e pyesnin duke i thënë: «Çfarë emri na urdhëroni?» Por atyre që i impononin zgjedhjen e tyre duke i thënë «A duhet të vendos këtë apo atë, zotëri?», u përgjigjej duke u kthyer nga nipi i tij i vogël që kishte pranë e duke i thënë atij: «Më thuaj një emër ti.»

* * *

Ai i tha njërit prej vëllezërve tanë, i cili erdhi për të marrë lutje me shumë hezitime para se të shkonte në Amerikë për master: «Mos i humb namazet dhe qëndro me myslimanët e devotshëm.» Jemi dëshmitarë se ky vëlla, i cili e zbatoi këtë si


në vendlindje, ashtu edhe gjatë gjithë jetës së tij kur u kthye, arriti një gradë që e rrethoi jetën e tij me shërbim dhe sinqeritet.

* * *

Ndërsa gjithçka kishte mbaruar në njëren prej dasmave dhe ai po largohej në mbrëmje, një mik i tij i tha: «Zotëri, ky mik është një nga shërbyesit më të mirë.», për dikë që shërbente menjëherë kur e shihnin të tjerët dhe që nuk bënte asgjë kur nuk e shihnin. Hoxha ia ktheu atij: «Epo! Shërbyesi i vërtetë do të dalë në pah në botën tjetër.»

Njerëzit rreth tij ndjenin një autoritet të tillë tek ai, saqë ai ndikim i rrethonte në mënyrë të pashmangshme. Ndonjëherë do të shihje se kjo atmosferë kishte një ndikim të madh te një mjek, infermier, polic, shitës apo një person i zakonshëm që nuk ishte takuar kurrë më parë me të, dhe ndonjëherë te një fëmijë i vogël trazovaç ose një maniak i keq që e ndryshonte papritur dhe i jepte atij një gjendje qetësie dhe prehjeje.

Jo vetëm te njerëzit, por mund ta shihnit dhe do ta ndjenit ndryshimin në çast me këtë efekt, madje edhe te macet e paturpshme, qentë e tërbuar dhe



zogjtë e zhurmshëm. Në kopshtin e rezidencës ku bëheshin përgatitjet para një dite dasme, era e fortë i shqetësonte të gjithë dhe çonte pluhurin nga toka, por sapo iu afrua atij, ajo u ndalua dhe ndryshoi drejtim. Unë isha dëshmitar i kësaj dhe i thashë shokut tim pranë meje i habitur, pa i bërë ndonjë shpjegim: «A e sheh atë që po shoh unë?» Miku, i cili ishte dëshmitar i kësaj mirësie hyjnore, më tha me habi: «Po, era ndalet sa herë që del përpara të nderuarit tonë.»

Kur filloi të ndodhte një gjendje ekstaze me ndikimin e ilahive të kënduara përgjatë një programi në Inegël ku merrnin pjesë me mijëra njerëz, ai e parandaloi përhapjen e kësaj gjendje duke urdhëruar që të recitohej një pjesë nga Kurani duke thënë: «Ilahitë të provokojnë, kurse Kurani Fisnik të qetëson.» Kjo panoramë ishte një shembull ku shihej qartë motoja “të ndikosh te vullneti, por të mos e bësh të dorëzohet”.

Vite më vonë, në një vizitë të veçantë, e kuptuam më mirë urtësinë kur dëgjuam fjalët e tij: “Pas dëgjimit të ilahive aq sa është e mjaftueshme, më mirë është ta ndërpresësh kur zemra të vihet në lëvizje.” Përjashtimi i vetëm nga kjo situatë ishte biseda fetare e lamtumirës në çatinë e konviktit të vjetër të ILAM-it. Ai nuk ndërhyri aspak kundrejt mijëra të dashurve të tij që nuk e kishin parë prej kohësh, të cilët fillimisht u emocionuan kur e panë, dhe më pas filluan të qanin me të madhe. Nuk e largoi aspak vështrimin e thellë dhe të mjegullt nga sytë e përplotur. Kështu dha lamtumirën në një mënyrë të pazakontë. Ishte një situatë e tillë sa që kur pasardhësi i tij u kthye nga xhaxhai pranë tij dhe i tha: «Ti duhet ta bësh përshëndetjen.», ai xhaxhai asket belbëzoi dhe tha: «Unë nuk mund të them as salam alejkum para këtij xhemati.” Kështu doli në pah se kush duhej të fliste në emër të kësaj rruge. Ceremonia e dorëzimit të një trashëgimie udhërrëfyese u përjetua në mënyrë kaq të natyrshme.

Disa nga të afërmve të tij ua përmendi emrat një nga një duke u shprehur: «Jam i kënaqur me filanin, edhe pse ka mangësi.» Në këtë mënyrë delikate jepte edhe përgëzimet, edhe mesazhet që përfshinin paralajmërime.

Nëse shqetësohej pa dashje përgjatë periudhës së sëmundjes, djemtë e tij shpirtëror që i shërbenin përveç të afërmve të familjes, i përgjigjeshin vetëm me një lëvizje të vetullës.

Edhe në kohët më të vështira, ai nuk bënte një paralajmërim ndaj bashkëbiseduesit që ky i fundit të ofendohej apo të mos e duronte dot.

Kishte një festë të mbushur me njerëz në Fondacionin Hydaji. Një grup fëmijësh që luanin në oborrin e shkollës, të cilët e panë, erdhën me vrap dhe u ulën përballë hoxhës. Pasi i nderuari i shikoi ata, e pyeti djalin e vetëm të ulur me një bluzë pa mëngë: «Kush je ti, biri im?» Një nga të mëdhenjtë që e kuptoi situatën, e qetësoi menjëherë duke i thënë: “Familja e tij nuk është e rregullt, zotëri.” Pastaj hoxha u shpreh: “Edhe fëmija i fëmijëve tanë është i yni dhe është nën kontrollin tonë.”

Edhe pse kishte mungesë të njerëzve pas grushtit të shtetit të 12 shtatorit, presidenti, kryeministri, të gjithë ministrat dhe zyrtarë të kohës morën pjesë në namazin e xhenazes që u mbajt në xhaminë Sahraji Xhedid, pas vdekjes së nipit të tij, i cili pati hyrë në politikë për shkak se ishte aktiv në sferën sociale. Namazi i vaktit u fal në xhami, pastaj shumë hoxhallarë e politikanë të njohur zunë vend në rreshtin e parë në oborr. Ndërsa po e prisnin atë, ai nuk doli nga xhamia dhe tha: “Ta falim këtu namazin e xhenazes.” Kështu nuk u dha mundësi keqdashësve që po mundoheshin të bënin një fotografi dhe ta përdornin.

Për një kohë, ai filloi të mbante karfica xhakete në formën e fjalës Allah dhe Hu, të cilat nuk i kishim parë më parë në jakat e rrobave të tij. Këto i vishte vetë dhe duke i shumuar, ua bënte dhuratë të dashurve të tij dhe kështu i bënte të përhapeshin. Pas pak kohe kur karficat e ndryshme të xhaketës që pasqyronin frymën e kohës u bënë modë si shenjë e pozicionimit në anën e shoqërisë dhe burokracisë, edhe ne e kuptuam shenjën e vërtetë.

Në dalje pas një bisede fetare të mbushur me njerëz në Gëztepe, ai kërkoi në mënyrë të pazakontë një takim për të vizituar një mik të vjetër që kishte një shtëpi afër dhe nuk ishte takuar për një kohë të gjatë dhe që kishte shërbyer në rugën tonë. Në përfundim të kësaj vizite, ai u ndal edhe një person tjetër, shtëpia e të cilit ndodhej në banesën ngjitur dhe që ndodhej thujse në të njëjtën situatë, duke thënë: “Të ndalemi edhe tek zoti filani.” Menjëherë pas kësaj morëm lajmin për vdekjen e atyre dy burrave të moshuar në intervale të shkurtra.

Gjurmët që ai përhapu dhe metodat që ai na mësoi bëhen më të dukshme në çdo ngjarje. Ato vazhdojnë t'i hapin rrugën umetit dhe pasuesve të tij si udhërrëfyese gjithnjë e më të fuqishme me kalimin e kohës. Zoti na bëftë t'i duam të dashurit e tij dhe na bashkoftë përsëri në audiencën e të dashurve të tij!

DUA TË BËHESH NJË PREJ TYRE

— Sadik Dana —

Ebu's-Suud bin Ebu'l-Ashairi këshilloi një mikun e tij:

“O vëlla! Allahu i Madhëruar të bëftë prej njësuesve të Tij, sepse ata nuk i bëjnë shirk Zotit.

Ata janë njerëz aq të pastër, saqë nuk njohin vësh-tirësi.

Ata janë njerëz aq të sinqertë, saqë e keqja nuk mund t'u afrohet. Ata e përkujtojnë Allahun gjithmonë, madje me shumë lehtësi.

Ata përshtaten me çdo lloj gjendjeje dhe nuk merren me gjëra të padobishme.

Ata nuk kanë dhembshuri ndaj nefsit. Dispozitat fetare gjithmonë kanë përparësi për ta.

Ata janë asketë, kështu që nuk i drejtohen askujt tjetër përveç Allahut Teala.

Ata nuk bëjnë zënka, por janë të kënaqur nga gjend-ja në të cilën ndodhen. Ata i mëshirojnë njerëzit dhe nuk janë të ashpër ndaj tyre.

Punët e tyre janë këshilla për njerëzit dhe jo shtir-je.

Turpërimi nga Allahu i Lartësuar është pothuajse e vetmja gjë me rëndësi për ta. Madhështia e Zotit (xh. xh.), është para syve të tyre.

O vëlla! Përsëri i lutem Allahut Teala që të të bëjë prej atyre të cilët i binden vazhdimisht Atij!

Ata i gëzon vetëm kënaqësia e Allahut të Madhëruar, jo ajo që i pëlqen nefsit.

Ata i janë dorëzuar shpirtërisht Allahut të Lartë-suar. Ata janë bërë të atillë që nuk kanë urrejtje dhe zemërim të pavend.

Gjithmonë ndjekin të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe zbatojnë çdo urdhër të Tij. Të gjithë sahabët e Pejgamberit (a.s.), i përkujtojnë me mëshirë, ndjejnë dashuri ndaj të afërmeve të Pejgamberit dhe i pranojnë virtytet e njerëzve të mëdhenj që kanë jetuar në të kaluarën.

Suu'dh-dhan, domethënë të menduarit keq për të tje-rët, është shumë larg tyre. Veçanërisht për besimtarët, domethënë, për ata që i besojnë Allahut, pejgamberë-ve, engjëjve, librave të Tij dhe Ditës së Gjykimit.

Ata nuk mendojnë keq për asnjë. Ata kanë vetëm dhembshuri dhe mëshirë.

Stolitë e kësaj bote nuk janë të rëndësishme për

ta. Për ta, më i forti i dynjasë, nuk është më i forti i vërtetë, më i pasuri, nuk është më i pasuri i vërtetë dhe sulltani nuk është sulltani i vërtetë.

Ata ndjejnë keqardhje ndaj atyre që përpiqen për të zhvatur ndonjë gjë nga kjo botë dhe ndaj atyre që gë-zohen pasi të zhvatin dhe të marrin. Shkaku është ky: e dinë se asnjë gjë e kësaj bote nuk është e përhershme dhe se herët apo vonë, do të ndodhë ndarja.

Ata i besojnë pjesës që është ndarë për ta dhe e dinë se ajo që është përcaktuar për ta do të vijë pa-tjetër. Veçanërisht, shqetësimi për këtë çështje është shumë larg tyre.

Ata nuk kanë frikë nga asnjë krijesë. Kanë përparuar aq shumë në moral, saqë nuk kanë asnjë cilësi të keqe. Vetën e tyre e kanë privuar nga kjo botë, duke e kundërshtuar në mënyrë të vazhdueshme.

Ata përpiqen që t'ua bëjnë të dashur Allahun ro-bërve të Tij, duke i bërë të vrapojnë në bindje ndaj Zotit, duke i bërë të pohojnë mirësitë që u janë dhënë, duke i bërë të kërkojnë falje për gabimet e tyre dhe veçanërisht duke i bërë të shërbejnë vazhdimisht për hir të Tij.

Ja pra vëlla, unë dua të bëhesh prej këtyre. Allahu Teala i ka bërë këta njerëz të tillë, që nuk i shtrijnë duart te pasuria e njerëzve. Duart dhe gjuha e tyre nuk u bëjnë dëm njerëzve.

Myslimanët jetojnë shumë lehtë me ta. Të keqes nuk i përgjigjen me të keqe, por falin. Ja pra, e gjithë shpre-sa dhe lutja ime është që ti të bëhesh njëri prej këtyre. Allahu ta mundësoftë këtë! Amin! Amin o Zot!”

Imam Sharani ka thënë:

“Të gjitha fjalët e miqve të Zotit përmbajnë moral të lartë, por fjalë kaq përmbledhëse nuk kam parë në asnjë vend. Edhe veprat e të Nderuarit Ahmed Rifaiut janë shumë të larta nga aspekti i moralit. Allahu Teala qoftë i kënaqur prej të dyve!..”

Le ta përfundojmë temën tonë me fjalët shumë të vlefshme të Hazretit Ebu's-Suud bin Ebu'l-Ashair, i cili ka thënë:

“Ji vetvetja, mos ji neglizhent ndaj Zotit (xh.xh.) dhe adhuroje Atë me të vërtetë!

Mos u bëj prej atyre të cilët merren me pamjet e jashtme të ibadetit dhe e harrojnë Zotin (xh.sh.), i cili është qëllimi në ibadet!

المصور
کتب علی تلمیسی بحکم الدین



ALLAHU ËSHTË I BUKUR DHE E DO TË BUKURËN

— Halit Serhan Erxhivelek —

Universi është krijuar në mënyrën më të bukur nga Allahu, i Cili është el-Bari, Ai që krijon gjithçka në formën më të mirë. Krijimi është në mënyrën më të bukur, si nga aspekti i formës, ashtu edhe nga aspekti i funksionit. Universi kuptohet me matematikë, por merr kuptim me estetikë. Sepse estetika është pasqyrimi i attributeve të Krijuesit në krijimin e universit. Si rezultat i këtij botëkuptimi, burimi i konceptit të estetikës në Islam është parë si nocioni se «Allahu është i bukur dhe krijon gjithçka në formën më të bukur». Ndërsa rregullat fizike shfaqin fuqinë e pafundme dhe të pallogaritshme në krijimin e krijuesit, shfaqja e emrave el-Bari, el-Musavvir dhe el-Latif dalin me konceptin e estetikës. Ky manifestim shpjegon edhe zgjedhjen e formës, pamjes dhe natyrës në krijimin e Allahut, sepse siç thuhet në hadithin fisnik: «*Allahu (xh.xh.), është i bukur dhe e do atë që është e bukur.*» Ky dimension i krijimit është si shpjegimi i hadithit Kudsij: «*Unë isha një thesar i fshehur, desha të njihesha dhe krijova botën.*» Krijimi është rezultat

i dashurisë dhe bukuria është shpjegimi i formës së krijimit. Konceptimi artistik i Islamit, i cili merr Allahun dhe ekzistencën absolute, me të gjitha konceptet dhe perceptimet e tyre si argument, është të bëjë të ndjehet sa më shumë Musavviri i vërtetë, i cili gjithmonë shfaqet me veprat e tij përtej sferës së ekzistencës.¹ Në këtë aspekt, arti islam dhe imagjinata estetike janë në një marrëdhënie të pandashme të vendosur me botëkuptimin islam të ekzistencës e njohurisë dhe besimin e tevhidit.²

Nuk ka absurditet në krijimin e Allahut (xh. xh.). Ajo që Allahu dëshiron nga njerëzit, të cilët i krijoi si mëkëmbës të Tij në tokë,³ është që të ndërtojnë qytetërimin, që është dimensionin më përmbledhës i marrëdhënieve mes njerëzve, në mënyrën më të bukur, dhe kështu të rindërtojnë

1. Turan Koç, *Islam Estetigi – Estetika Islame, Botimet Isam, Botimi i 7-të*, (Stamboll: 2017), 49.

2. *Vepra e lartpërmendur*, 50.

3. *Shik. Bekare*, 30.

dhe reformojnë botën. Feja, e cila përcakton se si do të jetë kjo veprimtari ripërtëritëse, e organizon jetën e kësaj bote me anë të dy koncepteve bazë si drejtësia dhe masa (kist) për të arritur lumturinë në ahiret, e cila është jeta kryesore.⁴

Sipas hadithit të Xhebrailit, feja synon një konsistencë shumëdimensionale të përftuar duke ndërtuar konceptet e besimit, islamit dhe ihsanit njëra mbi tjetrën. Besimi kërkon mendjen dhe të kuptuarit, Islami kërkon veprën dhe ihsani, i përshkruar nga Profeti (a.s.), si adhurim ndaj Allahut sikur e sheh Atë, kërkon një nivel të caktuar të vetëdijes në zemër.

Konsistenca e mirësisë në vepra dhe moral mund të arrihet duke konceptuar të fshehtën e ajetit *“Allahu është me ju kudo që të ndodhëni”*⁵, kurse konsistenca në mendje dhe ndjenjë mund të arrihet duke konceptuar sekretin e ajetit *“Allahu është më afër jush se damari i qafës.”*⁶ Ihsani mishërohet si nderim dhe përkushtim në adhurim, mirësjellje në trajtim, hir në sjellje, elokucencë në gjuhë dhe si rezultat, fisnikëri në shpirt. Robi i cili arrin konsistencën e mirësisë në veprat, gjendjen, moralin dhe zemrën e tij bëhet i devotshëm, si rrjedhojë, Allahu, i Cili është absolutisht i bukur dhe e do të bukurën, e do atë rob dhe i jep dashurinë e Tij atij robi, siç është dhënë përgëzimi në ajetin fisnik: *“Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun.”*⁷

Ata që e kanë arritur mirësinë në formën më të bukur në veprat, moralin dhe në të gjitha gjendjet e tyre janë evlijau-llahu (miqtë e Allahut), të cilët janë pasardhësit e vërtetë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). I Ndjeri Hoxhë Musa Topbashi, rahmetull-llahi alejh, i cili ishte një besimtar i denjë e i përsosur që akoma jeton në zemrat e të dashurve të tij edhe pse ka afër çerek shekulli që ka ndërruar jetë, ishte një besimtar i devotshëm dhe udhërrëfyes i përkryer që kishte arritur konsequencën e mirësisë në të gjitha veprat dhe gjendjet e tij. Ai i mësoi të dashurit e tij se si ta adhuronin Allahun, se si të ishin umet i Habiullahut (a.s.), se si t'i mbështesnin të varfrit, të vejat e jetimët në konsequencën e mirësisë duke i

bërë së pari personalisht vetë. Musa Efendiu u bë një monument mirësie duke i mësuar ata se si ta adhurojnë Allahun në mënyrën më të mirë, se si të hahet, se si të mbahet një gotë, se si të nuhatet një trëndafil, sesi të bëhet paketë një dhuratë dhe sesi t'u shërbehet maceve, qenve e pulëbardhave. Ky njeri i mirë, i cili e mishëroi si fisnikëri në të gjitha qelizat e trupit të tij konsequencën e mirësisë, ishte

KONCEPTIMI ARTISTIK
I ISLAMIT, I CILI MERR ALLAHUN
DHE EKZISTENCËN ABSOLUTE,
ME TË GJITHA KONCEPTET DHE
PERCEPTIMET E TYRE SI ARGUMENT,
ËSHTË TË BËJË TË NDJEHET
SA MË SHUMË MUSAVVIRI I VËRTETË,
I CILI GJITHMONË SHFAQET ME
VEPRAT E TIJ PËRTEJ SFERËS
SË EKZISTENCËS.

si një shembull i gjallë i mirësisë, hirit, paqes dhe mirësjelljes. Musa Efendiu, i cili arriti kulmin në të kuptuarit e tij se ai shihej nga Allahu në çdo moment, jetoi me përpjekjen për t'i kryer punët e tij në mënyrën «më të bukurë» që e meriton Ai që e shihte gjithmonë.

Dashuria për të bukurën tek Musa Efendiu nuk ishte një kërkim i thatë i së bukurës, por ishte rezultati i dëshirës për të qenë i denjë për Allahun (xh.xh.), i cili është i Bukuri absolut, për ta kënaqur Atë dhe për të arritur pëlqimin e Tij. Bukuritë që përjetoi dhe i bëri edhe të tjerët t'i përjetojnë e kishin bërë aq të bukur, sa që te ai ishte shfaqur urtësia e ajetit fisnik: *«Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun.»* Dhe siç shpreh vetë, kapitali i tij i vetëm në fund të jetës së tij ishte dashuria ndaj Allahut (xh.xh.). Musa Topbashi, i cili bëri një jetë të gjatë me një mirësi, hir, mirësjellje dhe fisnikëri të pamatshme, të formuar nga ndjeshmëria e sheriatit ndaj masës (matjes, ekuilibrit) dhe nga kërkimi i së bukurës që manifestohet nga dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ndante njerëzit jo ndryshe, por vetëm në ata që e arrijnë Allahun dhe ata që nuk e arrijnë dot Allahun. Duke shprehur magjepsjen e tij me bukurinë si shfaqje të dëshirës së tij për të arritur te Allahu, ka thënë: «Adhurimi të shpie në Xhenet dhe madhërimi në adhurim të shpie tek Allahu.» Me këto shprehje pothuajse i paralajmëronte të dashurit e tij duke ua bërë të qartë se mirësia, hiri, mirësjellja, ihsani dhe të gjitha sjelljet e tjera të ngjashme me këto janë vetëm mjete që i shërbejnë qëllimit të arritjes së Allahut (xh.sh.)

4. Ahmet Rejsuni, islam Hukuk Felsefesine Giris – Hyrje në filozofinë juridike islame, Botimet Pënar, Botimi i 1-rë. (Ankara, 2019) 21.

5. Hadid, 4.

6. Kaf, 16.

7. Maide, 54.



KU DO IKËSH?

— Ali Riza Temel —

Zoti e përshkruan gjendjen e njeriut që është shtangur nga tmerrri i kiametit: **“Atë ditë, njeriu do të thotë: Ku mund të ik? Jo, jo! Nuk ka ku të ikë e të fshihet. Atë ditë, vendi ku do të shkohet është vetëm audienca e Zotit.”** (Kijame, 10-12)

Herë pas here, ne e përjetojmë paraprakisht tmerrin dhe panikun e apokalipsit (kiametit) në këtë botë. Përballë një fatkeqësie gjithëpërfshirëse, kërkojmë një vend apo strehë për të shpëtuar, një strehë ku të vendosim kokën. I pasur-i varfër, i fortë-i dobët, drejtor-nëpunës, i ri-plak, të gjithë bien në dëshpërim.

Epidemia e fundit e virusit korona e solli këtë dëshpërim tek të gjithë në mbarë botën. Nuk mbeti vend për të ikur. Kur ka ndonjë fatkeqësi lokale, të pasurit ikin në vende më të sigurta dhe e vazhdojnë jetën atje falë pasurisë së tyre. Kështu që sigurohen nga rreziku. Por përballë kësaj epidemie nuk mbeti vend për të ikur askush. U pa qartë se paraja nuk mund të bënte asgjë. U kuptua se fuqia, pasuria dhe pushteti nuk kishin asnjë dobi.

Përveç marrjes së disa masave paraprake në planin njerëzor, nuk ka dyshim se mbrojtja dhe streha e vërtetë është Allahu (xh.xh.). Adresa e saktë është Ai. **“Atëherë vraponi drejt Allahut.”** (Dharijat, 50) Sa bukur ka thënë poeti arab:

“Bëj durim, nuk ka asgjë në këtë botë që është e përjetshme,

Askush nuk mund të të mbrojë nga caktimi i Allahut.”

Në botën tjetër kthimi është vetëm tek Ai, edhe në këtë botë lutja është vetëm për Të. Profeti (a.s.), i cili na mësoi njerëzimin dhe të vërtetat e përjetshme, gjithmonë i përgjerohej Atij në kohërat më të trazuar, duke thënë: «Nuk ka strehë dhe mbrojtje tjetër përveç Teje. Ta paraqes Ty dobësinë time.» Falë durimit të tij të madh dhe mbështetjes te Zoti realizoi revolucionin më të madh në botë. Strehimi tek Allahu e bën njeriun të fortë. Sepse strehohet te burimi i fuqisë dhe pushtetit.

Kjo epidemi e koronës që po përjetojmë pothuajse na ka bërë të përjetojmë skenën e apokalipsit: **“Atë ditë njeriu do të ikë nga vëllai, nëna, babai, gruaja dhe fëmijët. Atë ditë, secili do të ketë një problem që do të jetë i mjaftueshëm për veten e tij.”** (Abese, 34-37)

Sot edhe ne po ikim nga të afërmit tanë që të mos infektohem me virusin dhe nuk po e prekim dot fytyrën nga frika. Ky situatë pa rrugëzgjdhje na e tregoi vendin. E pamë sa të dobët dhe të pafuqishëm jemi ndërkohë që mendonim se ishim të fortë. Siç thuhet edhe në suren Humeze, dëshmuam se pa-

suria dhe paratë tona, të cilat i kemi grumbulluar dhe menduam se do të na bëjnë të pavdekshëm, nuk janë të dobishme. Pamë të pasurit dhe të varfrit, të fortët dhe të dobët, të binin në të njëjtin dëshpërim përballë një virusi.

Kuptuam që edhe gjërat më të çmuara dhe më të admirueshme kthehen në qeniet më të rrezikshme, sipas vendit të tyre. Nuk e përqafojmë dot fëmijën dhe i përshëndetëm nga larg nipat dhe mbesat. Nuk morëm dot pjesë në funeralin e babait tonë. Kështu, e pamë dhe përjetuam më nga afër dobësinë tonë.

E pamë duke e përjetuar se Faraoni dhe Nemruti ishin balona që shpërthyen me një gilpërë të vogël. Dëshmuam falimentimin e topave, pushkëve dhe raketave tona përballë një virusi të padukshëm.

Njerëzit nuk llogaritin se do të përballeshin me fatura të rënda për mëkatet dhe zullumet e tyre. Ata nuk e njihnin ligjin. Ata mendonin se te zgjahët e padrejtë që ngritën do të vazhdonin gjithmonë. Ata vepruan sipas parimit që të tjerët humbin gjithmonë, në mënyrë që ata të fitonin më shumë. Ndërsa ata duhej të mbanin dietë dhe të aplikonin kura për humbje peshe për shkak të ngrënies së tepërt, nuk mendonin për ata që vdiqën nga dhimbja (e urisë). Ata morën mallkimin e të shtypurve. U përballën me hakmarrjen e mjedisit që kishin ndotur dhe plaçkitur. U goditën nga zemërimi i kafshëve që vranë dhe bimët që i modifikuan gjenetikisht.

Me pak fjalë, kostoja e lakmisë ishte e rëndë. Kjo faturë nuk iu pre vetëm shtypësve. Ajo iu pre edhe atyre që nuk i thanë ndal persekutimit dhe

ata që nuk ndërhyjnë kundrejt të keqes edhe pse kishin fuqinë për ta parandaluar dhe ndërprejnë. **“Kini kujdes nga një fitne e tillë, e cila nuk prek vetëm zullumqarët mes jush** (por përhapet tek të gjithë). **Dijeni se dënimi i Allahut është i ashpër.”** (Enfal, 25)

Dënimet varen nga shkalla e gabimeve. Gabimet në rang botëror kërkojnë dënime në rang botëror. Në këtë rast, është e vështirë të shpëtosh nga ky dënim dhe ndonjëherë nuk është e mundur fare. Mirëpo, nëse njeriu pendohet dhe bëhet pishman me qëllim që të mos i përsërisë më të njëjtat gabime, atëherë shfaqet falja dhe mëshira hyjnore. Edhe Nuhu (a.s.), u dërgua si profet në një shoqëri të pamëshirshme. Ai i bëri thirrje nga më të ndryshme popullit dhe iu lut që të ndiqte rrugën e drejtë, por thirrja e tij nuk u bëri asnjë dobi vetëm sa e shtoi rebelimin e tij. Më në fund ata u mbytën në ujë. Djali i tij, i cili nuk hipi në anije, tha: “Unë do të strehohem në mal. Ai do të më mbrojë nga uji.» Nuhu (a.s.), i tha: **«Sot nuk ka njeri që do të shpëtojë nga dënimi i Allahut, përveç atyre që Allahu do t'i mbrojë.»** (Hud, 43) Biri i Nuhut dhe bijtë e tij të tjerë të cilët më vonë ranë në mëkat, nuk gjetën strehë për t'u mbrojtur. **“Gjendja e atyre që marrin për miq të tjerët përveç Allahut është si ajo e merimangës. Merimanga bën një fole. Megjithatë, foleja më e dobët është foleja e merimangës. Ah sikur ta dinin.”** (Ankebut, 41)

Adresa në të cilën mund të aplikojë besimtari në çastin e fundit është e qartë. **“Ata që bëjnë durim, kur u vijnë vështirësitë, thonë: “Ne jemi robër të Allahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi.”** (Bekare, 156) Ata e shohin vdekjen jo si zhdukje, por si derë të ekzistencës së përjetshme. Njeriu që e di se do të kthehet në shtëpi në mbrëmje është i lumtur. Ai që nuk ka ku të kthehet dhe nuk ka shtëpi është i mjerë.

Nëse ka një ikje të mirë, atëherë ajo është ikja nga mëkatet. Ata që ikin nga mëkatet kërkojnë një vend për të shpëtuar, sepse vendi i tyre i strehimit dihet.

Fatkeqësia epidemike e koronës në mbarë botën na mësoi shumë gjëra. Ne mësuam dobësinë tonë, pafuqinë tonë dhe kufijtë tanë. Kemi parë koston e gabimeve, rebelimeve, prishjes, shpërdorimit, kotësisë, egoizmit, pamëshirshmërisë dhe mizorisë. Kuptuam se nuk kishte rrugë tjetër veçse t'i drejtoheshim Allahut dhe urdhrave të tij shpëtues. Le ta përfundojmë fjalën kështu: “Të gjitha dyert janë të mbyllura, kurse dera e pendimit është e hapur.”



NA QUAJTI MYSLIMANË

— Ahmed Hamdi Jëlldërëm —

SOT, ISLAMI, I CILI NJIHET ME SHUMË FRAZA, ËSHTË NJË PËRSHKRIM I THJESHTË I ROBËRVE TË ZGJEDHUR TË ALLAHUT, LARG ÇDO LLOJ ATRIBUIMI DASHAKEQËS QË MUND T'I BËHET. AJETI FISNIK E THOTË QARTË KËTË: "... AI (ALLAHU) JU KA QUAJTUR "MYSLIMANË..." ALLAHU I MADHËRUAR I KA ZGJEDHUR ROBËRIT E VET, TË CILËT I KA QUAJTUR MYSLIMANË DHE U KA CAKTUAR DETYRËN "XHIHAD NË RRUGËN E ALLAHUT".

"Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh më parë (në Shkrimet e Shenjta) dhe në këtë (Kuran), me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë. Andaj, faleni namazin, jepeni zekatin dhe mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrotjësi juaj. Sa Mbrotjës dhe Ndihmës i mrekullueshëm është Ai!" (Haxh, 78)

Sot, Islami, i cili njihet me shumë fraza, është një përshkrim i thjeshtë i robërve të zgjedhur të Allahut, larg çdo lloj atribumi dashakeqës që mund t'i bëhet. Ajeti fisnik e thotë qartë këtë: "...Ai (Allahu) ju ka quajtur "Myslimanë..." Allahu i Madhëruar i ka zgjedhur robërit e Vet, të cilët i ka quajtur myslimanë dhe u ka caktuar detyrën "Xhihad në rrugën e Allahut".

Myslimani është një rob i dalluar i Allahut dhe është i detyruar të bëjë një xhihad të vërtetë në rrugën e Tij. Profeti do të dëshmojë nëse e ka përmbytur këtë detyrë apo jo. Me fjalë të tjera, përmbajtja e xhihadit është të bësh një jetë sipas sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Sepse dëshmitari është dëshmitar i ngjarjes që shpaloset para syve të tij. Marrëdhënia e myslimanit me Pejgamberin është për të zbatuar dhe për të predikuar fenë që ai predikoi.





Nga kjo kuptohet se për të qenë i denjë për emrin mysliman, ky i fundit e ka obligim ta zbatojë fenë që i është përcjellë dhe ta përcjellë/transmetojë atë tek mbarë njerëzimi. Të thuash “Unë jam mysliman” nuk mbaron kjo punë, thjesht fillon. Nuk është gjë tjetër veçse injorancë që një mysliman i cili është vetëm në fillim të punës të ngrihet dhe t’ua përmendë njerëzve Islamit e tij. Kurani e mohon këtë në mënyrë eksplicite: **«Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamit. Thuaju: “Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamit; përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”** (Huxhurat, 17)

Ankesat si «mjafton kaq fetarizëm» apo «kërkesat nuk mbarojnë kurrë», nuk janë të drejta. Meqë masa jonë është Pejgamberi (a.s.), ne duhet të përqipemi të pasojmë jetën e tij dhe të zbatojmë fenë që ai predikoi. Ky është misioni ynë i brendshëm. Ne duhet të përqipemi të reformojmë veten dhe të bëhemi myslimanë të mirëfilltë. Por puna nuk mbaron me kaq. Ne kemi gjithashtu një detyrë ekstroverte, që është të jemi model për të gjithë botën. Është për të përcjellë fenë e Allahut (xh.xh.).

Të blig do të thotë të paraqesësh, të përcjellësh, të dërgosh. Për të paraqitur, përcjellë dhe dërguar, së pari duhet të zotërosh. Pikërisht në këtë pikë, ne duhet të marrim një dëshmi/autorizim/diplomë nga Profeti (a.s.).

Për ta poseduar Islamit dhe për ta përhapur atë, myslimanët e sotëm duhet t’u kushtojnë vëmendje tri çështjeve të mëposhtme:

a) Është e një rëndësie të madhe për çdo mysliman që të krijojë një lidhje të fortë me të kaluarën e tij. Nuk mund të mendohet që një njeri i cili nuk i njeh rrënjët e tij dhe nuk është i vetëdijshëm për të kaluarën e tij, të ndërtojë të ardhmen. Mënyra për ta bërë këtë është të rrisim marrëdhëniet tona me Kuranin dhe Sunetin dhe ta njohim mirë jetën e Pejgamberit tonë dhe të shokëve të tij.

b) Myslimani duhet ta mbajë vetëbesimin e tij të lartë, duke e ditur se nderi dhe dinjiteti i takon vetëm Allahut, Profetit të Tij dhe besimtarëve. Shprehjet që përçmojnë, poshtërojnë dhe lëndojnë myslimanët nuk janë kurrë të pajtueshme me Islamit. Fatkeqësisht, në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, një kompleks i tillë inferioriteti lindi tek myslimanët dhe efektet e tij negative u panë. Disa myslimanë e konsideruan zhvillimin material relativ atë që e shihnin në përdim si qytetërim dhe thanë: “Shkova në lindje, pashë myslimanë, por nuk kishte Islam! Shkova në perëndim dhe pashë Islamit, por nuk kishte myslimanë.” Diskurse të tilla u përhapën dhe u bënë opinion në mesin e myslimanëve, dhe si rrjedhojë, psikologjia e dëshpërimit e zuri shumicën e tyre robër. Edhe pse këto krahasime negative janë bërë me qëllime të mira, kanë krijuar një gjendje disfate.

c) Myslimani është gjithmonë me shpresë për të ardhmen. Zoti ynë i Plotfuqishëm është poseduesi i së djeshmes, së sotmes dhe së nesërme. Dëshpërimi i myslimanit do të thotë mohim i vetvetes, devijim nga rruga dhe rënie në degradim: **“Kush e shkëput shpresën nga mëshira e Zotit, përveç të çoroditurve?”** (Hixhr, 56)

Ndjenjat negative për të ardhmen si mungesa e shpresës, trishtimi, dobësia, etj., siç janë një kancer që shkatërron kombet, pengojnë gjithashtu edhe zhvillimin e shoqërive. Ndjenja të tilla të egra janë karakteristike për njerëzit frikacakë, të pafuqishëm dhe vulgarë.

Myslimani duhet të përqipet ta strukturojë kohën dhe vendin ku jeton sipas vlerave në të cilat beson, duke thënë: “Koha është e imja dhe hapësira më është besuar mua.”, siç ka thënë i ndjeri, Prof. Nexhip Fazëlli.

Përpjekja është nga ne, kurse suksesi është nga Allahu.

ÇFARË QENIEJE ËSHTË DJALLI DHE SI E MASHTRON NJERIUN?

— Abdurrahim Somunxhu —

Iblis është emri i djallit që ishte në xhenet. Pasi u dëbua nga xheneti, djalli mori emrin e vet. Xhindët dhe djajtë janë krijesa që nuk perceptohen nga organet tona të shqisave. Xhindët dhe djajtë, zotërojnë vetëdije dhe vullnet. Këta janë të obliguar të respektojnë urdhëresat dhe ndalesat e fesë islame.

Djali është prej xhindëve të egër dhe të devijuar. Në Suren Kehf, ajeti 50 thuhet se djajtë janë prej kategorisë së xhindëve. Djalli është një qenie që e shtyn njeriun në rrugë të gabuar, që e cyt zemrën e tij nga jashtë dhe i pëshpërit fshehtas. (Surja Nas, 5)

Në Suren Bekare, ajeti 34 përmendet njoftimi i Allahut ndërkohë që iblisi (*djalli*) jetonte me engjëjt në xhenet: “...**Kur u thamë engjëjve (dhe xhindëve): ‘Përluni në sexhde para Ademit’, ata u përlën, përveç Iblisit (djallit), i cili nuk deshë, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar.**”

Fakti se përse djalli nuk i bëri sexhde Ademit shpjegohet kështu në Suren A'raf, ajeti 12: “**Alla-**

hu tha: ‘Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?’ Ai (iblisi) u përgjigj: ‘Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta’. (Tha se zjarri ka pozitë më të lartë se balta dhe kundërshtoi duke mos iu bindur urdhrit të bënte sexhde (t'i përkulej) Ademit).”

Edhe xhindët, si djalli dhe njerëzit, hanë, pinë, lindin, martohen, bëjnë fëmijë dhe vdesin. Profeti ynë i nderuar, salallahu alejhi ue selem, i shikonte e i njihte xhindët. Ai ishte profet edhe i tyre. Ai gjykonte për zgjidhjen e problemeve midis xhindëve.

Sulejmani, alejhi selam, ndërtoi Mesxhid-i Ak-sanë, duke vënë në punë edhe xhindët. Xhindët nuk e dinë të fshehtën. Në Suren Se'be ajeti 14 bëhet e ditur se xhindët nuk e dinë të fshehtën.

Krijimi i xhindëve daton para krijimit të njerëzve.

Njerëzit, të cilët i mashtroi për herë të parë djalli dhe u përpoq t'i nxirrte nga rruga e drejtë duke u betuar rrejtshëm, ishin prindërit tanë Ademi,

alejhi salam, dhe Havaja. Ademi, alejhi salam, bashkë me nënën tonë, Hava, jetonin në xhenet. Teksa hëngrën nga pema që ua kishte ndaluar Allahu, djalli i këshilloi dhe i garantoj ata duke u betuar rrejtshëm se nuk do t'i dëmtonte asgjë, nuk do të dilnin nga xheneti dhe do të qëndronin përjetësisht në të. Në Suren A'raf, ajetet 19-22 përmendet: **“Dhe iu betua atyre (duke thënë): ‘Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!’”**


Djajtë i zbukurojnë gjërat e gabuara për të devijuar njerëzit nga rruga e drejtë. (Surja Ankebut, 38) Djalli është përpjekur ta nxjerrë nga rruga babain tonë, Ademin, alejhi salam, i cili është njeriu dhe profeti i parë dhe ta nxjerrë bashkë me bashkëshortin e tij prej xhenetit. Vallë, a nuk mund të na devijojë nga rruga e drejtë djalli, si (nipër) pasardhës të babait tonë Ademit?

Në Suren A'raf, ajeti 17 thuhet se djalli do t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë: **“ (ai kundërshtoi Allahun duke thënë: ...) e pastaj, do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vësh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!”**

Çfarë dëshirojnë të bëjnë djajtë për t'i devijuar njerëzit në rrugë të keqe? Për këtë, në Suren Maide, ajeti 91 thuhet: **“Vërtet, djalli me pije alkoolike (që të dehin) dhe me bixhoz kërkon të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë (nga këto)?”**

Gjithashtu, në Suren Bekare, ajeti 268 bëhet e ditur se djalli i urdhëron njerëzit në varfëri dhe ligësi. Megjithatë, siç është djalli prej xhindëve që kanë devijuar, ashtu është edhe prej njerëzve. Për këtë, në Suren Nas, ajetet 4, 5, 6, thuhet: **“(Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve) ... nga sherri i djallit cytës (që u cyt njerëzve gjëra të këqija) që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve!”** Në këtë sure bëhet e ditur se ka edhe djaj prej njerëzve përveç djallit prej xhindëve.

Cila është detyra që na bie? Është ta njohim djallin si armik dhe të mos shkojmë pas gjurmëve të tij. Prej nesh kërkohet mbështetje te Allahu për t'u mbrojtur nga sherri dhe cytjet e këtij djalli. Në suren Mu'minun, ajeti 97 thuhet: **“Dhe thuaj: ‘O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet (shigjetat helmuese që i hedhin në zemër) e djajve**



...” Mënyra për t'u mbrojtur nga djalli, është të mbizotërosh mendjen dhe të mbrohesh nga sherri i djallit, duke lexuar: **“Eudhu bil-lahi mine'sh-shejtani'rr-raxhim!”**, që është arma shpirtërore e besimtarit.

Si përfundim, kur të hyjë në xhenet i zgjedhuri për në xhenet dhe në xhehenem i zgjedhuri për në xhehenem; kur të mblidhen rreth djallit pa-suesit e tij dhe t'i thonë se na mashtrove dhe u bëre shkak që ne të hyjmë në xhehenem, përgjigjen që jep djalli e mësojmë nga Surja Ibrahim, ajeti 22: **“Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do t'u thotë (atyre): ‘Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova (devijova nga fjala ime). Unë nuk kam pasur kurrfarë (force) pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra (të mohonit dhe kundërshtonit) e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi! ...”**

Profeti ynë i nderuar, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Çdo njeri ka një djall.”** Myslimani duhet të kërkojë gjithnjë mbrojtje prej Allahut. Nga Profeti ynë i nderuar këshillohet leximi i Ajetu'l-Kursij dhe i sureve Felek e Nas kundër ndikimit negativ të xhindit dhe djallit. (Buhari, “Vekale-Kujdestaria”, 10; Tirmidhi “Tib-Mjekësia”, 16)

Allahu na mbroftë nga e keqja e djajve prej njerëzve dhe xhindëve!

AGIMI ËSHTË KOHA E PASTRIMIT TË BESIMTARIT

— Dr. Kerim Bulladë —

Në Kuranin Fisnik, në sure të ndryshme, flitet për cilësitë e besimtarëve, për besimin e fortë të tyre, për dhënien pas ibadetit, për përpjekjet që shfaqin në dhënien për hir të Allahut Teala, për konceptimin e nderit, për ruajtjen e amanetit, për respektin që kanë kundrejt Allahut të Madhëruar dhe për largimin e tyre prej gjërave që nuk u interesojnë.¹ Në këtë shkrim, do të flasim vetëm për disa cilësi të besimtarëve.

1. Natën e kalojnë duke i bërë sexhde Allahut Teala. Besimtarët bëjmë shumë ibadet edhe natën, ashtu siç nuk i nënvlerësojnë ibadet e ditës, ndërkohë që punojnë për të fituar dhe për të plotësuar nevojat e shtëpisë. Kurani Fisnik thotë kështu për ata:

“Robërit (e veçantë) të Rrahmanit janë ata që ecin me modesti në tokë. Kur u hedhin ndonjë fjalë injorantët, ata thonë paqe (pa i lënduar ata)! Ndërsa natën e kalojnë duke bërë sexhde dhe kijam (pjesë e namazit që fillon me tekbirin fillestar

dhe mbaron në ruku).” Kur besimtarët hyjnë në mbrëmje në shtëpitë e tyre, nuk e kalojnë kohën pa u marrë me diçka. Ata e përmendin gjithmonë Allahun e Madhëruar kur janë duke pushuar, kur janë ulur dhe kur ngrihen. Besimtarët nuk janë neglizhentë në këtë çështje. Ata i drejtohen Allahut Teala, qëndrojnë në audiencën e ti dhe falin namaz në mënyrë të sinqertë.

Besimtarët veprojnë të vetëdijshëm për ekuilibrin e ndjeshëm që shprehet në ajetin Kuranor, ku Allahu i Madhëruar thotë:

“A mund të jetë (i njëjtë me mohuesin) ai që e kalon natën duke bërë sexhde e duke qëndruar në kijam, që frikësohet për ahiretin e tij dhe kërkon mëshirën e Zotit?..”²

Besimtarët veprojnë duke e kuptuar delikatesën dhe rëndësinë e detyrës që u është dhënë. Qëndrimi në sexhde dhe qëndrimi në kijam, është cilësia themelore e tyre. Besimtarët bëjnë sexhde në orët

1. Shik. El-Bakara, 2/1-5, el-Mu'minun, 23/1-9, etj.

2. ez-Zumer, 39/9.



e vona të natës dhe lexojnë ajetet e Allahut Teala.³ Besimtarët bëjnë sexhde duke qarë kur përmenden ajetet e Allahut Teala, që është shumë i mëshirshëm dhe ndjekin rrugën që të shpie te e vërteta dhe rrugën e pejgamberëve të zgjedhur, si Ademi, Nuhu, Ibrahim, Jakubi, Ismaili⁴ dhe Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem.

2. Flenë pak natën. Kurani Fisnik i shpreh kështu cilësitë e bukura të besimtarëve, që e kanë merituar xhenetin në këtë botë:

“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre, meqë më parë kanë qenë punëmbarrë. Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).”⁵

Besimtarët bëjnë punë të mira në këtë botë. Nuk u hyn gjumë në sy, për shkak të dashurisë ndaj Allahut dhe ngaqë frikësohen për ahiretin e tyre. Në këtë mënyrë, bëjnë ibadet dhe kryejnë obligimet e tyre. Ata nuk flenë në kohën e agimit dhe i kërkojnë falje Allahut Teala për gabimet e tyre. Agimin që është koha më e përshtatshme për lutje dhe istigfar, e kalojnë me ibadet. Istigfarin që meriton të pranohet nga Zoti, e bëjnë këta njerëz të mirë.⁶

Besimtarët bëjnë ato gjëra për të cilat janë urdhëruar dhe i lënë ato të cilat i kanë të ndaluara. Të flesh pak, të bësh shumë ibadet, të kërkoesh falje natën, ta zbukurosh atë me lutje dhe përgjërime, janë cilësitë më të dallueshme të besimtarët. Për shkak të këtij sinqeriteti dhe besnikërie ndaj Allahut Teala, arrijnë kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), dhe fitojnë xhenetin me mirësinë e Tij.

3. Trupat e tyre qëndrojnë larg shtretërve. Besimtarët qëndrojnë gjatë pa fjetur natën. Ata digjen me dashurinë për të fituar shtretërit e jastëkët e përherëshëm⁷ dhe qëndrojnë larg shtretërve e jastëkëve të përkohshëm. Kurani Fisnik i thekson kështu cilësitë themelore të besimtarëve:

“Shpalljet Tona i besojnë vetëm ata të cilët, kur u përmenden, bien në sexhde, dhe të cilët e adhurojnë Zotin e tyre, e lavdërojnë dhe nuk bëhen mendjemëdhenj. Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ta (në jetën tjetër), si

shpërblim për punët e mira që kanë bërë. Vallë! A është besimtari njësoj si keqbërësi? Jo, ata nuk janë të barabartë. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë Xhenetin strehëm, si shpërblim për punët (e mira) që kanë bërë.”⁸

Besimtarët janë gjithmonë ndërmjet frikës dhe shpresës. Ata gjithmonë shpresojnë në mëshirën e Allahut të Madhëruar.⁹ Nga ana tjetër, frikësohen nga zemërimi dhe ndëshkimi i Allahut Teala. Ata shpresojnë xhenetin, por frikësohen shumë edhe nga xhehenemi.

4. Namazet i falin vazhdimisht. Besimtarët i falin gjithmonë namazet e tyre. Ata nuk i lënë pesë vaktet, namazin e xhumasë dhe namazet e bajrameve. Përveç namazeve farz, ata nuk nënvlerësojnë edhe namazet nafile. Besimtarët i falin namazet vazhdimisht, ashtu siç shprehet edhe në ajetin Kuranor:

“Ata janë të vazhdueshëm në faljet e tyre.” “Ata që i falin namazet rregullisht.”¹⁰

Ata janë të kujdesshëm ndaj namazeve, ashtu siç ruajnë jetën e tyre, sepse ua dinë vlerën. Ata kurrë nuk qëndrojnë larg rukusë dhe sexhdes. Në çfarëdo kushtesh që të jenë, nuk e lënë namazin për asnjë lloj pune, pozite, grade, pasurie dhe fame. E pranojnë namazin si një argument real të besimit të tyre. Ata e duan namazin, i cili është një praktikë dhe një argument i jashtëm i fjalës së Teuhidit. Ata ndjejnë dashuri për namazin si për dritën e syve të tyre.

Besimtarët i vazhdojnë ibadetet, namazet dhe lutjet derisa t’u vijë jakini (vdekja). Ata veprojnë brenda kornizës së urdhrave hyjnorë për të cilët bëhet fjalë në këto ajete kuranore:

“Tani, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur! Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”¹¹

Ata përpiqen të lartësohen pa u vënë rëndësi nënvlerësimeve, talljeve dhe nënçmimeve të askujt. Ata ndjejnë kënaqësi me vetëdijen ndaj ibadetit, i cili u është gdhendur në shpirtat e tyre dhe përjetojnë qetësi shpirtërore duke falur namaz. Ata e dinë se në jetën e ibadetit nuk ka qetësin, pushim, raport apo ndërprerje dhe në këtë mënyrë përpiqen ta plotësojnë jetën e tyre të përkohshme. Për këtë arsye, në çdo punë të besimtarit ka mirësi.

3. Shik. Al Imran, 3/111.

4. Shik. Merjem, 19/58.

5. Edh-Dharijat, 51/15-18.

6. Elmallëllë, Muhammed Hamdi Yazir, Hak Dini Kur'an Dili. Ata që e kanë thjeshtëzuar: Ismail Karaçam shokët e tij, Gjermani, pa datë, VII, 255.

7. err-Rahman, 55/54; el-Vakia, 56/34; el-Gashije, 88/15.

8. es-Sexhde, 32/15-19.

9. Shik. ez-Zumer, 39/53.

10. el-Mearixh, 70/23,34.

11. el-Hixhr, 15/98-99.

7 GRUPE NJERËZISH TË PËRZGJEDHUR

— Murat Kaja —

Profeti ynë (a.s.), ka ndjekur metoda të shumta për t'ia mësuar njerëzve këtë fe. Përveç urdhrave dhe ndalesave, ndonjëherë ka rregulluar gabimin ose ka miratuar edhe punën e mirë të ndokujt. Ndonjëherë u ka drejtuar pyetje shokëve të tij dhe përgjigjen përsëri e ka dhënë vetë. Pyetjeve që i bëheshin, ndonjëherë u përgjigjej ashtu sikur ishte, por ndonjëherë duke dhënë edhe më tepër detaje nga ç'kërkohej.

Ka qëlluar t'i mësonte edhe duke e vepruar, ose duke u larguar vetë nga një vepër. Ndonjëherë ka folur pak dhe saktë, arsye për të cilën e kanë quajtur edhe “**xhevamiu'l-kelim**”, që do të thotë, “tregon shumë, me pak fjalë”. Këto fjalë ai i ka gdhendur në mendjen e njerëzve, duke i përmendur nga tri herë. Ndonjëherë, çështjen e ka shpjeguar gjerë e gjatë, ka treguar ndodhi dhe ka portretizuar çështjet të ndryshme. Dhe ndonjëherë, i shpjegonte të ndara në kategori...

Është e mundur që këto t'i japim një nga një, me shembuj, sepse librat e haditheve janë të mbushur me mijëra nga këto shembuj. Mirëpo, këtu duam të marrim në dorë një hadith që na tregon se si i Dërguari i Allahut u ka mësuar njerëzve fenë, moralin e lartë, urtësinë dhe vlerat, duke ua dhënë diturinë të ndarë në kategori dhe grupe.

I Dërguari i Allahut na e përkujton shpesh botën tjetër dhe i portretizon në një mënyrë të gjallë ato që do të ndodhin atje, gjendjen dhe veprimet e njerëzve. Ja pra, hadithi ynë fillon duke treguar gjendjen e njerëzve në botën tjetër: **“Atë ditë Allahu do të marrë nën hijen e (arshit të) vet shtatë persona. Atë ditë nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së (arshit të) Tij.”** (Buhari, Xhemaat dhe Imamet, 8; Muslim, Zekat, 91) Me këtë, Profeti ynë (a.s.) na sjell para syve edhe gjendjen e asaj dite në botën tjetër, por na bën edhe kureshtar për të ditur se cilët janë këta persona. Cilët janë këta shtatë persona

1. **KRYETARI I SHTETIT
I CILI PUNON ME DREJTËSI.**
2. **I RIU QË EDUKOHET
ME DASHURI DHE RESPEKT
NDAJ ADHURIMIT TË ALLAHUT.**
3. **NJERIU, ZEMRA E TË CILIT
ËSHTË E LIDHUR MBAS XHAMISË.**
4. **ATA QË E DUAN NJËRI-TJETRIN
PËR HIR TË ALLAHUT.**
5. **AI QË RUAN NDERIN DHE NAMUSIN.**
6. **MIRËBËRËSI, I CILI ATË QË JEP
ME DORËN E DJATHTË NUK IA DI E
MAJTA.**
7. **AI QË E PËRMEND ALLAHUN
KUR ËSHTË I VETMUAR.**

fatlumë? Ç'është ajo që i bën ata të përgëzohen me këtë mirësi?

Në fillim Resulullahu (a.s.) tregon për kryetarin e shtetit që punon me drejtësi. Pra këtu na jepet një stimulim drejt fushës materiale të kësaj bote. Që në fillim, ai sikur na jep mesazhin se në këtë fe materialja dhe shpirtërorja janë të lidhura si mishi me thoin. Resulullahu (a.s.) i jep shumë rëndësi sigurisë dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve dhe dëshiron që populli të jetojë i qetë dhe i sigurt. Për këtë arsye, nuk e lë bosh këtë fushë. Ai vë në dukje një vlerë universale: Drejtësinë. Ky është edhe një princip i cili theksohet shumë në Kuranin Famë-lartë. (Nisa 4/58; Maide 5/8; Nahl 16/90) Madje Kur'ani na tregon për Davudin (a.s.), i cili gjendet në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe materiale. Allahu e urdhëron edhe atë, që të prijë me drejtësi dhe me barazi. (Sad 38/26). Në një farë mënyre, edhe Omeri (r.a.) halifja i dytë i Profetit (a.s.) e përforcon këtë princip. Me veprimtaritë që zhvilloi, me institucionet që formoi dhe me vendimet që mori, ai u bë njeriu i parë që përfitoi nga ky përgëzim që solli Profeti ynë (a.s.). Ai përbën shembullin konkret të këtij princip që stabilizoi Islami. Për këtë arsye, ai është quajtur "Umeru adlun", që do të thotë, "Omeri (r.a.) është vetë drejtësia".

Së dyti, Profeti ynë (a.s.) bën fjalë për të riun që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit. Këta janë kategoria e dytë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e arshit të Allahut. Të rinjtë që edukohen prej vegjëlisë me vetëdijen e besimit, të cilët ecin me kokën lart dhe pa u ndarë nga rruga e drejtë, në kohën kur iu zien gjaku dhe kur mjedisi përreth tyre është mbushur përplot me qendra joshëse. Të rinjtë që përkushtohen me kujdes, me dashuri, me energji dhe dinamizmin në këtë rrugë...

Në Kuranin Famë-lartë kemi shembullin e "Shokëve të shpellës". Allahu shprehet me lëvdata për këta të rinj sakrifikues! Që në fillim, përreth Resulullahut ka pasur gjithmonë të rinj. Çështja e shenjtë e Islamit është lartësuar mbi supet e këtyre të rinjve të devotshëm. Janë ata që mundohen dhe punojnë për t'ia mësuar vetes dhe të tjerëve Kuranin në Mekke. Janë përsëri ata që qëndrojnë në krye të luftës në Medine dhe në përhapjen e Islamit në vende të ndryshme. Aliu (r.a.) është shembulli më i mirë i atyre që e kanë kushtuar jetën e tyre në rrugën e Allahut. I pari që besoi, i pari që rrezikoi jetën në kohën e hixhretit, Luani i Allahut në Bedir dhe Uhud, Aliu (r.a.).

Së treti, vjen ai zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Pra, besimtari në zemrën e të cilit ndodhet një dashuri e pashoqe për xhaminë. Një vakt namaz e ka falur dhe pret me padurim të vijë vakti tjetër. Një njeri shumë i përkushtuar në faljen e namazit në xhami dhe në ripërtëritjen e sunetit. Xhamia ujë dhe besimtarët peshq! Si mos ta dojë xhaminë besimtari? Në kohën kur Resulullahu (a.s.) emigroi për në Medine, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie dhe ai vetë mbajti gurë në supet e tij. Zemra e myslimanëve dhe pulsi i bashkësisë Islame rreh gjithmonë nëpër xhamia. Bashkimi, vëllazëria është aty. Ndihma dhe solidariteti janë aty. Libri i Allahut lexohet aty, emri i Tij përmendet aty dhe njerëzit po prej aty thirren për në shpëtim. Xhamitë janë projektimi i mëshirës që zbret nga Qabja. Mëshira gurgullon në xhami, qetësia zbret në xhami. Ja pra, për këtë arsye besimtarët që kanë dashuri për xhaminë dhe xhematin dhe që ndjejnë dëshirën për shërbim ndaj xhamisë, do të jenë nën hijen e arshit në ditën e kiametit.

Së katërti, Profeti ynë (a.s.) na tregon për **ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut**. Midis tyre nuk ka ndonjë interes të kësaj bote por ka vetëm një miqësi të pastër dhe pa pretendime. Kur bashkohen, bashkohen për hir të Allahut duke shpresuar kënaqësinë e Tij. Madje, edhe kur ndahen, ndahen për hir të Tij dhe shpresojnë kënaqësinë e Tij. Dhe

kjo dashuri midis tyre vazhdon deri në fund të jetës. Çfarë ka më me vlerë në jetë se sa një mik i sinqertë? Të dimë që kemi një mik të sinqertë dhe besnik, që e duam dhe e duan, na jep një qetësi të madhe shpirtërore. Një pjesë e bukurisë së jetës përbëhet nga miqësia e ngrohtë, nga ajo miqësi që nuk bazohet në interesa...

Në Kuranin Famëlartë flitet për miq që do të jenë armiq në ditën e kiametit. Mirëpo, miqtë e vërtetë do të jenë larg kësaj. (Zuhruf 43/67) Në një vend tjetër tregohet për dikë që meriton dënimin dhe ky me një pendim të thellë thotë: **“Ah sikur të mos isha mik i filanit!”** (Furkan 25/28) Sa miqësi e bukur është ajo e të Dërguarit të Allahut (a.s.) me sahabët e tij si Ebu Bekri dhe Omeri (r.a.)! Përfytyroni për pak çaste tablonë e sinqertë që ekspozojnë këta miq të ngrohtë, të cilët bisedojnë të ulur pranë një pusi!

I pesti është ai që i jep një rëndësi të veçantë, nderit dhe namusit. **Një grua me pushtet i propozon këtij marrëdhënie të pamoralshme dhe ky e refuzon atë duke thënë, “unë i frikësohem Allahut”.** Sa virtyt i madh është nderi! Për çfarë virtytësh mund të bëhet fjalë, nëse në një popull ka humbur ndjenjat e nderit dhe namusit!? Ja pra, ajo që na e siguron këtë ndjenjë është devotshmëria. Pra të jesh i vetëdijshëm kundrejt përgjegjësive që ke ndaj Allahut.

Ato që ka jetuar Jusufi (a.s.) janë të njëjta me ato që na ka treguar Resulullahu (a.s.). Të gjithë e dimë ndodhinë. Në suren Jusuf ajo jepet me detaje. Mirëpo, përgjigja e atij njeriu të lartë ndaj një propozimi të pamoralshëm është shumë ndikuese: **“Allahu më ruajt nga kjo gjë. Si mund të bëj këtë pasi që Allahu më ka dhuruar këto mirësi.”** (Jusuf 12/23) Në rrethin që jetonte Jusufi (a.s.), edhe burrat edhe gratë ishin zhytur nga koka tek këmbët në imoralitet. Jusufi (a.s.) e pa më të arsyeshme të qëndronte në burg, se sa të jetonte pa ndjenja në një rreth të tillë: **“Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dashur për mua, se sa ajo që ma ofrojnë ato mua...”** (Jusuf 12/33) Lutja e Profetit tonë (a.s.) do të na ndihmojë në këto raste: “Allahu im, dëshiroj prej teje që të jem në rrugë të drejtë, të përqafohem me devotshmërinë dhe të jetoj me nder.” Gjithashtu, edhe zotëruesi i dy dritave në kohën e Profetit, Osmani (r.a.), na ndriçon rrugën me ndjesinë e tij të veçantë ndaj nderit dhe turpiti!

Për sa i përket të gjashtit, Profeti ynë (a.s.), me këtë nënvizon një pikë të rëndësishme. Pra, **dora e majtë e atij që bën mirë nuk duhet të dijë se ç'bën**

dora e djathtë. Kështu që, ai njeri mirësinë e bën në mënyrë të fshehtë. Sepse qëllimi i tij është vetëm kënaqësia e Allahut. Ai nuk e bën këtë për sy e faqe. Në ajetin e ndershëm shprehet se të japësh haptas është mirë, por të japësh fshehtas është edhe më mirë, (Bakara 2/271). Profeti ynë i dashur, çështjen e fshehtësisë e ka shprehur në një mënyrë shumë interesante, për arsye që ai i cili merr lëmoshë të mos turpërohet midis të tjerëve. Atë që jep dora e djathtë të mos e dijë e majta! Sigurisht, edhe njerëzit që marrin lëmoshë kanë një ndjenjë nderi dhe krenarie. Prandaj, kur të jepet, duhet të jepet pa i cenuar ndjenjat e tyre. Ja pra, edhe ata që e kanë këtë ndjesi, do të jenë nën hijen e arshit.

I shtati dhe i fundit është **ai që e përmend Allahun dhe të Dërguarin e Tij kur gjendet i vetmuar.** Ky njeri është aq i mbushur me dashuri ndaj Allahut, sa që nga sytë e tij rrjedhin lot. Dashuria hyjnore ia djeg zemrën. Zemra e shuan zjarrin dhe shpirti e ujit tokën me lotët e tij. Kur e përmend Allahun dhe e lexon librin e Tij, zemra i rrëqethet dhe i mbushet me devotshmëri dhe mëshirë. Shpirti i tij fiton butësi dhe pastërti! Edhe Profeti ynë (a.s.) i ka kaluar disa nga netët e Tij i mbytur në lot. Kryen adhurim, lexon Kur'an dhe derdh lot i Dërguari i Allahut (a.s.). Edhe shoku i Tij më i ngushtë Ebu Bekri (r.a.) kishte një zemër të tillë. Në mesxhidin që ndërtoi përpara shtëpisë së tij në Mekke, lexonte Kuran duke qarë. Vajza e tij Aishja (r.a.) na e tregon atë si “një njeri me zemër të butë dhe sylagur”. Mirëpo këtë nuk mund ta shpjegosh dot me fjalë, nëse nuk e jeton, nuk e kupton.

Hadithi ynë fillon me materialen dhe mbaron me shpirtëroren. Në këtë fe, rëndësia që i jepet rregullimit të jetës së kësaj bote është po aq e madhe sa edhe rëndësia që i jepet forcimit dhe pasurimit të botës shpirtërore të njeriut. Me këtë hadith, i Dërguari i Allahut (a.s.) na ka paraqitur një manifestim të principeve universale të Islamit. Ky hadith është si një ylber që pasqyron shtatë ngjyrat themelore të diellit Islam. Ai nxjerr në pah ngjyrat që i jep Islami këtyre vlerave, që nga principi i lidhur me shtetin, marrëdhëniet shoqërore, kujdesi që duhet treguar në punë të mira dhe deri tek rëndësia që kanë marrëdhëniet e njeriut me Allahun. Nëse e marrim numrin shtatë si një kuptim figurativ të shumicës, pra simbolin që tregon një sasi të madhe, do të shikojmë se këto pika janë dimensione që zgjaten për tek principet e tjera.

BASHKË ME TË RINJTË NË RRUGËN E EDUKIMIT

— Idris Arpat —

Çështja e mësim-edukimit është një nga çështjet më serioze të njerëzimit. Ashtu siç ka lidhje mënyra e botëkuptimit dhe jetesës sonë me mësim-edukimin, ashtu ka lidhje edhe grada jonë me cilësinë e arsimit. Dashuritë tona, dëshirat, aftësitë dhe dobësitë tona; mungesa e idealeve, jeta pa qëllime dhe të gjitha të metat tona të ngjashme me këto, në një farë mënyre janë të lidhura me mësim-edukimin.

Thonë se mësim-edukimi është një “profesion pejgamberësh”. Kjo mund të thuhet edhe për shkak se pejgamberët kanë qenë mësuesit e njerëzimit, por edhe për të theksuar rëndësinë e kësaj çështjeje.

Popujt që e marrin seriozisht jetën dhe mendojnë për të tashmen e të ardhmen e tyre, i japin shumë rëndësi mësim-edukimit. Ata, jo vetëm që ndajnë pjesën më të madhe të buxhetit për fushën e arsimit, por i orientojnë në këtë fushë edhe fëmijët më të zgjuar dhe mendjet më të mprehta. E njëjta gjë është edhe nëse e shohim nga aspekti i familjes dhe i nxënësit. Cilëndo familje të pyesni se “cila është gjëja më e shtrenjtë për ju?”, “fëmijët”, do t’u përgjigjen. Sigurisht që familjet dëshirojnë t’i edukojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla me emër. Fëmijët e tyre që i kanë rritur me aq mund, nuk do të dëshironin kurrë t’i linin në dorën e mësuesve të rëndomtë nëpër shkolla të thjeshta.

Në fillim, deri në një farë mase nxënësi mund ta kuptojë rëndësinë e çështjes së edukimit dhe se a janë apo jo të përshtatshme kushtet e mësimimit. Por me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e aftësisë së perceptimit, ai arrin ta kuptojë mirë nivelin e shkollës dhe të mësuesve. Për rrjedhojë, ai e di mirë se çfarë themelesh po hidhen, ato të lumturisë apo të shkatërrimit.

Një temë të gjerë siç është kjo e mësim-edukimit,



është e vështirë ta përmbledhësh të gjithën brenda kufijve të këtij shkrimi, por megjithatë, do të dëshiroja të hyja pak në detaje.

Le të marrim në dorë lëndën e letërsisë. Për shkak se është një lëndë me përmbajtje të gjerë dhe plot ngjyra, ajo e tërheq vëmendjen e nxënësit, e emocionon dhe zgjeron botën e tij të imagjinatës. Kështu duhet të jetë mësimi, nëse mësuesi i lëndës është i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka, e ka pasion lëndën dhe është i aftë. Po ashtu, edhe lëndët e tjera varen nga këto parime.

Çdo lëndë ka ngjyrat dhe veçoritë e saj tërheqëse. Mjafton që mësuesi i lëndës të kuptojë rëndësinë e çështjes, të ndjejë përgjegjësinë dhe të përdorë potencialin që ka.

Këtu duhet të theksojmë se edhe aftësitë dhe prirjet e nxënësit duhet të merren patjetër në konsideratë. Ashtu si çdo fëmijë nuk është i aftë në çdo lëndë, edhe prirjet e tij nuk janë të njëjta për çdo lëndë. Padyshim se orientimi i nxënësit në një degë sipas aftësive dhe prirjeve të tij, është e detyrueshme. “Puna më e lehtë është ajo që bëhet me dashuri”. Prandaj duhet ta kuptojmë mirë rëndësinë e aftësisë dhe dashurisë dhe të besojmë në forcën e saj.

Nëse shkolla arrin t’i japë fëmijës zakonin e leximit, do të thotë se ka arritur një sukses shumë të madh. Do të thotë se tashmë, orët e mërzitshme janë kthyer në orë tërheqëse. Allahu betohet në penën dhe ato që shkruhen me të. Por kushedi çfarë mirësisë do të falë Ai për shkak të edukimit të mendjeve të arta dhe zemrave të gjera. Në këtë mënyrë, njeriu do të kapërcejë një nga një të gjitha shkallët e zhvillimit dhe do të arrijë mendime të larta e ndjenja të pastra. Kufijtë e kënaqësisë do të qartësohen dhe do të zgjerohen me zgjerimin e botës së mirësisë. Prej mirësive të qiejve dhe të tokës do të burojnë gëzime dhe festa të ndryshme.

Prej lëndëve të logjikës e matematikës do të arrihen mendime të qarta, ndërsa prej filozofisë dhe tasavufit thellësi e gjerësi. Me qartësimin e dijes do të kenë saktësi edhe mendimet e mbështetura

në dije. Mendimet e sakta do të sjellin vendime të sakta, ndërsa vendimet e sakta, do të sjellin zbatime të suksesshme. Kushti i domosdoshëm për arritjen e këtyre sukseseve dhe pasurive, janë mësuesit që vlojnë nga brenda.

Mësuesi...

Njeriu që ka marrë mbi supë misionin e pejgambereve, ka marrë përsipër një barrë shumë të rëndë prandaj jeton me ndërgjegje. Ai është njeriu që i ka kthyer gjembat nga brenda dhe nga jashtë çel gjithmonë trëndafila. Sado shqetësime të ketë, ai është njeri që preferon të qeshë. Ai është njeriu që jeton për të ardhmen.

Edhe një bukuri, edhe një urtësi, edhe një varg, edhe një fjali të bukur... në këtë mënyrë, këta njerëz nuk e kuptojnë përfundimin e ditëve të numëruara... Vetëm për të edukuar një nxënës durojnë një mijë të këqija. Ata janë njerëz që thonë “vdes nëse nuk jap mësim”, “ditën kur të mos vij në mësim, ejani në varrimin tim”. Për ta nuk ka kufi në shërbimin ndaj nxënësve dhe arsimit. Ata edhe prej vrasësit më të keq arrijnë të nxjerrin flamurtarë të besimit.

Nëse nuk gjeni dot mësues të mirë, gjithçka bëhet e vështirë. Fati më i keq i fëmijëve nuk është mungesa e shkollës, e pajisjeve mësimore apo e parave. Këto mund të zgjidhen në një farë mënyre. Por çfarë do të bëni nëse mësuesit i shuhet ideali, i ngushtohet horizonti dhe i ndalen përpjekjet? Mungesa e vizionit, e përpjekjes dhe e entuziazmit e bën jo vetëm shkollën sikur ka rënë zjarri, por edhe fëmijët i kthen në lule që vyshken pa çelur ende mirë. A nuk ia nxin të ardhmen shoqërisë ky problem?

Ja pra fëmijë e të rinj! Ju jeni të interesuarit e drejtpërdrejtë të gjithçkaje që ndodh. Programi i shkollës kështu, mësuesit ashtu, botëkuptimi i edukimit një përrallë tjetër etj... Por sido që të jetë, ju duhet patjetër të gjeni një mënyrë për të zhvilluar veten. Nuk ndodhemi në vendin e ankesave dhe qarjeve, por në testin e seriozitetit dhe sinqeritetit. Askush nuk i ka ngjitur shkallët e suksesit me duar në xhepa e duke fishkëlyer. Kjo është koha për të shtrënguar dhëmbët dhe për të mësuar durimin. “Fillimet e dijes janë më djegëse se qepa, por fundi



është më i ëmbël se mjalti”, miku im. Ti duhet të dish të përtypësh hidhërimet pa e shtrembëruar fytyrën dhe t’u vësh gjoksin vështirësive.

Nëse e mësoni mirë arabishten, do t’u hapen dyert e dijes islame e, nëse e mësoni anglishten, u hapen dyert e kulturës botërore. Prandaj, këto dy gjuhë duhen mësuar në mënyrë sa më të dobishme. Përndryshe, nuk mund të hapeni në oqeanet e gjera të dijes, mendimit dhe artit, por do ta burgosnit veten në një hapësirë shumë të ngushtë.

Nga ana tjetër, duhet të fitoni një zakon të vazhdueshëm e të rregullt të leximit. Ka shumë libra dhe shkrime që ju presin për t’i lexuar. Me të lexuar e mësuar, shtohet edhe kureshtja, ngrihet edhe niveli i botëkuptimit dhe perceptimit tuaj.

Gjatë leximit nuk duhet të nxitohemi. Duhet të shpëtojmë nga ndjenja e mbarimit sa më shpejt të shkrimit apo të librit. Përndryshe, do të na shpëtojnë shumë urtësi dhe shprehje të bukura.

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe marrja e shënimeve. Kur lexojmë një libër, duhet të marrim shënim çdo gjë të rëndësishme dhe çdo fjali që na pëlqen. Në sajë të shënimeve, prej atyre që mësojmë kur jemi pesëmbëdhjetë vjeç do të përfitojmë edhe kur të jemi dyzetepesë vjeç. Shënimet e mbajtura, në të ardhmen do t’ju falin emocione të reja dhe do t’u hapin derën shumë zhvillimeve të dobishme.

Njeriu nuk duhet ta detyrojë veten të lexojë këtë apo atë libër të caktuar. Ai duhet të lexojë atë libër që dëshiron. Ashtu siç nuk i pëlqejnë gjithmonë të njëjtat gjellë, njeriut nuk i pëlqejnë gjithmonë edhe të njëjtët libra. Në lidhje me këtë çështje, kriteri më i mirë është interesi i njeriut. Njeriu duhet të lexojë librin për të cilin ka interes dhe dëshiron ta lexojë. Në këtë mënyrë edhe kultura jonë mbushet me ngjyra, por edhe lexojmë me dëshirë e pasion.

Njeriu që merret me dije dhe mendime, në të njëjtën kohë duhet edhe të shkruajë. Ai duhet t’i shkruajë mendimet dhe disa prej ndodhive të gëzueshme e të hidhura, duke shënuar edhe datën e tyre. Këto mund të jenë ditarë të çmuar, poezi ose tregime të shkurtra. Në këtë mënyrë, nuk i çojmë dëm frytet e mendjes dhe zemrës sonë. Duke

shkruar vazhdimisht, do të arrijmë mendime më të qarta, pjekuri dhe tekste më të bukura.

Pjesëtarët e një feje që betohet në penën dhe ato që shkruhen me të, nuk duhet ta lëshojnë kurrë penën nga dora. Ju e dini, është një metodë që quhet “Të mendosh duke shkruar, të shkruash duke menduar”.

Njeriu nuk duhet t’i mbajë për vete ato që mëson. Në një farë mënyre, ai duhet t’i shprehë ato në çdo moment të përshtatshëm. Mendimet e qëlluara dhe fjalitë e bukura duhen shprehur patjetër në një moment kafeje, gjatë një bisede ose gjatë një shëtitjeje. Është e mundur që këto të tërheqin vëmendjen e dëgjuesit dhe të ndikojnë tek ai. Fshehja e dijes nuk ka asnjë dobi. Retë mbajnë shumë shi, por nëse nuk e lëshojnë, janë të padobishme.

Bisedat në aspektin e dijes dhe mendimit, në të njëjtën kohë janë edhe stërvitje e mendjes. Rruga e dijes dhe njohjes, është një rrugë e gjatë dhe e hollë, e cila kërkon durim, vazhdimësi, kujdes dhe metodë. Këto janë elementet e domosdoshme të kësaj rruge.

Le të kujtojmë edhe një çështje: Ashtu siç është “leximi” një mënyrë mësimi në rrugën e dijes, ashtu është edhe “dëgjimi”. Në Kuranin Fisnik, urdhërohet: **“Ata të cilët dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të bukurën prej tyre...”** (Zumer, 18) Pra, të dëgjosh me vëmendje, të marrësh atë që është më e bukura e të lësh atë që nuk është e dobishme. Me një fjalë, të kesh një mendje që zgjedh e jo që merr ose lë gjithçka. Nëse përvetësohet kjo metodë, udhëtari i dijes do të përfitojë shumë.

Edhe një çështje:

Qëllimi ynë i vetëm në veprimtaritë tona drejt dijes e njohjes, është kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Në hyrjen e sures el-Muddeththir, e cila është një nga suret e para që është zbritur, pasi Allahu i drejtohet Pejgamberit tonë (a.s.), duke i thënë të ngrihet e të thërrasë njerëzit, të madhërojë Allahun, të pastrohet nga papastërtitë trupore dhe shpirtërore, Ai e urdhëron që pas të gjitha këtyre: “Të durojë për hir të Zotit!”. Pra, çështja është shumë e qartë. Në të kundërtën, gjithçka bëhet e pamundur.



KATËR MIQTË E ZGJEDHUR TË TË DËRGUIARIT TË ALLAHUT

Kur të analizohet dhe meditohet rreth historisë së njerëzimit, vihet re se personalitetet e mëdha i kanë dhënë drejtim rrjedhës së historisë.

Në krye të këtyre personaliteteve vijnë pejgamberët, pastaj figurat e mëdha që kanë edukuar këta pejgamberë, pastaj miqtë e Zotit (evliatë) që ndoqën gjurmët e tyre dhe arritën pikën kulmore në ma'rifetull-llah, pastaj dijetarët që arritën pikën kulmore në dije e urtësi dhe pastaj padishahët që ishin sulltanë të materiales dhe shpirtërores.

VULA PROFETIKE NDAJ HISTORISË

Kur të analizohet dhe meditohet rreth historisë së njerëzimit, vihet re se personalitetet e mëdha i kanë dhënë drejtim rrjedhës së historisë.

Në krye të këtyre personaliteteve vijnë pejgamberët, pastaj figurat e mëdha që kanë edukuar këta pejgamberë, pastaj miqtë e Zotit (evliatë) që ndoqën gjurmët e tyre dhe arritën pikën kulmore në ma'rifetull-llah, pastaj dijetarët që arritën pikën kulmore në dije e urtësi dhe pastaj padishahët që ishin sulltanë të materiales dhe shpirtërores.

Njerëzimin e kanë drejtuar këto personalitete të mëdha, sepse njeriu mahnitet ndaj personaliteteve të mëdha ngaqë këtë e ka në natyrën e tij. Njerëzit kundrejt këtij karakteri dhe personaliteti që përhapën këta figura të mëdha, u joshën dhe ndjenë nevojën për t'i pasuar, për t'i ndjekur dhe për të ecur në gjurmët dhe rrugën e tyre.

Sikundër këtyre, edhe të poshtrit që preferuan të mbeshnin në vulgaritetin e dëshirave vetjake, kanë përjetuar dhe i kanë bërë edhe të tjerët të përjetojnë padrejtësitë dhe vuajtjet e mëdha të historisë duke ushqyer xhelozin dhe armiqësin kundrejt njerëzve të devotshëm.

Nisur nga ky këndvështrim, historia e njerëzimit

përbëhet nga historia e pejgamberëve dhe historia e luftës së ndjekësve të pejgamberëve me armiqtë e tyre.

Edukuesit më të mëdhenj të njerëzimit janë pejgamberët. Sulltani i pejgamberëve, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), i ka vënë vulën më të madhe në çdo aspekt historisë së botës. Rrezet e kandilit që ndezi në Hixhaz, në lindje arritën deri në Kinë e Indi, ndërsa në perëndim arritën deri në oqeanin Atlantik dhe malet Pirene të Francës. Në bazën e këtij ndikimi madhështor dhe të shpejtë sigurisht se gjendeshin personalitetet që i kishte edukuar dhe rritur i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte usvetun hasene / shembulli më i bukur.

“Rrezet e kandilit që ndezi në Hixhaz Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), në lindje





arritën deri në Kinë e Indi, ndërsa në perëndim arritën deri në oqeanin Atlantik dhe malet Pirene të Francës.”

Siç është shprehur edhe Imam Karafi, njëra prej mrekullive më të mëdha të Resulullahut (a.s.), e cila nuk kanë lënë nevojë për mrekulli të tjera, janë sahabët e nderuar e të zgjedhur të tij që i ka edukuar ai vetë. Ndërsa në pikën kulmore të sahabëve, të cilët përbënin kulmin e njerëzimit pas pejgamberëve, gjendeshin katër kalifët e drejtë që ishin miqtë e dashur të Pejgamberit.

Këta katër miq të dashur gjithmonë i kanë qendruar pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), përgjatë gjithë jetës. Edhe pasi Pejgamberi (a.s.), u shpërngul për në botën e përherëshme, ata e zëvendësuan atë në minber dhe atdheun Islam që arriti të përfshinte kontinentet e udhëhoqën sipas rregullave më të përpikta të drejtësisë. Këta heronj të Islamit të cilët bënë një jetë plotësisht askete dhe modeste veçanërisht pasi u bënë kalifë, të cilët preokupoheshin me problemet e kësaj bote dhe të botës tjetër të umetit të Muhamedit dhe të cilët e dorëzuan shpirtin njëri në gradën e sinqeritetit, tjetri dëshmor në krye të Kuranit Fisnik dhe dy të tjerët duke rënë dëshmorë në xhami, i sakrifkuan për këtë fe të vërtetë e të fundit fëmijët, pasurinë dhe jetën e tyre.



“Në bazën e këtij ndikimi madhështor dhe të shpejtë për përhapjen e Islamit sigurisht se gjendeshin personalitetet që i kishte edukuar dhe rritur i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte usvetun hasene / shembulli më i bukur.”

Ndjekja e rrugës së këtyre katër sahabëve të zgjedhur, të cilët u edukuan me një interesim të veçantë të të Dërguarit të Allahut, i është urdhëruar nga vetë Resulullahu (a.s.), të gjithë umetit:

“NDIQNI RRUGËN E ATYRE!”

Në hadithin fisnik thuhet:

“Ajo që duhet të bëni është që të kapeni pas sunetit tim dhe sunetit të Hulefau’rr-Rrashidin (kalifëve të drejtë) të cilët janë në rrugë të drejtë.” (Ebu Davud, Sunnet, 5/4607; Tirmidhi, Ilm, 16; Ibn Maxhe, Mukaddime, 6.)

Dijetarët dhe të urtët e rrugës së ehli sunetit që e kanë ndjekur këtë urdhër, e kanë konsideruar si një borxh besnikërie që duhet të paguhet duke ua transmetuar brezave të rinj jetën plot mësim dhe fjalët plot urtësi e njohuri të Ebu Bekrit, Omerit, Osmanit dhe Aliut. Ata kanë lënë vepra shumë të vlefshme në këtë fushë. Këto personalitete që emrat e tyre i shkruajmë në kubetë e faltoreve tona, janë si yje që do të na tregojnë rrugën në qiellin e zemrës sonë.

Dy prej këtyre personaliteteve të bekuara janë bërë hallka e dytë e zinxhirëve të artë që i ka formuar i Nderuari ynë dhe që vetë ishte hallka e parë. Secili prej tyre, si personalitete shumë të rëndësishme të memories sonë kombëtare dhe fetare me virtytet e larta dhe cilësitë e bekuara që përfaqësonin, gjenden në radhët e para ndërmjet emrave që populli ynë u vendos fëmijëve të vet.

Qëllimi ynë me këtë shkrim në të cilin do t’i shtjellojmë në mënyrë të përmbledhur Hulefau’rr-Rrashidin / Kalifët e Drejtë, është që t’i kujtojmë kalifët e drejtë të cilët ishin më afër Resulullahut (a.s.) dhe të cilët e gdhendën atë në formën më të bukur në personalitetin dhe jetën e tyre. Gjithashtu, që të bëhemi shkak për të nisur një udhëtim drejt të Nderuarit tonë duke u nisur prej tyre.

“Siç është shprehur edhe Imam Karafi, njëra prej mrekullive më të mëdha të Resulullahut (a.s.), e cila nuk kanë lënë nevojë për mrekulli të tjera, janë

sahabët e nderuar e të zgjedhur të tij që i ka edukuar ai vetë.”

I pari i kalifëve të drejtë ishte miku më i afërt i të Dërguarit të Allahut dhe mbajtësi i sekreteve të tij, Ebu Bekri (r.a.). Siç shprehet edhe Kurani:

“I DYTI I TË DYVE” EBU BEKRI (R.A.)

Ai arriti gradën Siddik (i sinqerti), me besimin, besnikërinë dhe sinqeritetin e palëkundshëm të tij. Siç ishte prej fatlumëve që e pranuan të parët ftesën e Islamit, e shpalli në një formë krejt tjetër sinqeritetin e tij duke thënë kundrejt talljeve të mushrikëve pas ngjarjes së miraxhit:

“Nëse ka thënë ai, është e vërtetë!”

Ai ishte i përkushtuar bashkë me fëmijët e tij në shërbimin ndaj Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.), në kohën kur organizonin atentate ndaj tij në Mekë. Pastaj arriti nderin për të qenë miku i ngushtë i Resulullahut (a.s.), në shpellën Theur përgjatë udhëtimit të hixhretit siç shprehet edhe ajeti fisnik “i dyti i të dyve”.

“Ndërsa në pikën kulmore të sahabëve, të cilët përbënin kulmin e njerëzimit pas pejgamberëve, gjendeshin katër kalifët e drejtë që ishin miqtë e dashur të Pejgamberit.”

Një ditë Pejgamberi (a.s.), tha:

“Nuk kam pasur dobi nga pasuria e askujt siç kam përfituar nga pasuria e Ebu Bekrit...”

Ndërsa Ebu Bekri (r.a.), filloi të derdhte lot kur i dëgjoi këto fjalë dhe tha:

“A nuk jemi unë dhe pasuria ime vetëm për ty, o i Dërguari i Allahut?!” (Ibn Maxhe, Fedailu As’habi’n-Nebi, 11.) Në këtë mënyrë u shpreh qartë se ia kishte dedikuar të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, veten dhe çdo gjë që posedonte.

Ebu Bekri (r.a.), përgjatë gjithë jetës së tij i shërbeu të Nderuarit tonë me jetën, pasurinë dhe fëmijët e tij. Ebu Bekri (r.a.), është gëzuar për Resulullahun, është mërëzitur për të dhe është shqetësuar për të. Në shpellën Theur, aty ku u realizua edhe udhëzimi shpirtëror, u shfaq edhe e fshehta e shoqërisë me të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Ebu Bekri (r.a.), tregon:

Kur isha bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në shpellë përgjatë udhëtimit të hixhretit, pashë këmbët e politeistëve që qëndronin mbi kokat tona dhe thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Nëse ndonjëri prej këtyre përkulet dhe sheh poshtë, patjetër që do të na shohin!”

Ndërsa Resulullahu (a.s.), më tha:

“Çfarë pandeh (dhe çfarë mendon) për dy vetë i treti i të cilëve është Allahu, o Ebu Bekr?” (Buhari, Tefsir, 9/9; As’habu’n-Nebi, 2; Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 1.)

Një pjesë e rëndësishme e myslimanëve të parë arritën nderin për t’u udhëzuar falë përpjekjeve të Ebu Bekr es-Siddikut. Ky i fundit, pasurinë që e kishte fituar me një tregti të ndershme dhe të pastër, e harxhoi duke i blerë dhe liruar robërit që rënkonin nën zullumin e pronarëve të tyre politeistë. Ajeti i mëposhtëm zbriti për ta lavdëruar këtë bujari të madhe të tij:

“Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit), Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit.” (Lejl, 5-7)

“Ebu Bekri i cili arriti një pozitë të pashoqe në bujari, ishte një hero i sinqertë, që i mbështetej Zotit dhe që mjaftohej me atë që kishte. Ai mund ta falte të gjithë pasurinë e tij kur ishte e nevojshme.”

Kur babai i tij, Ebu Kuhafe, i cili akoma nuk ishte nderuar me besimin Islam, e këshilloi të merrte skllëvër të fuqishëm që të paktën t’i kryenin ndonjë punë kur vuri re se biri i tij, Ebu Bekri po e harxhonte të gjithë pasurinë duke blerë skllëvër të dobët dhe të brishtë, Ebu Bekri (r.a.), iu përgjigj duke i thënë se nuk kishte asnjë qëllim tjetër përveçse kënaqësinë e Allahut Teala. Edhe kjo përgjigje u lavdërua si më poshtë në ajetin fisnik:

“Do të mbahet larg tij (zjarrit) më i devotshmi (që ruhet nga gjynahet), që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten dhe duke mos pritur shpërbllim prej dikujt tjetër për këtë, por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit. Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!” (Lejl, 17-21) (Sujuti, Lubabu’n-Nukul, II, 198.)

Ebu Bekri i cili arriti një pozitë të pashoqe në bujari, ishte një hero i sinqertë, që i mbështetej Zotit dhe që mjaftohej me atë që kishte. Ai mund ta falte të gjithë pasurinë e tij kur ishte e nevojshme. Ai kishte arritur deri në atë pikë të faljes dhe mëshirës sa që nuk ua ndërpreu ndihmën as njerëzve që iu përzie emri në shpifjen që hipokritët ia bënë vajzës së tij, Aishes, e cila ishte monumenti i nderit.

Ebu Bekri para se të bëhej kalif i milte delet e vajzave jetime që gjendeshin në vend. Gjithashtu u plotësonte edhe nevojat e tyre. Pasi u bë kalif, fqinjët e tij filluan të mendonin:

“Tashmë është bërë kalif i madh. Me shumë

mundësi nuk mund t'i mjelë më delet e jetimeve për shkak se do t'i shtohen preokupimet dhe do t'i ndryshojnë kushtet e jetës.” Por asgjë nuk ndryshoi. Ai me të njëjtën modesti vazhdoi t'ua milte delet vazhaze jetime dhe t'ua plotësonte nevojat. (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 80; Sariçam, Ebu Bekri, fq. 82.)

“Ebu Bekri kishte arritur deri në atë pikë të faljes dhe mëshirës sa që nuk ua ndërpreu ndihmën as njerëzve që iu përzie emri në shpifjen që hipokritët ia bënë vazhës së tij, Aishes, e cila ishte monumenti i nderit.”

Ebu Bekri (r.a.), gjithmonë ishte i pari në veprat e mira dhe çështjet e bamirësisë:

GJITHMONË MË PËRPARA

Në hadithin fisnik është dhënë përgëzimi se Ebu Bekr es-Siddiku do të ftohet nga të gjitha dyert e xhenetit për shkak të natyrës fisnike të tij që nuk ngopej me vepra të mira. Edhe llagapi Ebu Bekr thuhet se i është vendosur ngaqë ishte i pari në çdo punë të mirë dhe ngaqë rendte në bamirësi më para se të gjithë.

Ebu Bekri (r.a.), përjetonte një afrimitet krejt tjetër dhe një gjendje privatësie të fshehtë me Pejgamberin tonë të Nderuar (a.s.). Ai merrte një frymëzim aq të madh nga i Nderuari ynë sa që asnjë sahab nuk arrinte ta merrte dot. Këtë gjendje e tregon Omeri (r.a.), i cili një ditë dëshmoi bisedën e tij me Resulullahun (a.s.):

“Shkova te i Dërguari i Allahut (a.s.). Ai po bisedonte me Ebu Bekrin rreth dijes së tevhidit. U ula ndërmjet tyre. Nuk kuptova asgjë prej fjalëve të tyre sikur të isha dikush që nuk dinte aspak arabisht. Andaj e pyeta:

“Ç’është kjo gjendje kështu? A kështu bisedoni gjithmonë me Pejgamberin (a.s.)?”

Ebu Bekri, radijall-llahu anh, mu përgjigj:

“Po nganjëherë kur jemi vetëm për vetëm me Resulullahun (a.s.), bisedojmë në këtë mënyrë.”

“Ebu Bekri (r.a.), para se të bëhej kalif i milte delet e vazhaze jetime që gjendeshin në vend dhe u

plotësonte atyre edhe nevojat e veta. Edhe pasi u bë kalif, vazhdoi t'i milte delet e vazhaze jetime.”

Pejgamberi ynë i Nderuar në namazin e fundit që frekuentoi në Mesxhidu'n-Nebevi, e nxori imam Ebu Bekrin. Kur Ebu Bekri (r.a.), u zgjodh kalif pasi ndërroi jetë Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), u mbajti një fjalim njerëzve me një modesti dhe thjeshtësi të madhe:

“O njerëz! Jam zgjedhur kalif i juaji edhe pse nuk jam më i miri prej jush. Nëse e kryej detyrën me përkushtim, më ndihmoni. Nëse veproj gabim, më tregoni rrugën e drejtë...” (Ibn Sa'd, III, 182-183; Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 69, 71-72; Hamidullah, Pejgamberi i Islamit, II, 1181.)

Në fakt Ebu Bekri ishte njeriu më i virtytshëm ndërmjet sahabëve pas Pejgamberit (a.s.), por ai jetonte me modesti dhe dinjitet, në mënyrë që të përfshihej nga ajeti fisnik në të cilin thuhet:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...” (Furkan, 63)

“Ebu Bekri (r.a.), ka thënë: Nëse besimi mbetet vetëm nëpër xhami (nuk reflektohet në jetë), pasuria mbetet në duart e koprracëve, armët në duart e frikacakëve dhe autoriteti në duart e të dobëtëve, prishen punët.”

Ebu Bekri (r.a.), edhe pse gjithmonë gjendej pranë Pejgamberit kur ishte gjallë, prapë se prapë gjithmonë përmllohej për të.

GJITHMONË E MERRTE MALLI PËR TË

Ndërsa pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.), për shkak të kësaj ndarjeje atij iu shtua edhe më shumë mallëngjimi për ta takuar atë.

Aishja (r.anha), e tregon si më poshtë entuziazmin e takimit që ndjente ndaj Pejgamberit babai i saj përgjatë momenteve të vdekjes:

“Kur babai im, Ebu Bekri (r.a.), dergjej i sëmurë, pyeti:

“Çfarë dite është sot?” Ne i thamë:

“E hënë.” Ai na tha:

“Nëse vdes sonte, mos më lini për nesër, sepse dita dhe nata më e dashur për mua është ajo që



është më e afërt me Resulullahun (a.s.). (Dome-
thënë, momenti më i afërt kur do ta takoj atë.)”
(Ahmed, I, 8.)

Një buqetë nga fjalët e këtij personaliteti monu-
ment bujarie, besnikërie dhe mallëngjimi që u edu-
kua nga Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut
(a.s.):

“Katër persona janë prej robërve të devotshëm
të Allahut:

1. Ai që gëzohet kur sheh dikë që pendohet (duke
marrë kënaqësi nga hyrja e tij në rrugën e shpë-
timit).

2. Ai që i lutet Zotit për faljen e mëka-
tarëve. (Kjo është shenja dhe horizonti i
mëshirës që duhet ta posedo-
jë një besimtar.)

3. Ai që lutet për vëllain në
fe. (Ai që nuk mbart urrejtje,
ftohtësi dhe mëri në zemër
kundrejt askujt.)

4. Ai që e ndihmon dhe i
shërben atij që ka më shumë
nevojë. (Ai që i percepton
si amanet mirësitë që ia ka
dhënë Allahu Teala dhe që
mbart vetëdijen për të bërë
infak edhe ndaj krijesave të
tjera.)”

“Më i fuqishmi i juaj te unë
është i dobëti derisa të marrë
të drejtën e vet. Më i dobëti
i juaj te unë është i fuqishmi
derisa t’i merret e drejta që ia
ka uzurpuar dikujt tjetër.”

“Nëse besimi mbetet vetëm
nëpër xhami (nuk reflektohet
në jetë), pasuria mbetet në
duart e koprracëve, armët në
duart e frikacakëve dhe autoriteti në duart
e të dobëtëve, prishen punët.”

“Mendohu mirë se çfarë thua, kur e thua dhe
kujt ia thua!”

“Mos u lavdëroni! Çfarë dobie ka që të lavdërohet
njeriu i cili është krijuar nga dheu dhe të cilin do ta
hanë krimbat e insektet kur të kthehet në dhe!”

“Rregullo veten, në mënyrë që njerëzit të sillen
mirë ndaj teje!”

“Ebu Bekri (r.a.), ka thënë: Mendohu mirë se çfarë
thua, kur e thua dhe kujt ia thua!”

“Ik prej famës, në mënyrë që të të ndjekë nde-
ri.”

“Ebu Bekri (r.a.), ka thënë: “Mos u lavdëroni!
Çfarë dobie ka që të lavdërohet njeriu i cili është
krijuar nga dheu dhe të cilin do ta hanë krimbat e
insektet kur të kthehet në dhe!”

“Përgatitu kundrejt vdekjes, në mënyrë që të të
jepet jeta e përhershme.”

“Allahu Teala në Kuranin Fisnik shpërblimin që
do ta japë e ka përmendur bashkë me ndëshkimin,
në mënyrë që robit t’i shtohet dëshira për ibadet
dhe të ketë frikë nga ndëshkimi.”

Sa shfaqje e bukur e edukimit plot fry-
mëzim dhe përshtirshmëri të të Dërguarit
të Allahut (a.s.), është i dyti
i Kalifëve të Drejtë, Omeru’l-
Faruku! Ndërmjet dy gjendje-
ve para dhe pas këtij edukimi
u lartësua;

NGA BATAKU I INJORANCËS TE GRADA E FARUKUT: OMERI (R.A.)

Ndërkohë që ishte një per-
son i vrazhdë dhe zullumqar
në errësirën e injorancës para
se të ndriçohej me dritën e
udhëzimit, mori lutjen e Re-
sulullahut për udhëzim dhe
sytë e zemra filluan t’i hape-
shin ndaj dritës së Islamit për
shkak të ndikimit të Kuranit
Fisnik që e dëgjoi në shtëpi-
në e motrës së tij në të cilën
hyri plot zemërim. Biri vrasës
i xhahilijetit, Omeri, tashmë u
shndërrua në Omerin (r.a.), të
cilit sytë i rridhnin lot, zem-

rën e kishte të butë dhe që qëndronte plot
modesti e përlulje në audiencën e Zotit (xh.

xh.).

Omeri (r.a.), i cili u përngjas me Musain nga Kre-
naria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ngaqë kishte
një karakter të ashpër dhe strukturë fizike të fortë,
posedonte një mendje, largpamësi dhe gjenialitet
që u zhvilluan me shpalljen hyjnore. Si një njeri
që merrte frymëzim hyjnor, shpesh herë shprehjet
e tij ishin në përputhje me ajetet e Kuranit Fisnik.
Resulullahu (a.s.), ka thënë duke e shprehur këtë:

“Në umetet që kanë jetuar para jush ka pasur

*“Falënderimi i takon
Allahut i Cili ka krijuar
njerëz ndërmjet jush
dhe prej sahabëve të
Muhamedit (a.s.), të
cilët do të më tregojnë
rrugën e drejtë nëse më
shohin duke bërë
ndonjë gabim.”*

njerëz që u vinte frymëzim. Nëse ka ndonjë prej atyre në umetin tim, padyshim se ai është Omeri.” (Buhari, As’habu’n-Nebi, 6)

Fakti që dallohej në përkthimin e të vërtetës, u bë shkak që t’i jepej llogajti “Faruk”, domethënë ndarësi i të vërtetës nga e pavërteta, i të mirës nga e keqja dhe i të drejtës nga e gabuara.

“Omeri (r.a.), i cili u përngjas me Musain nga i Nderuari ynë (a.s.), ngaqë kishte një karakter të ashpër dhe strukturë fizike të fortë, posedonte një mendje, largpamësi dhe gjenialitet që u zhvilluan me shpalljen hyjnore.”

Gjendja e vrazhdë dhe zemërimi i këtij njeriu të bekuar prej të cilit shejtani ndërronte rrugën kur e shihte, dhe gjuhës e zemrës së të cilit i ishte dhënë e vërteta, siç shprehet edhe Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ishin vetëm kundrejt armiqve të Allahut Teala. Ndërsa kundrejt të vërtetës shfaqte menjëherë bindje e nënshttrim qoftë edhe ndaj një shenje të Resulullahut, lëreni më ndaj një urdhri të Allahut apo të të Dërguarit të Tij.

Kjo ngjarje që e transmeton Ahmed ibn Hanbeli është ndër dëshmitarët më të mirëfilltë të atyre që thamë më sipër:

NJË PREJ SHEMBUJVE TË PANUMËRT TË BESNIKËRISË...

Omeri (r.a.), një ditë po shkonte në namazin e xhumasë në periudhën e kalifatit të tij. Kur po kalonte pranë murit të shtëpisë së Abbasit (r.a.), dy pika uji të pista ranë në pelerinën e Omerit nga olluku i çatisë (me shumë mundësi për shkak të pastrimit).

“Në umetet që kanë jetuar para jush ka pasur njerëz që u vinte frymëzim. Nëse ka ndonjë prej atyre në umetin tim, padyshim se ai është Omeri.” (Buhari, As’habu’n-Nebi, 6)

Kalifi u mërzi, e kapi ollukun me dorë dhe e hodhi poshtë, në mënyrë që të mos pikonte edhe mbi të tjerët. Pastaj e ndërroi pelerinën dhe shkoi në xhami.

Ai e ceku këtë ngjarje në hytben e xhumasë që e mbajti dhe e paralajmëroi xhematin duke thënë:

“O njerëz! Po bëni gjëra të gabuara. Kur po vija, po kaloja pranë filan muri. Nga një olluk më pikoi papastërti. Edhe unë e shtyva me dorë dhe e hodha poshtë atë olluk.” Akoma pa e mbaruar fjalën, Abbasi u hodh nga vendi dhe i tha:

“O Omer! Çfarë ke bërë kështu? Unë e kam parë me sytë e mi. Atë olluk e ka vendosur i Dërguari i

Allahut (a.s.), me duart e veta.”

Omeri mbeti i ngrirë në minber. Si mund ta prish-te ai diçka që e kishte vendosur vetë i Dërguari i Allahut (a.s.)? E mblodhi veten menjëherë dhe i tha Abbasit (r.a.):

“Pasha Allahun, unë do ta vendos kokën në fund të atij muri. Ti do ta vendosësh këmbën mbi kokën time, do të hipësh dhe do ta vendosësh në vend atë olluk...” Ai e kompensoi gabimin e tij duke vepruar ashtu siç tha. (Shik. Ahmed, I/210; Ibnu’l-Xhevzi, Sifatu’s-Safve, 1/285.)

Nga ana tjetër Omeri ishte shumë largpamës dhe kishte shikim të mprehtë në mbrojtjen e fesë. Omeri (r.a.), i cili lavdërohej nga Pejgamberi ynë i Nderuar si një derë që nuk u jepte mundësi përçarjeve, kur përgjatë kohës së kalifatit të tij vuri re se një pemë që mendohej se ishte pema nën të cilën Resulullahu (a.s.) dhe sahabët kishin dhënë besën para marrëveshjes së Hudejbijes, vizitohej nga njerëzit dhe pothuajse madhërohej, urdhëroi që të pritej, në mënyrë që t’i ndalonte injorantët të cilët mund të kaploheshin nga mendimi se ajo ishte e shenjtë.

Drejtesia e pashoqe ishte njëra prej cilësive më të rëndësishme të kalifatit të Omerit, i cili dridhej prej frikës ndaj Allahut dhe që jetonte në asketizëm edhe pse kishte arritur gradë të lartë shpirtërore dhe ishte përgëzuar me xhenet nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Udhëheqësi i besimtarëve i cili u emërtua Omeru’l-Adl që do të thotë “Omeri është vetë drejtësia”, e ndjente veten përgjegjës qoftë edhe për një dele që mund ta hante ujku buzë lumit Tigër.

Pasi Omeri (r.a.), erdhi në krye të detyrës, vazhdimisht ishte i brengosur dhe i shqetësuar prej barrës së rëndë të përgjegjësisë. Kur Hudhejfe (r.a.), e pa atë në këtë gjendje dhe e mësoi shkakun, i tha:

“A kjo është gjëja që të brengos? Pasha Allahun, nëse do të të shohim duke bërë ndonjë gjë të gabuar, do të të tregojmë rrugën e drejtë.”

Kalifi u gëzua shumë për këtë. Hudhejfen (r.a.), e urdhëroi ta përsëriste fjalën duke iu betuar dhe pastaj e falënderoi Zotin (xh.xh.), duke thënë:

“Falënderimi i takon Allahut i Cili ka krijuar njerëz ndërmjet jush dhe prej sahabëve të Muhamedit (a.s.), të cilët do të më tregojnë rrugën e drejtë nëse më shohin duke bërë ndonjë gabim.” (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VIII, 154.)

“Hudhejfe (r.a.), i tha Omerit i cili shqetësohej për shkak të përgjegjësisë së udhëheqjes: “Pasha Allahun, nëse të shohim duke bërë ndonjë gabim, do të të tregojmë rrugën e drejtë.” Kalifi u gëzua

shumë për këtë.”

Kur shkoi në Sham bashkë me skllavin e tij, në deve hipën me radhë. Kur hynë në qytet, ai hyri në këmbë krahas të gjitha insistimeve të skllavit, sepse radhën e kishte skllavi. Kjo kaloi në histori si shembulli i një drejtësie, modestie, altruizmi dhe vëllazërie të veçantë. Përgjatë natës rendte nëpër rrugët e Medinës me thasët e ushqimeve në kurriz për t'i ndihmuar të varfrit dhe skamnorët.

“Omeri (r.a.), ka thënë: “Atij që i lë fjalët e tepërta i jepet urtësi. Atij që e lë shikimin e tepërt (me spiunim), i jepet modesti në zemër. Atij që e lë të ngrënët e tepërt, i jepet kënaqësia për ibadet.”

Në periudhën e Omerit shteti Islam u zgjerua deri në kufijtë e Irakut, Shamit dhe Egjiptit. U morën plaçka lufte me sasi të mëdha. Por kalifi pati pranuar të merrte nga thesari vetëm një sasi sa për të jetuar, sepse ai me çdo gjë që posedonte ishte në gjurmët e të Dërguarit të Allahut dhe të Ebu Bekrit;

NË RRUGËN E DY MIQVE

Jetën e vazhdonte në vështirësi. Nganjëherë gjysmë i ngopur dhe nganjëherë gjysmë i uritur.

Sahabëve të mëdhenj u erdhi keq për këtë gjendje të kalifit. Ata dëshironin t'ia shtonin rrogën. Por ata e kishin shumë të vështirë që t'i flisnin për këtë çështje dhe ta bindnin. Për këtë arsye, e lutën nënën tonë Hafsën, e cila ishte bashkëshortja e Pejgamberit tonë të Nderuar dhe në të njëjtën kohë edhe vajza e Omerit, që t'i fliste babait të saj për këtë propozim. Hafsa (r.anha), i foli babait të saj për propozimin e sahabëve të cilët dëshironin t'ia ngrenin rrogën si udhëheqës dhe ta shpëtonin nga vështirësia.

Nisur nga kjo, Omeri (r.a.), i kujtoi vajzës së tij, Hafsës, ditët e kaluara duke e pyetur:

“Bijë! Si e kishte gjendjen Resulullahu në të ngrënë, në të pirë dhe në veshje?”

Nëna jonë, Hafsa iu përgjigj:

“Aq sa i mjaftonte.” Pasi Omeri mori këtë përgjigje, ia shpjegoi asaj me këtë shembull të bukur urtësinë e të jetuarit në nevojë duke i thënë se kishte për qëllim pasimin e të Dërguarit të Allahut dhe paraardhësit të tij Ebu Bekrit:

“Dy miqtë e mi dhe unë u ngajmë tre udhëtarëve që ecin në të njëjtën rrugë. I pari ynë e arriti qëllimin. Edhe tjetri shkoi te i pari duke ecur në të njëjtën rrugë. Ndërsa unë si i treti dëshiroj të shkoj te miqtë e mi. Nëse shkoj me shumë barrë, nuk mund t'i arrij ata! Apo ti nuk dëshiron që të jem udhëtari i tretë i kësaj rruge?” (Shehbenderzade

Ahmed Hilmi, Historia Islame, vëll. I, fq. 367.)

Më në fund edhe ai e përfundoi jetën e tij të bardhë e pa asnjë njollë në gjurmët e dy miqve të vet me një fund të mrekullueshëm duke rënë dëshmor. Pastaj u varros në Ravzatu'l-Mutahhara pranë dy miqve të tij.

Sa shumë të urta janë fjalët e këtij sahabi të madh i cili ishte si një shpatë e mprehtë që e ndante të vërtetën nga e gabuara falë frymëzimeve hyjnore që i vinin:

“Atij që i lë fjalët e tepërta i jepet urtësi.

Atij që e lë shikimin e tepërt (me spiunim), i jepet modesti në zemër.

Atij që e lë të ngrënët e tepërt, i jepet kënaqësia për ibadet.

Atij që e lë të qeshurin e tepër, i jepet madhështi.

Atij që e lë shakanë, i jepet krenari.

Atij që e lë dashurinë ndaj kësaj bote, i jepet dashuria ndaj botës së përtejme.

Atij që e lë preokupimin me gabimet e tjetrit, i jepet gjendja për të rregulluar gabimet e veta.

“Omeri (r.a.), ka thënë: “Atij që e lë të qeshurin e tepërt, i jepet madhështi. Atij që e lë shakanë, i jepet krenari. Atij që e lë dashurinë ndaj kësaj bote, i jepet dashuria ndaj botës së përtejme.”

Atij që e lë kërkimin në lidhje me natyrën e Allahut (i Cili është përtej perceptimit) dhe spiunimin, i jepet shpëtimi nga hipokrizia.

Njeriu që e dua më shumë është ai që më tregon për gabimet dhe mangësitë e mia.” (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, 30.)

“Omeri (r.a.), ka thënë: “Atij që e lë preokupimin me gabimet e tjetrit, i jepet gjendja për të rregulluar gabimet e veta.”

Omeri iu përgjigj si më poshtë atyre njerëzve që nuk punonin, që ishin dembelë dhe që pastaj thoshin: “Ne jemi njerëz që i mbështetemi Zotit.”:

“Ju jeni njerëz që nuk i besoni Allahut, por pasurisë së të tjerëve. Njeriu që i mbështetet Zotit me të vërtetë është ai që e hedh farën në tokë dhe pastaj i bindet Allahut.” (Ibn Rexheb, Xhamiu'l-Ulum.)

“Njeriut mos i shikoni namazin që e fal dhe agjërimin që e mban. Por shikoni nëse thotë të vërtetën kur flet, nëse e mban amanetin kur i jepet ndonjë gjë amanet dhe nëse bën kujdes ndaj hallallit e haremit kur priret ndaj kësaj bote!” (Bejhaki, Sunenu'l-Kubra, VI, 288; Shuab, IV, 230, 326.)

Dikush po e lavdëronte dikë tjetër në prani të

Omerit. Omeri (r.a.), i bëri atij tri pyetje:

- a) A ke udhëtuar ndonjëherë me të?
- b) A ke bërë ndonjë tregti apo ndonjë punë tjetër shoqërore me të?
- c) A e ke fqinj?

Kur personi u dha përgjigje “jo” të tria pyetjeve, Omeri i tha:

“Betohem në Allahun, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër, ti nuk e njeh atë!” (Gazali, Ihja, III, 312.)

Kadi Shurajhi i shkroi letër Omerit dhe e pyeti se si të gjykonte. Omeri (r.a.), iu përgjigj duke i thënë:

“Gjyko ndërmjet atyre me librin e Allahut. Nëse nuk e gjen aty (dispozitën), gjyko me sunetin e të Dërguarit të Allahut. Nëse nuk e gjen as në librin e Allahut, as në sunetin e Resullullahut, gjyko me dispozitat që kanë gjykuar të devotshmit. Nëse nuk gjendet ndërmjet gjykimeve që kanë dhënë të devotshmit, atëherë, nëse dëshiro, mund të gjykosësh vetë, nëse dëshiron, mund të mos gjykosësh! Mendoj se do të ishte më mirë për ty nëse nuk do të gjykoje, vesselam...” (Nesai, Kudat, 11-3.)

“Mos i vishni gratë me rroba shumë të bukura. Nëse ndonjëra prej tyre ka rroba dhe stoli shumë të bukura, i pëlqen të dalë jashtë.” (Ibn Xhevzi, Menakib)

“Për t’i rregulluar njerëzit, së pari duhet të rregulloni veten tuaj. Njeriu më injorant është ai që e shet ahiretin e vet për dynjanë e të tjerëve.”

“Ji i fuqishëm pa shfaqur vrazhdësi dhe ji i butë pa shfaqur dobësi!”

“Omeri (r.a.), ka thënë: “Për t’i rregulluar njerëzit, së pari duhet të rregulloni veten tuaj. Njeriu më injorant është ai që e shet ahiretin e vet për dynjanë e të tjerëve.”

Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve që të përfitojmë nga Kalifët e Drejtë dhe nga jeta e tyre plot urtësi për sa i përket njohjes së Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.) dhe pasimit të

tij me dashuri e besnikëri!

Zoti (xh.xh.), na bëftë prej atyre që reflektojmë fytyrën e bukur të Islamit me dijen, urtësinë, bujarinë, drejtësinë, modestinë dhe të gjitha cilësitë e tjera të bukura duke përhapur karakterin dhe personalitetin (Islam)!

vijon numrin tjetër...

“Njeriut mos i shikoni namazin që e fal dhe agjërimin që e mban. Por shikoni nëse thotë të vërtetën kur flet, nëse e mban amanetin kur i jepet ndonjë gjë amanet dhe nëse bën kujdes ndaj hallallit e haramit kur priret ndaj kësaj bote!”



PËR NJË VATËR FAMILJARE TË GËZUAR

— Halil Ibrahim Kuruxhan —

Po jetojmë në një kohë, në të cilën po shkatërrohet koncepti i familjes. Perëndimi ka arritur një gjendje, ku nuk flitet aspak për konceptin e familjes. Edhe në botën islame, përditë na del përballë ekzistenca e dhimbjeve të brendshme të familjes me plot shembuj negativë. Ndërkohë që shembujt e familjes së gëzuar e të qetë të një kohe shumë të afërt, përjetoheshin ndërmjet myslimanëve me të gjithë bukurinë e tyre. Çfarë ka ndodhur që vatrat tona familjare të qeta, kanë filluar të marrin plagë?

Prof. Dr. M. Jashar Kandemiri, me veprën e tij “Për një vatër familjare të gëzuar”, na rikujton rëndësinë e familjes, që është guri themelor më i rëndësishëm i shoqërisë.

Nëse e përmbledhim librin, që profesori i nderuar, Jashar Kandemiri e ka përgatitur me eksperiencën e

viteve, shohim se na rikujton urdhrat dhe këshillat e Allahut Teala, i Cili na njeh më mirë se sa njohim ne veten tonë dhe të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, që janë të domosdoshme për një vatër familjare të gëzuar. Libri është përgatitur me mënyrën e ngrohtë të Prof. Kandemirit dhe në një format që mund ta lexojë lehtë çdo njeri nga çdo shtresë. Ai përbëhet nga dy pjesë.

Në pjesën e parë shtjellohen parimet që duhen zbatuar për një vatër familjare të gëzuar, duke filluar që me procesin e zgjedhjes së partnerit. Në pjesën e dytë shtjellohet jeta familjare e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, me të gjitha detajet, në mënyrë që të jetë shembull për ne në të gjitha aspektet.

Njëra prej temave që shtjellohet më shumë apo

ndoshta më e rëndësishmja, është tema e njeriut model, i cili ka arritur përsosmërinë dhe kënaqësinë e Allahut Teala. Për këtë arsye, çështja e njeriut të përsosur në traditën islame mori formën e doktrinës pas Ibn Arabiut. Në këtë mënyrë, u botuan libra vetëm për këtë temë, me titull “Insani Kamil”.

Edhe libri me titull “Njeriu i përsosur në mendimin mistik”, i Doç. Dr. Isa Çelikut, është një studim i vazhdimtë të kësaj tradite. Libri përbëhet nga hyrja dhe tri pjesë. Në hyrje janë shtjelluar konceptet “njeri” dhe “përsosmëri”, nën dritën e Kuranit e sunetit. Në pjesën e parë është shtjelluar tema e njeriut të përsosur në mendimin e mistikës, gradat e njeriut të përsosur, cilësitë e njeriut të përsosur dhe konceptet themelore, bashkë me nënpikat e tyre në lidhje me njeriun e përsosur. Ndërsa në pjesën e dytë, janë shpjeguar lidhjet e njeriut të përsosur me Allahun Teala, me shoqërinë dhe me gjithësinë.

Në pjesën e vlerësimit dhe të përfundimit janë shtjelluar disa zbulime dhe vlerësime të rëndësishme.

“**Jam Kureshtar për xhenetin**”. Ne jetojmë në një botë, në të cilën “çdo gjallesë do ta shijojë vdekjen”.

Askush nuk ka mundësi të ikë prej gjërave që do të përjetohej në momentet e vdekjes dhe pas saj. Për këtë arsye, pyetjet që kanë të bëjnë me vdekjen dhe jetën e ahiretit, e kanë shqetësuar gjithmonë mendjen e njerëzve. Po pyetjeve të fëmijëve në lidhje me vdekjen dhe me gjendjen pas saj, si duhet t’u përgjigjemi? Si mund t’u përgjigjemi me një gjuhë që e kuptojnë ata?

Libri i pestë i serialit “Jam kureshtar” të Ežkan Eže-tit, titullohet “**Jam kureshtar për xhenetin**” dhe u përgjigjet pyetjeve rreth vdekjes dhe ahiretit. Edhe në këtë vëllim, si në të gjitha vëllimet e tjera, me një gjuhë që mund ta kuptojnë fëmijët, u jepet përgjigje pyetjeve për të cilat fëmijët janë kureshtarë, por që prindërit e kanë të vështirë t’u përgjigjen. Ja disa prej pyetjeve, që u jepet përgjigje në këtë libër:

Çfarë është vdekja? A është i mirë apo i keq Azraeli? Çfarë na ndodh kur vdesim? Çfarë bote është bota e varrit? Si shpërthen kiameti? Si do të ringjallemi? Çfarë vendi është ahireti? Çfarë do të ndodhë në Mahsher? Si do të peshohen mirësitë? Si kalohet në urën e Siratit? Çfarë vendi është xheneti?

DITËT E SYRGJYNOSJES SË SULLTAN ABDYLHAMITIT II

Seria e kujtimeve të Botimeve Timash, vazhdon me librin “**Ditët e syrgjynosjes së Sulltan Abdylhamitit II.**” Z. Atif Hysejini, i cili i ka shkruar këto kujtime, është një doktor i obliguar nga qeveria e Bashkimit dhe Progresit për të bërë doktoraturën e veçantë nga koha kur Abdylhamiti u sërgjynos në Selanik e deri kur ndërroi jetë në Sarajën e Bejlerbejit.

Z. Atif Hysejini ka mbajtur ditar përgjatë viteve që është interesuar me Sulltan Abdylhamitin. Ky ditar, që është dymbëdhjetë vëllime dhe përfshin afërsisht nëntë vjet, nxjerr në dritë të dhëna shumë të veçanta në lidhje me Sulltan Abdylhamitin.

Ditarët që ka përgatitur Prof. Dr. Metin Hylagy, duke i marrë nga Arikivi i Institucionit të Historisë Turke dhe të cilët kanë kaluar në literaturë si njëri prej burimeve më të besueshme në lidhje me Abdylhamitin, japin të dhëna të rëndësishme në lidhje me sëmundjet e Abdylhamitit, për ilaçet e tij, për mënyrat e mjekimit që ka përdorur kundër sëmundjeve dhe, veçanërisht, për mënyrat e mjekimit bimor që ka përdorur. Mbi të gjitha, nxjerrin në pah jetën private të Abdylhamitit, strukturën e mendimit e të besimit, ndjenjat, dashuritë, urrejtjet, personalitetin, kujtimet, që kanë të bëjnë më shumë me vendet evropiane dhe qasjet e tij personale e politike.



MBRUJTJA ME KURAN

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu Teala thotë:

“Sa për ata që u udhëzuan me udhëzimin hyjnor, (sa më shumë të dëgjojnë Kuran) Allahu u jep sukses dhe ua shton udhëzimin. Atyre u jep devotshmëri e vetëpërmbytje.” (Muhamed, 17.)

Domethënë se hipokritët dëgjojnë Kuran, por nuk përfitojnë prej tij. Ndërsa atyre që Allahu Teala i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, përkundrazi, ua shton edhe më shumë udhëzimin, sepse kurdo që dëgjojnë Kuran, përpigën për ta mësuar kuptimin e tij dhe besojnë me sinqeritet duke u bindur se ai (Kurani) është i vërtetë. Allahu i Madhëruar u jep devotshmëri zemrave të tyre. Si rezultat i kësaj devotshmërie që u jep në zemër Allahu Teala, ata përpigën t’i zbatojnë urdhrat e Kuranit Fisnik dhe largohen prej ndalesave të tij.

Nisur nga kjo, kushdo që e ka të dobët devotshmërinë në zemër, domethënë ka pak frikë nga Allahu i Madhëruar, e ka të dobët edhe zbatimin e urdhrave të Allahut të Lartësuar. Si rezultat, bën shumë lëshime dhe nuk largohet aq shumë nga haramet.

Baza e devotshmërisë është zbatimi i të gjitha urdhrave hyjnorë dhe largimi në mënyrë kategorike nga të gjitha haramet që Allahu Teala i ka ndaluar.

Ato që ua shtojnë besimin besimtarëve janë Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (s.a.s.).

Në suren el-Ankebut, thuhet:

“Ata që luftojnë për të ndihmuar fenë Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Më të vërtetë, ndihma e Allahut është me muhsinët / punëmirët!” (el-Ankebut, 69.)

Siç shpjegohet edhe në Tefsirin Hazin ue Medarik, synimi me fjalën muxhadele (luftë), sipas një kuptimi është përpjekja dhe munda për të kërkuar dije. Nisur nga kjo, kuptimi i ajetit është: “Ata që përpigën dhe mundohen për të marrë dituri, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt rrugës së dijes. Më të vërtetë, ndihma e Allahut është me punëmirët!”



Sipas një kuptimi tjetër, fjala muxhadele do të thotë zbatim i sunetit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), veprim me dijen e marrë dhe pendimin e bërë për mëkatet.

Sipas Fahri Raziut, kuptimi i ajetit është ky: “Ata që bazohen në argumentet të cilat vërtetojnë njësimin e Zotit dhe përpigën të meditojnë mbi to, me të vërtetë do t’i udhëzojmë në besimin e drejtë.”

Muhsinët / vepërmirët janë ata që i kryejnë ibadetet sipas rregullave të shariatit.

Enesi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë në një hadith kudsij:

“Allahu Teala ka thënë: ‘Nëse robi më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një krah. Nëse më afrohet një krah, Unë i afrohem një pash. Nëse vjen te Unë duke ecur, Unë shkoj te ai duke vrapuar.’ (Buhari)

Në ajetet fisnike, thuhet:

“...Allahu ia udhëzon zemrën kujtdo që i beson Atij...” (et-Tegabun, 11.)

“...Atij që bën vepër të mirë, Ne do t’ia shtojmë shpërblimin. Allahu, me të vërtetë, është Falës dhe Mirënjohës.” (esh-Shura, 23.)

“Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.” (esh-Shura, 20.)

SA BUKUR ËSHTË TË DUASH

— Sadik Dana —

Imam Buhari, rahimehullah, thotë: “Ndërmjet lajmeve që na kanë ardhur është edhe lajmi që Allahu Teala i ka shpallur Xhebrailit, alejhi’s-selam dhe i ka thënë: ‘O Xhebrail! Çfarë do të bëje sikur të të dërgoja në dynja dhe të të bëja prej banorëve të saj?’ Xhebraili, alejhi’s-selam, u përgjigj: ‘Ti e di gjendjen time më mirë se unë, o Zot! Por sikur të isha prej banorëve të dynjasë, do përpiqesha të bëja këto tri vepra: **E para**, do të ndihmoja ata që janë bërë me familje dhe e kanë të vështirë të sigurojnë të ardhura për të. **E dyta**, do t’i vija detyrë vetes t’ua mbuloja mëkatet dhe gabimet njerëzve, që të mos i shikonte askush përveç Teje. **E treta**, do t’u jepja ujë të eturve.”

Aq sa t’i japësh një robi për të pirë nga dashuria jote, atë do edhe Zoti. Domethënë, për të dashur një njeri, është farz të duhet Zoti. Lum për atë që e do Zotin, që ia di vlerën kësaj dashurie, e cila i është dhënë dhe e vlerëson. Vetëm robërit që i do Allahu Teala, e arrijnë përsosmërinë. Zoti ua ka hequr nga zemrat e tyre çdo lloj dëshire për këtë botë. Për këtë arsye, ata duan vetëm Atë. Ata që duan Atë, arrijnë çdo qëllim. Ata janë zhytur në shpresën që kanë te Ai dhe zemrat e tyre i kanë të pushtuara vetëm nga Ai. Në këtë mënyrë, në zemrat e tyre gjen vendosmëri vetëm dashuria ndaj Allahut Teala. Pastaj, këto zemra u kthehen në një det dhe thesar të paçmueshëm.

O Zot! Mos na privo nga mirësia e dashurisë, sepse çdo gjë gjelbëron, gjallëron dhe forcohet me dashurinë Tëndë.

Kur kjo dashuri të arrijë në pikën kulminante të saj, e deh njeriun, sepse vetja e tij del nga aty dhe ai ekziston me Atë që do. Kur vetja e njeriut del nga aty, ai arrin çdo lloj nderimi dhe mirësie të Rabbu’l-Aleminit, domethënë, të Atij.



O Zot! Na bëj t’i duam ata që do Ti! Siç na ke bërë të duam të Dërguarin Tënd, salallahu alejhi ve selem, na bëj të duam edhe çdo mik Tëndin! Na bëj të duam të gjithë Elhi Bejtin, sahabët e nderuar dhe të gjithë ata që e duan dhe i shërbejnë Islamit!

Sa bukur është të duash! Kështu që, mjerë për atë që s’do! Ai që do, del nga kafazi dhe bëhet i lirë. O Zot! Ne të duam Ty në sajin Tënd. Po ashtu, në sajin Tënd i duam ata që i duam. Në sajin Tënd i duam ata që do Ti. Në sajin Tënd i duam ata që të duan Ty. O Zot! Ata që të duan Ty, edhe pse e kanë nxjerrë nga zemra çdo gjë përveç Teje, prapëseprapë i duan ato, por me masë. Në këtë mënyrë, kjo dashuri, nuk është pengesë për dashurinë që kanë ndaj Teje, sepse dashuria që kanë ndaj gjërave të kësaj bote, përbëhet vetëm nga thërrimet dhe grimcat e vogla të dashurisë që kanë ndaj Teje.

O Zot! Na bashko dhe mos na ndaj nga të dashurit e Tu! Sepse qëndrimi pranë tyre është xhenet, ndërsa qëndrimi larg tyre është xhehenem. Mos na ndaj prej të dashurve të Tu, në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë nga nuri i tyre! Kënaqësia jote arrihet vetëm duke të të adhuruar Ty. Ndërsa kushti që ke vendosur për këtë adhurim, është zbatimi i përpiktë i urdhrave me dashurinë dhe orientimin që na ke dhënë dhe largimi nga ato që ke ndaluar.

KUR DUHET TË SHKOJMË TE DOKTORI I TË ÇMENDURVE?

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Numri i ankesave që kërkojnë aplikimin në një klinikë psikiatrie është pothuajse i barabartë me numrin e njerëzve në botë. Ajo që ka rëndësi është serioziteti i ankesës. Nuk shkojmë te mjeku për çdo temperaturë, na intereson nëse kalon 38 gradë dhe ka zgjatur një ditë. Edhe këtu kriteri është; Kushtet që ndikojnë në jetën familjare, të punës dhe shoqërore të personit dhe që shkaktojnë përkeqësim të funksionalitetit.

Disa probleme nuk janë aq shqetësuese. Për shembull:

- Nuk mund të lexoja gazetën, shkova te mjeku dhe bleva syze.

- Ana e thoit më ishte skuqur. Mjeku i familjes më dha një krem, faleminderit.

Por nëse çështja është e dimensioneve të ndryshme, nëse ka një problem psikologjik, veçanërisht nëse keni shkuar te mjeku i të çmendurve (!), nuk bënte nëse nuk do ta shkruanim kështu, nuk ka rëndësi edhe nëse rezultati del i pastër. Kjo hyn

në dosjen tuaj penale. Kështu që përdoret në çdo situatë shqetësuese.

Është e vështirë të flasësh për një sistem të paprekshëm dhe të padukshëm. Tema bëhet akoma më e pakuptueshme kur këtyre sistemeve u shtohen konceptet që lidhen me shumë disiplina si shpirti, nefsi, vesvesi, lajthitja dhe metafizika. Për më tepër, gjërat ndërlikohen kur merren parasysht edhe fjalët e profesor Ajhan Songarit i cili është shprehur: «Shpirti i përket Allahut, nuk sëmuret, ato që përshkruani ju janë çrregullime në funksionet e trurit.»

Fëmija ynë kishte temperaturë, e ekzaminoi një shok doktor. Diagnoza?

- Bajamet janë të mëdha dhe të kuqe.

- Diagnoza: Bajamet

- Bëmë një analizë, rezultoi se ishte baktere.

- Trajtimi: antibiotik

- Rezultati: I suksesshëm.

Gjithçka është kaq e lehtë, kaq e bukur...

- Miku im më i mirë, kishte probleme të ndryshme të kësaj bote. Ai thoshte se ishte shumë i mërzhitur, madje po mendonte të bënte vetëvrasje. Sa herë që hap dritaren, zemra ime më vinte te goja (frikësohesha).

- Është e vërtetë, apo po e ekzagjeron?

- A po mendon të bëjë vetëvrasje? Apo thjesht dëshiron të bëjë bluf dhe të heqë presionin?

- Po sikur të jetë e vërtetë, po sikur të hidhet nga dritarja ndonjë ditë?

- Me kë duhet të konsultohemi? A nuk ka ndonjë psikolog, psikiatër, hoxhë të fortë apo dikush tjetër?

- A thua del diçka në grafi apo në skaner? T'i bëjmë një test rezonancë, rreze, apo test alergjie?

- Mjekët gjithmonë japin ilaçe. Mos vallë duhet të gjejmë një terapist, t'ia tregojmë gjithçka dhe të relaksohemi?

Hajt tani, ndajini gurët nga orizi...

Në këtë artikull, le të përpiqemi t'u përgjigjemi disa pyetjeve të bëra shpesh dhe disa çështjeve kurioze. Ndoshta disa gurë do t'i hiqen orizit.

CILI ËSHTË DALLIMI MIDIS PSIKIATRIT DHE PSIKOLOGUT?

Psikiatri pas përfundimit të shkollimit gjashtëvjeçar të fakultetit të mjekësisë, merr titullin “doktor i mjekësisë”. Ai bëhet asistent në repartin psikiatrik të një spitali mësimor. Në përfundim të shkollimit 4-5 vjeçar bën një tezë dhe nëse kalon provimin merr titullin psikiatër.

Psikologu mbaron departamentin katërvjeçar të psikologjisë në fakultetin e shkencave dhe letërsisë të universitetit. Kështu bëhet psikolog. Nëse dëshiron të përparojë, merr diplomën master dhe merr tituj si “psikolog klinik”, “psikolog zhvillimi”.

Të dyja janë zona shërbimi shumë të vlefshme, të nevojshme dhe të rëndësishme kur kryhen siç duhet. Është e pakuptimtë të krahasosh njërën me tjetrën dhe të përpiqesh të zëvendësosh njërën me tjetrën. Por ajo që është më e pakuptimtë është se këta aspirojnë të zëvendësojnë njëri-tjetrin në formulën e trajtimit.

TE CILI DUHET TË APLIKOJMË MË PARË?

Kur nuk mund të kontaktohet një psikiatër, aplikimi i parë është te një psikolog. Duke qenë se numri i pacientëve tanë dhe numri i mjekëve psikiatër nuk është i përputhshëm dhe shumë ankesa nuk janë në fakt probleme mjekësore, kjo situatë në fakt e ndihmon sistemin të funksionojë. Si në çdo punë, edhe këtu kualifikimi dhe përvoja janë shumë të rëndësishme.

Puna ekipore është ideale. Nëse është e nevojshme (dhe sigurisht e mundur) pacienti duhet të shkojë te psikiatri. Le të bëhet diagnoza, të përcaktohet serioziteti i situatës, të organizohet trajtimi. Psikologu që ka vend në këtë trajtim le ta marrë në dorë pacientin dhe trajtimi të vazhdojë.

KUSH DUHET TË SHKOJË TE MJEKU?

Numri i ankesave që kërkojnë aplikimin në një klinikë psikiatrike është pothuajse i barabartë me

numrin e njerëzve në botë. Ajo që ka rëndësi është serioziteti i ankesës. Nuk shkojmë te mjeku për çdo temperaturë, na intereson nëse kalon 38 gradë dhe ka zgjatur një ditë. Edhe këtu kriteri është; Kushtet që ndikojnë në jetën familjare, të punës dhe shoqërore të personit dhe që shkaktojnë përkeqësim të funksionalitetit. Të gjithë kanë frikë nga errësira, por nëse kjo frikë ju ka bërë të mos shkoni në dhomën tjetër, atëherë është koha për të lënë një takim. Gjithashtu, këto duhet të jenë ngjarje afatgjata, jo ndjenja disa orëshe.

Ndonjëherë midis atyre që vijnë vetëm me ankesën e ngrënies së thonjve dhe kanë probleme me gjumin, të cilat mund të konsiderohen të lehta, mund të dalë një diagnozë e depresionit madhor duke hapur kështu një pus me gjilpërë. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të rriturve tanë. Ankesat psikiatrike mund të ngatërrohen me sëmundjet kronike ekzistuese, madje edhe ndryshimet e thjeshta të ilaçeve mund të shkaktojnë probleme serioze. Në pacientët pediatrikë, vetëm të dëgjosh, të thuash se është në rregull, po shkon mirë, të bisedosh me fëmijën, të bësh një marrëveshje dhe madje të eliminosh mungesën e komunikimit të familjes, ndonjëherë mund të jetë terapeutike.

KUSH DUHET TË MOS SHKOJË?

Pika dalluese këtu është se njerëzit nuk kërkojnë ndihmë psikologjike vetëm kur kanë një sëmundje psikiatrike. Ata gjithashtu aplikojnë për problemet e sjelljes, problemet e përshtatjes, problemet e marrëdhënieve dhe komunikimit. Fatkeqësisht, nuk ka mjaftueshëm psikiatër për të dëgjuar të gjithë ata që kanë ankesa të tipit “Unë nuk kaloj dot mirë me bashkëshortin, fëmija nuk më fle vetëm, fëmija nuk merr vesh me vëllain e tij”. Të thuash se ndihesh i pakënaqur sot, nuk do të thotë depresion.

SI DUHET TË JETË PËRDORIMI I ILAÇEVE?

Fatkeqësisht, të gjithë janë të shqetësuar për këtë çështje. Si pacientët që mendojnë se mjeku u ka dhënë ilaçe të panevojshme, ashtu edhe mjekët që shohin pacientët që nuk përmirësohen ngaqë nuk përdorin ilaçin që ua kanë dhënë. Fytyra e paneleve të trajtimit ndryshoi plotësisht kur u tregua se disa pjesë të trurit nuk funksiononin siç duhej dhe se teprica ose mungesa e disa substancave ishte efektive në shumë prej sëmundjeve psikiatrike në të cilat ushtroheshin trajtimet e dëgjimit dhe sugjerimit.

Tema mund të zgjerohet ndërsa shkruajmë, andaj le ta përfundojmë me fjalinë përfundimtare të domosdoshme të situatave shqetësuese që çdo njeri i përjeton shumë herë: «O Zot, na ruaj mendjen!»

ANALIZIMI I NJË UDHËTIMI

— Murat Akgyn —

Për ta mësuar lumturinë e vërtetë, këtë herë shkuam në kohën e lumturisë, pra në kohën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Para na doli tregimi i një udhëtimi të bekuar. Mësimet rreth familjes, i patëm marrë nga krijesat, nga ajetet e Kuranit dhe nga vëllezërit e Jusufit (a.s.). Ndërsa tani, do të mundohemi ta marrim mësimin tonë duke i bërë një analizë udhëtimit të bekuar.

Një rrugë, dy udhëtarë dhe një udhëtim i vështirë. Pas kishin armikun, ndërsa përpara një rrugë të gjatë. Mbi supet e tyre rëndonte lodhja e një udhëtimit të gjatë. Një moment, vendosën të pushonin. Gjetën një vend. Njëri prej udhëtarëve hyri i pari në shpellë, në mënyrë që tjetrit të mos i ndodhte ndonjë gjë e keqe. E pastroi vendin brenda. I mbylli të gjitha vrimat, në mënyrë që të dashurin e tij të mos e dëmtonte ndonjë gjë. Ndërsa vrimën e fundit e mbylli me dorën e tij, ngaqë nuk kishte gjë tjetër për ta mbyllur. Të gjithë e dini këtë udhëtim dhe i njihni udhëtarët e bekuar të këtij udhëtimit. Njëri është më i dashuri, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe tjetri është i dashuri i më të dashurit, Ebu Bekri (r.a.).

Tani le të flasim për njëren prej historive që vazhdimisht e shohim rreth nesh. Një rrugë, dy udhëtarë dhe një udhëtim i vështirë. Prapa kishin barrën që ua patën ngarkuar vitet në supet e tyre dhe gjallërinë e rinisë. Ata vendosin për ta vazhduar rrugën bashkë për ta hedhur nga supet e tyre qoftë edhe pak lodhjen që ua kishin dhënë vitet, për të arritur prehjen... Rruga është e gjatë dhe e lodhshme. E mbushur me pengesa dhe gropa. Të ecurit bashkë, kërkon sakrificë.

Dy udhëtime që i ngjajë shumë njëri-tjetrit. Vetëm koha dhe njerëzit janë të ndryshëm. Dy njerëz që e

duan njëri-tjetrin. Një udhëtim i gjatë dhe i vështirë. I dashuri i më të dashurit, Ebu Bekri (r.a.), na jep një mësim që prej shekujsh. Sigurisht se për ata që kanë vendosur të ecin bashkë në rrugë dhe që e duan njëri-tjetrin...

Tani është koha e mësimet.

Ebu Bekri (r.a.), kaloi një hap përpara Tij, në mënyrë që të mos dëmtohej i dashuri. Pastaj u përpoq t'i mbyllte të gjitha vrimat nga të cilat mund të dëmtohej Ai. Kur nuk gjeti gjë tjetër për t'i mbyllur vrimat, trupin dhe qenien e tij e bëri mburojë për të dashurin. Me këtë histori, që prej shekujsh, na është treguar se si duhet të sillemi ndaj të dashurit tonë.

Po ne, a i kemi mbyllur vrimat nga të cilat mund të dëmtohet i dashuri ynë? A e kemi sakrifikuar veten, në mënyrë që ai të mos dëmtohet? A u kemi rezistuar dot gjarpërinjve që kafshojnë, vetëm e vetëm që ai të jetë mirë?


Udhëtimi është i gjatë dhe i vështirë, por nëse e keni gjetur Ebu Bekrin tuaj, udhëtimi është po aq i bukur dhe i sigurt.

Të gjesh Ebu Bekrin tënd...

Të jesh Ebu Bekër...

Sa e vështirë, apo jo?





KUR SUKSESI BËHET MËKAT

— Dr. Aid El Karni —

Kur popujt jetojnë në injorancë dhe prapambetje, sulmohen nga sëmundja e fanatizmit medhhebor (juridik fetar), nga ngurtësimi ideor dhe autoritarizmi politik. Për rrjedhojë, ky individ, nëse ndeshet me të vërtetën, nuk njeh vetëm se atë çfarë është lindur në të e që e ka trashëguar nga etërit e tij.

Në këtë kontekst, Allahu i Lartësuar, lidhur me idhujtarët thotë: “(Idhujtarët thanë:) **I kemi gjetur etërit tanë në një fe dhe ne po ecim pas gjurmëve të tyre.**”

Në këtë situatë, këta popuj e konsiderojnë opinionin kundërshtues, edhe nëse është i drejtë, të gabuar dhe të papranuar. Kësisoj, ata mësyjnë dhe i turren çdo novatori dhe të suksesshmi.

Volteri, sikurse vjen në librin “Kënaqësia e të folurit” të Davidit, thotë: “Suksesi është një “mëkat”, që e kryejnë disa njerëz me qëllim të mirë, porse kolegët e tyre nuk ua falin atë.”

Vërtet, sa vlera dhe ndere të strategëve, i përdhosën injorantët. Të mjafton të shikosh sulmet, agresionet dhe armiqësitë me të cilat të marrët dhe të poshtëruar prej idhujtarëve, i konfrontuan profetët (a.s.).

Disa strategë heshtën dhe nuk e thanë të vërtetën, të influencuar nga frika e turmës dhe zemërimi i masës.

Mbi këtë realitet, Sheuku thotë:

*Të mençurit e kuptuan bretkocën,
Kur “Kam ujë në gojë”, - ajo tha:
A është e mundur të flasë,
Dikush që gojën plot me ujë e ka?!*

Ngjashëm shprehet poeti i madh Ebu Zejd Muhamed ibn Ahmed es Sudejriu:

*Sa veta fshehin çka që nuk e trazojnë,
S’ia beson as edhe më të afërmit person,
Pasi druhet se shkarja e tij tjetrin e gëzon,
Paçka se tjetri dukshëm, dashuri reflekton.*

Kuptimi i kësaj është se ka shumë e shumë njerëz, që bartin në kraharor sekretin e tyre personal, të cilin nuk mund ta nxjerrin nga goja e t’ia thonë dikujt, qoftë ai edhe më i afërti i të afërmeve; të influencuar dhe të zhgënjyer nga individit të cilit nuk mund t’i besohet asnjë sekret, nuk mund t’i qahet asnjë hall, madje që e gëzon gabimi dhe shkarja jote, që shtret se është në kraharor tënd, ta shfaq shoqërinë dhe dashamirësinë, porse brendia e tij është e nxirë nga smira dhe antipatia kundër teje, më zi se shufra e hekurit, të cilën e ka shpërfytyruar zjarri dhe tymi.

Shkëlqesitë dhe të suksesshmit, që përballen me sulmet dërrmuese të trashanikëve, i ngushëlloj me biografinë e shkëlqesisë së krijesave, Profetit (a.s.), që u konfrontua me injorancën e injorantëve, aq sa kundër tij dhe thirrjes së tij u formuan fraksione idhujtarësh vيرانë, dyfytirëshash besëprerë, hebrenjsh komplotues, të krishterësh smirëzinj dhe të afërmish të vrazhdë; por pavarësisht gjithë kësaj ai (a.s.), vijoi të bënte durim, të shpresonte shpërblimin e Zotit të vet, të rezistonte, të fitonte dhe së fundi, të kurorëzohej me kurorën: “**Ne të dhamë ty një fitore të sigurt.**”

Në këtë kontekst, poeti Abdullah el Berduniu, në lavdërim të shkëlqesisë së njerëzimit, Profetit të kombit islam (a.s.), në përshkrim të guximit, qëndresës dhe durimit të tij, thotë:

*Brofi djaloshi i dashur i udhëzimit,
Veshur me rrobën e dritës dhe zjarrimit,
Në pëllëmbën e tij pishitari udhëzon,
Në gjak ka besimin që çdo tiran e sfidon.*

Shiko epokën e zgjerimeve të myslimanëve, sesi u arrit reformimi, novacioni dhe u shpalesh kraharorët karshi mendimit ndryshe të kapërdishëm, sesi kombi islam u angazhua me zgjerimet, triumfet, ndërtimin dhe civilizimin.

Kurse, kur kombi islam u ligështua dhe gjendja e tij u dobësua, ai ra në luftërat fantazëm të konfliktit medhhebor (juridik fetar), fanatizmit dhe imitimit të verbër, në hijen e udhëheqësve dhe tiranëve, disa prej të cilëve qenë fëmijë e disa qenë të rritur mendjelehtë; aq sa për disa prej tyre Dhehebiu dhe Ibn Kethiri thonë: “Ky udhëheqës u preokupua shumë me vashat, pirjen dhe ahengun. Ai ishte i pasionuar pas zënies së qenve dhe deshve.”

Në kohën e të këtillëve u bojkotuan kreativiteti mendor, reformimi shkencor, liderët e fesë (imamët), gjenitë dhe të kualifikuarit. Asokohe u burgos Ibn Tejmije, u përdoq Ibn Khalduni, u vra El Mutenebiu në shkretëtirë, u izolua Ali ibn Rushdi në shtëpinë e tij, u dogjën librat e Ibn Hazmit dhe u përzu nga qyteti i tij, u eliminua Lisenu Din ibn Khatabi...

E gjitha kjo, sepse novacioni, suksesi, përparimi dhe talenti, janë mëkate që s’i falin dështakët, parazitët dhe përtacët.

Shqipëroi: Altin Torba

Gjurma e gishtit është vula që ne ngulitim në çdo gjë që bëjmë. Ashtu siç është përputhshmëria me gjurmët e gishtërinjve prova më serioze për mjekësinë ligjore, po ashtu janë edhe gjurmët e gishtërinjve që lëmë pas në të gjitha punët që bëjmë, në çdo vepër që lëmë pas.

GISHTAT: IDENTITETI YNË BIOLOGJIK



— Dr. Iljas Kandemir —

Struktura e trupit, organet shqisore, sistemet e vlerësimit dhe kontrollit të qenieve njerëzore janë krijuar për të punuar në mënyrë të sinkronizuar. Organet tona të shikimit, dëgjimit, prekjes, shijes dhe nuhatjes, paksa të ndryshme nga gjallesat e tjera, me strukturën e tyre algoritme për të menduarit dhe nxjerrjen e përfundimeve, janë të lidhura me njëra-tjetrën nën një sistem të centralizuar të mbështetjes së vendimeve.

Pjesa ku ne përdorim më shumë dhe në mënyrë më efektive shqisën e prekjes nga organet tona shqisore janë gishtat tanë, veçanërisht majat e tyre. Nëpërmjet tyre mund të perceptojmë sipërfaqet e strukturave, temperaturën, vrazhdësinë, lagështinë e tyre, etj. Me to mund të perceptojmë shumë veçori fizike. Kjo vlen edhe për disa kafshë me gishta si ne, siç janë majmunët. Por njerëzit kanë diçka tjetër që nuk e kanë majmunët: Gjurmët e gishtërinjve. Gjurma e gishtit është një veçori fizike që është unike për çdo person me një strukturë gjenetike të ndryshme dhe e dallon atë nga njerëzit e tjerë. Gjurma e gishtit është vula që ne ngulitim në çdo gjë që bëjmë. Ashtu siç është përputhshmëria me gjurmët e gishtërinjve prova më serioze për mjekësinë ligjore, po ashtu janë edhe gjurmët e gishtërinjve që lëmë pas në të gjitha punët që bëjmë, në çdo vepër që lëmë pas.

Qëllimi dhe arsyeja e ekzistencës së gjurmëve të gishtërinjve të pajisura me dallime individuale specifike për çdo njeri dhe çdo gisht, janë bërë më të qartë me përdorimet unike të gjurmëve të gishtë-

rinjve në shekujt e fundit. Për shembull, një piktor që pikturoi pikturën e tij shekuj më parë, regjistroi se piktura i përkiste atij duke firmosur nënshkrimin e tij unik. Mirëpo, dihet gjithashtu se shenja të tilla, duke përfshirë edhe firmat, imitohen shumë dhe nuk është e lehtë t'i dallosh nga ato realet. Disa piktorë janë përpjekur ta zgjidhin këtë problem, me vetëdije apo pa vetëdije, duke lënë gjurmët e dorës dhe gishtave në telajo. E gjithë kjo tregon se duart tona janë dëshmitarë shumë kompetentë që flasin për veprat që bëjmë ne: **“Atë ditë do t'ua mbyllim gojën dhe do të na flasin duart e tyre. Këmbët e tyre do të jenë dëshmitare të asaj që kanë bërë ata.”** (Jasin, 65)

Nëse i shikoni me vëmendje gjurmët e gishtit, do të shihni se në të vërtetë ato përbëhen nga katione/kanale të thella. Ato ekzistojnë pothuajse për të qenë përcaktues i identitetit të një personi në formën e tij origjinale. Natyrisht, kjo nuk është detyra e tyre e vetme. Për shembull, këto palosje dhe kanale bëjnë një punë të rëndësishme për të kapur më mirë sipërfaqet e sheshta. Ndoshta disa qindra vjet më parë ne nuk kemi pasur (objekte me) sipërfaqe kaq të sheshta në jetën tonë, por në botën e sotme teknologjike jemi plot me (objekte që kanë) sipërfaqe shumë të sheshta si qelqi, metali, plastika dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me to. Ndoshta ekrani me prekje i celularit tonë është një prej tyre. Në këtë pikë, ia vlen të kujtojmë se kur duart tona qëndrojnë në ujë më shumë se ç'duhet, majat tona të gishtave bëhen edhe më të rrudhura për të rritur kapjen.



A nuk është mirë që dizajni i strukturës së gishtit tonë është gati mijëra vjet më parë për shekullin e 21-të, kur telefonat tanë celularë njohin shenjat e gishtërinjve tanë dhe e kontrollojnë atë me majat e gishtave?

Është mjaft interesante që maja e gishtit shfaq gjurmë të ndryshme për çdo njeri. Edhe gjurmët e gishtërinjve të binjakëve nga një vezë janë shumë të ngjashme, por jo saktësisht të njëjta. Ky ndryshim fillon të shfaqet që në barkun e nënës. Me pak fjalë, bëhet e pamundur që dy persona të kenë të njëjtën gjurmë gishtash. Me fjalë të tjera, nuk është realisht e mundur që një njeri të lindë përsëri në mënyrë natyrale i njëjtë me dikë tjetër deri në gjurmën e gishtit. Natyrisht, Ai që është në gjendje ta bëjë këtë, madje edhe që thotë se majat e gishtave janë shumë më unike se gjymtyrët e tjera, ka një kompetencë tjetër: ***“A mendon njeriu se nuk mund t’ia bashkojmë kokcat? Po, ne kemi fuqinë t’i rregullojmë edhe majat e gishtave të tij.”*** (Kijame, 3-4)

Duart tona jo vetëm që lënë nënshkrimin tonë në punët që bëjmë dhe në vendet ku shkojmë, por edhe mbledhin diçka prej aty. Nëse gjërat që mbledhin janë patogjene, sigurisht që mund të na dëmtojnë edhe neve. Viruset, bakteret, kimikatet e dëmshme mund të përhapen nga duart tona në të gjithë trupin dhe ta kthejnë jetën tonë në një makth. Duke infektuar njerëzit e tjerë me një metodë të ngjashme, ajo mund të arrijë në skajin tjetër të botës në mënyrë zinxhir. Shekuj më parë, transporti ishte mjaft i kufizuar për shkak të mungesës së zhvillimit teknologjik. Por tani, është e mundur të udhëtosh në kontinente të largëta në më pak se një ditë lehtësisht dhe me vështirësi jo shumë të mëdha. Kjo tregon se sa e rëndësishme është të mbrojmë duart tona. Shtrëngimet e duarve, veçanërisht pas përshëndetjes së njerëzve në takimin e parë, shfaqen si një nga mënyrat e rëndësishme për transmetimin e këtyre patogjenëve negativë.

Sot, ne e kuptojmë më mirë se shumë viruse dhe baktere mund të hyjnë në trup përmes gojës dhe hu-

ndës brenda disa orësh. Për këtë arsye është shumë i rëndësishëm pastrimi i gojës dhe hundës me ujë disa herë në ditë dhe kjo në mënyrë të përsëritur. Megjithëse hunda dhe goja janë funksionojnë për ta siguruar këtë vonesë, sigurisht që është përgjegjësia jonë të mbrohemi duke i pastruar ato çdo disa orë. Pastërtia është arma jonë më e fortë kundër mikroorganizmave të dëmshëm që përpiqen të hyjnë në trupin tonë, shumohen dhe shkatërrojnë kur hyjnë, krahas shumë baktereve të dobishme që janë të bollshme në trupin tonë. ***«O ju që kenë besuar! Kur të faleni/luteni, lani fytyrat dhe duart deri në bërryla...»*** (Maide, 6)

Njohuria se gjurmët e gishtërinjve të njeriut janë kaq të ndryshme dhe unike ndoshta nuk ishte një fenomen që njerëzimi mund ta kishte konceptuar përpara se të arrinte nivelin e teknologjisë së lartë. Sepse, në ditët e sotme, me zhvillimet teknologjike si mikroskopi dhe gjenetika, zhvillimi/diferencimi i gjurmëve të gishtave mund të ekzaminohet duke shkuar deri në barkun e nënës. Në të ardhmen, informacionet e reja që do të merren për këtë temë do të shtohen me zhvillimin e mëtejshëm të studimeve teknologjike dhe informacioni i ri në fjalë do të vazhdojë të befasojë shkencëtarët dhe të buzëqeshë besimtarët. Shkencëtarët, të cilët mendojnë se mundësia e diferencimit në gjurmën e gishtit të një personi të dytë me të njëjtën gjurmë gishti është pothuajse e pamundur, nuk mund të shpjegojnë pse një diferencim i tillë ishte i nevojshëm deri në shekullin e kaluar, por ata tashmë nuk mund ta injorojnë faktin se sa i dobishëm është për ne falë teknologjisë në zhvillim. Ne mund të nënshkruajmë me gisht dokumentet në tableta dhe telefona, të bëjmë pagesa me gisht dhe t’i tregojmë pajisjes/sistemit me gisht se jemi vërtet ne. Në këtë rast, gishtat tanë kanë filluar të përdoren më funksionalisht se më parë. Ne si qenie njerëzore vulosim dhe ekzekutojmë çdo punë de facto që bëjmë me vulën tonë në majë të gishtave.

Atëherë le t'u dalim për zot duarve tona...

“TË JESH I SINQERTË
KUNDREJT ALLAHUT, TË JESH I
SINQERTË KUNDREJT KURANIT
FISNIK, TË JESH I SINQERTË
KUNDREJT LIDERËVE TË
BESIMTARËVE DHE TË JESH I
SINQERTË KUNDREJT TË GJITHË
MYSLIMANËVE.”

SINQERITETI

PJEKURIA E NJË PERSONALITETI TË PASTRUAR NGA FUNDËRRINAT

— Dr. Adem Ergyl —

Njëri prej synimeve më të rëndësishme të fesë, pa dyshim se është që t'i japë njeriut një pjekuri personaliteti pa fundërrina dhe të papërzier. Pastrimi mund të thuhet se është emri i procesit të arritjes të kjo cilësi. Kur flasim për fjalët që shprehin sinqeritetin në thëniet e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij (s.a.s.), në shikim të parë na vijnë në mendje këto tri koncepte: sinqeriteti, besnikëria dhe këshillë. Sinqeriteti është emri i të qenit i papërzier. Veçanërisht në fjalë dhe në vepra, shprehet të qenët i pastër ndaj Allahut, i përkushtuar ndaj Allahut dhe përjashtimin e çdo lloj mendimi që është jashtë pëlqimit të Allahut Teala. Sinqeriteti është si një adresë për ta bërë adhurimin jo në emër të dikujt tjetër, madje edhe as në emrin tënd, por vetëm në emër të Allahut.

Në të vërtetë, njerëzit janë urdhëruar vetëm me një adhurim të tillë. Allahu i Lartësuar thotë: **“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”** (Bejjine, 5) Ndërsa fjala besnikëri shpreh thelbin, fjalët, sjelljet dhe ndershmërinë e njeriut. Sigurisht se kjo është një rezultat i natyrshëm i sinqeritetit.

Allahu i Lartësuar formon një lidhje të drejtë ndërmjet besimit të vërtetë dhe besnikërisë. Në një vend që nuk ka besnikëri, bëhet fjalë për hipokrizi. Madje, shprehet se do t'i provojë me sprovë të ndryshme ata që thonë “besuam”, në mënyrë që të dalë në pah besnikëria në besim:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!”

Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.” (Ankebut, 2-3)

Ndërsa fjala nasihat / këshillë është njëra prej fjalëve të pasura në arabisht nga aspekti i kuptimit. Kuptimet leksikore të saj janë: “Dëlirësia dhe pastërtia e një gjëje, të qenët larg të keqes dhe prishjes, të qenët e njeriut i sinqertë dhe i besueshëm, qëllim i mirë ndaj të tjerëve dhe të duash mirësi gjithmonë për ta.”

Ndërsa në gjuhën tonë përdoret më shumë si këshillë që i bëhet dikujt në emër të mirësisë. Kjo fjalë është shumë e qartë se është përdorur në kuptimin e “sinqeritetit” dhe “dëlirësisë” që shprehin bazën dhe synimin e fesë në këtë hadith fisnik të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Temim Ibn Evs ed-Dari, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Feja është nashat / këshillë.” Ne i thamë: “Për kë, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi, alejhi’s-selam, u përgjigj: “Të jesh i sinqertë kundrejt Allahut, të jesh i sinqertë kundrejt Kuranit Fisnik, të jesh i sinqertë kundrejt liderëve të besimtarëve dhe të jesh i sinqertë kundrejt të gjithë myslimanëve.”¹ Ky hadith fisnik është shumë i rëndësishëm nga aspekti se cilësia e personalitetit dhe adhurimit që synon feja mund të matet me sinqeritet.

Nga kjo kuptojmë se grada e fetarisë është aq sa grada e sinqeritetit. Allahu i Madhëruar kërkon besnikëri dhe sinqeritet në besim. Ai i paralajmëron ata që shfaqen sikur kanë besuar apo që shprehen se kanë besuar, edhe pse nuk kanë besuar plotësisht me zemrat e tyre. Madje, shprehet se do t’i provojë nëse janë besnikë dhe të sinqertë në fjalët e tyre ata që thonë më gjuhë se kanë besuar. Përveç të tjerash, deklaroi se ata që thonë “dëgjuam” kur u lexohen ajetet hyjnore, por që nuk shfaqin besnikëri dhe sinqeritet, janë krijesat më të ulëta në sipërfaqen e tokës që nuk kanë marrë pjesë nga njerëzia.

“Mos u bëni si ata që thonë “Dëgjojmë”, por nuk ia vënë veshin. Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj se vërtetës) e që nuk kanë arsye.”²

Ata që sillen me hipokrizi kundrejt të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe ata që përpiqen ta fshehin veten me justifikime e betime të rreme, i cilëson si keqdashës të pandërgjegjshëm dhe të hamendtë. Në këtë mënyrë, na tregoi se njerëzit e pasinqertë janë armiqtë më të kobshëm. Andaj na e kujton shpeshherë se duhet të jemi të zgjuar kundrejt atyre që nuk sillen me sinqeritet kundrejt besimtarëve dhe që përpiqen të na mashtrojnë.

Gjithashtu na tregoi se ata mund të njihen nga fjalët dhe veprat e tyre. Këta njerëz vrapojnë sa andej-këndeje dhe vazhdimisht e ndërrojnë qëndrimin e tyre sipas interesave që kanë. Allahu i Madhëruar kërkon që besimtarët të jenë të sinqertë në pendimin e tyre.

1. Shik. Muslim, Iman 95. Veçanërisht shik. Buhari, Iman 42; Ebu Davud, Edeb 59; Tirmidhi, Birr 17; Nesai, Bej’at 31, 41.

2. Enfal, 21-22.

Andaj urdhëron që të jenë të vendosur në pendimin e sinqertë kundrejt gabimeve e mëkateve dhe të kthehen te Zoti e te e vërteta me një kthim të vërtetë: **“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’ju shlyejë gabimet e t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: “O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë”.** (Tahrim, 8)

Gjithashtu kërkon sinqeritet dhe dëlirësi në vepra dhe në sjellje duke na paralajmëruar qartazi: **“Thuaj: “Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!”** (Kehf, 110)

Allahu i Lartësuar na njoftoi se nuk i konsideron të pranueshme veprat që bëhen për shtirje, për lavdërime apo për synime të tjera jo të sinqerta. Allahu Teala dëshiron t’i shpjerë robërit e Tij te xhevahiri i sinqeritetit nganjëherë me mirësi dhe nganjëherë tjetër me fatkeqësi që duken si gjëra të këqija.

Në lidhje me këtë thotë: **“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”** (Enbija, 35) Krijuesi i Lartësuar tregon se sinqeriteti është një mburojë e fortë duke e shprehur se do t’i mbrojë robërit e Tij të sinqertë dhe se kurrë nuk do t’i lërë ata në dorën e shejtanëve prej njerëzve dhe xhindeve.

Në ajetet fisnike thuhet: **“Ajo e dëshiroi atë; por edhe Jusufi do ta kishte dëshiruar atë, sikur të mos kishte parë provën e Zotit të vet. Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.”** (Jusuf, 24) **“Iblisi tha: “Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë”.** (Hixhr, 39-40)

Së fundi, mund të thuhet se sinqeriteti është cilësi e personalitetit. Nëse nuk arrihet kjo cilësi, është e pamundur të formohen vatra familjare, ortakëritë, miqësitë, bashkimet për të njëjtën kauzë dhe veçanërisht miqësia me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Në një vend që s’ka sinqeritet, është e vështirë të flitet për miqësi, bashkim, paqe, lumturi, dashuri dhe sukses.

LARTËSIMI I JETËS GRADË - GRADË

— Idris Arpat —

Jeta është një udhëtim pa kthim dhe një ujë që rrjedh. Ajo është një hark i hapur ndërmjet kondakut dhe qefinit, ndërmjet djepit dhe varrit.

Në jetë vijmë pa vullnetin tonë dhe udhëtimin e fillojmë në mënyrë të detyruar. Askush nuk na pyet: “A dëshiron të vish në jetë, ta vazhdosësh jetën apo të zvarrisesh në jetë.” Vetën e kemi gjetur të mbështjellë nëpër djepa. Ja, që nga kjo pikë, fillon udhëtimi ynë drejt pafundësisë. Këtij udhëtimi i themi jetë.

Sikur të vinim në këtë botë me vullnetin tonë, duhej ta pyesnim njëri-tjetrin për qëllimin e kësaj ardhjeje. Për shkak se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, atëherë jemi të detyruar të pyesim Fuqinë e Lartë krijuese: “Cili është qëllimi për të cilin jemi dërguar në këtë botë?”

Përgjigja është kjo: “Li ja’budun, që të më adhuroni Mua.”

Sigurisht se në këtë çështje janë edhe aspektet e njohjes, gjetjes dhe admirimit.

Nga kam ardhur? Ku po shkoj? Cila është detyra ime bazë në këtë botë? Sipas cilave rregullave jeto het në këtë mysafirhane? Çfarë është kjo botë? Çfarë është ajo që vjen pas saj? Çfarë lidhjeje kanë me njëra-tjetrën? Çfarë pozite kam kundrejt Allahut të Madhëruar, njerëzve, vetes sime dhe natyrës?

Këto janë pyetje me rëndësi jetike. Ne e kemi të pamundur të jemi të qetë dhe të lumtur pa u gjetur përgjigje të saktë këtyre pyetjeve dhe pa u përpjekur për të jetuar sipas këtyre përgjigjeve. Ata që thonë se është e mundur, do të shohin se llogaria e gabuar nuk përputhet me natyrshmërinë e tyre.

E vetmja përgjigje e drejtë që mund të thotë mendja e pavarur nga shpallja hyjnore kundrejt këtyre pyetjeve bazë dhe shumë serioze, është “nuk e di”. Dihet se mendja shpjegon “si-të” dhe jo “përse-të”.

Kurani Fisnik dhe suneti i lartë profetik janë burimi i vetëm me të cilin mund ta konceptojmë drejt kuptimin e jetës. Mendja mund të japë shpjegime të rëndësishme vetëm nën dritën e shpalljes hyjnore, sepse “mendja është sy, ndërsa shpallja është dritë”. Çfarë të bëjë syri pa diellin. Destinacioni ku arrin njeriu që i kthen shpinën shpalljes, është hutimi, depresioni dhe agresiviteti. Njeriu i një bote që e ka shkëputur lidhjen me botën tjetër, vetëvritet ose revoltohet. Nuk ka sukses të rastësishëm. Nuk ka lumturi të befasishme. “Lumturia e jetës” mund të arrihet duke mësuar, kërkuar, duke ndjekur natyrshmërinë njerëzore dhe duke ua vënë veshin gjërave të përhershme.

Mirëpo, çfarë është natyrshmëria? Kush e njeh këtë enigmë që quhet njeri? Mjeshtrit e kësaj pune thonë: “Ne nuk mund ta shpjegojmë njeriun. Pyetni Allahun për të.”

Ja, jemi ballë për ballë me një çështje të madhe. Nuk mund të kuptojmë as natyrshmërinë njerëzore dhe as Kurandin Fisnik. Duke heshtur kundrejt pyetjeve të jetës dhe duke e bërë hatme Kurandin Fisnik, i cili ka zbritur “li kaumin jakilun / për një popull që mendon”, dy miliardë myslimanë në këtë botë, po bëhen rutinë. Puna jonë nuk është punë dhe përparimi ynë nuk është përparim.

A thoni: “Na mjafton aq sa kuptojmë?” Edhe të tjerët para nesh kanë thënë kështu, miku im i da-

shur. Nëse nuk u gjejmë përgjigje pyetjeve të jetës dhe zgjidhje problemeve, jeta nuk na pranon si “ekzistues” dhe na shtyp.

Edhe perëndimi, që është një “shoqëri e mendjes”, nuk ka ndonjë fjalë për të thënë në çështjen e kuptimit të jetës. Ai është i preokupuar për t’i vënë në gjumë individët me ninullat “e shpejtësisë e të kënaqësisë”. Nëse nuk i vë dot në gjumë, i bën të mos ndjejnë gjë. “Në perëndim nuk ka ndonjë gjë të re.” Ai e konsideron njeriun budalla dhe i vë përpara shumë lodra. Kjo është e gjitha.

Të jetosh, nuk do të thotë të marrësh e të japësh frymë. Të jetosh, është bukuria e ndjenjave dhe mendimeve. Është përpjekje për ta kaluar këtë bukuri në jetë. Është lumturia që buron nga kjo përpjekje.

Thonë se puna që bëhet me dashuri, është më e lehtë. Thonë, gruaja është bashkëshortja e burrit, është dielli i shtëpisë”. Njeriu që paska gjetur bashkëshorten dhe punën që do, paska hyrë në xhenet, ndërsa ai që punon duke mos dashur, u përpëlitka.

Bota pa probleme është thjesht një imagjinatë. “Njeriu është i vdekshëm dhe dita ka mbrëmje”. Nëse kërkojmë një botë për të jetuar larg brengave dhe problemeve, atëherë paskemi për të kërkuar deri në kiamet.

Të mos shqetësohesh kur kërkon një rrugëzgjdhje nga brengat dhe vështirësitë për të jetuar, do të thotë se dora nuk është në harmoni me këmbën.

“Det pa dallgë dhe njeri pa brenga, nuk ka.” Nëse nuk inatosemi, nëse nuk na kap paniku dhe nëse nuk zemërohemi me njerëzit kur përpiqemi për t’i zgjidhur dhe kapërcyer ngjarjet brengosëse, gjërat negative dhe problemet, ky është një sukses i madh.

Kam lexuar një shënim që ia kishte lënë birit të vet një major, që kishte vrarë veten para disa vitesh:

“Bir! Unë nuk munda t’ia dal me këta njerëz. Ti gjej një mënyrë për t’ia dalë mbanë!”

I ndjeri, përafërsisht thoshte këtë.

Ajo që unë kuptova nga kjo këshillë, është: “Edhe pse nuk kam gjetur një mënyrë për të jetuar në paqe me këtë botë, ti gjej një mënyrë për të mos hyrë në tension kundrejt atyre që ndodhin. Meqë je i detyruar të jetosh me këta njerëz, atëherë tensioni nuk ka dobi. Ti mundohu të jesh i qetë, nganjëherë duke bërë sikur nuk shikon, nganjëherë duke bërë sikur nuk dëgjon dhe nganjëherë duke bërë si budalla.

Sipas meje, kjo është një këshillë e drejtë. Ne nuk

mund të presim që çdo njeri të mendojë si ne apo të jetë si ne. Rrugëzgjdhja e kësaj, është t’i pranojmë njerëzit ashtu si janë.

Ajo që po përpiqem të shpjegoj, nuk është në kuptimin: “Ai që vjen është agai, ai që shkon është pashai”. Unë dua të them që ta arrijmë vazhdimisht lumturinë në jetë, kur jetojmë ndershmërisht dhe kur përpiqemi për të drejtën.

Të jetosh, është një namaz që falet me frikërespekt ndaj Zotit, një fatiha që lexohet nga thellësia e zemrës dhe një lutje e ngrohtë. Produktiviteti është i lodhshëm, por në fund sjell lumturinë e xhenetit. Edhe pse dembelizmi sjell një rehati fizike, shpirtërisht sjell lodhje dhe vështirësi në varr.

Produktiviteti është gjendja e të qenit i kënaqur, por, nëse kjo nuk e kalon vijën e interesit dhe nuk e arrin kufirin e kënaqësisë hyjnore, kënaqësia shpirtërore nuk mund të jetë e vazhdueshme dhe kthehet nga qëllimi i lartë që ka. Të arrish në gradën: “In exhrije illa alallah / Shpërblimi im është vetëm te Allahu”, është një kusht i madh. Domethënë, njeriu duhet të vijë në një gjendje që, çfarëdo të presë, ta presë nga Allahu i Madhëruar.

Të jetosh, është kënaqësi e botës shpirtërore.

Të jetosh, është lumturi familjare. Lumturia është dielli i dashurisë që lind nga gjuha. Ajo e ndriçon dhe e ngroh jetën tonë.

Të jetosh, është një emocion i lartë, që sjell lidhja e formuar me Allahun (xh.xh.). Ajo është zgjerim i botës sonë dhe zgjatje e imagjinatës sonë në botën e përtej, si rezultat i kësaj lidhjeje. Në këtë kontekst, Allah, do të thotë, Ai që na jep jetë.

Të jetosh, do të thotë të përdorim vullnetin tonë dhe të kufizojmë veten tonë. Të mjaftohemi dhe të gëzohemi me atë që kemi. Të pakësojmë pasionet, nëse nuk shtojmë dot mundësitë tona.

Të jetosh është diçka si “vrapimi i pikës për në det”.

Të jetosh, është dashuri për të ecur pa ndalur e pa pushuar dhe arritje nga një gradë në gradën tjetër.

Të jetosh, është një luftë dhe përpjekje e gjatë që mund të bëhet me vetëdije dhe durim për të mos lindur në harem dhe vdekur në vend ku gjenden idhuj.

Të jetosh, do të thotë të lahesh në ujërat e të mjaftuarit me pasurinë që ke dhe të arrish pasurinë shpirtërore. Do të thotë, t’i lartësosh dhe t’i zbukurosh gradë-gradë ditët e kësaj bote për t’u zgjuar duke buzëqeshur në mahsher.



KOHA E EDUKIMIT TË NJERIUT

— Xhafer Durmush —

Kurani Fisnik urdhëron që ta përdorim kohën me vetëdije dhe të arrijmë rezultate të begata nga kapitali që po mbaron. Ndërsa ajeti i pesëmbëdhjetë i sures el-Ahkaf, tregon rëndësinë jetike që ka mbartja për në ditët e nesërme e trashëgimisë së mirë, të cilën e kemi marrë nga e djeshmja, duke e gjallëruar atë në ditët e sotshme:

“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të tij. Nëna e mbart dhe e lind atë me mund. Ai mbartet dhe ushqehet me gjë për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e mbush dyzet vjet, ai thotë: ‘O Zoti im! Më frymëzo të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!’.” (el-Ahkaf, 15.)

Në ajetin fisnik ftohet për në zgjim njeriu, i cili ka arritur kohën që konsiderohet si fillim i moshës së pjekurisë. Prej tij kërkohet të shikojë se nga cila pikë e ka filluar jetën, të falënderojë prindërit për përpjekjet e mëdha që kanë dhënë për të dhe të falënderojë Allahun Teala, i cili ia ka dhënë të gjitha këto mirësi atij. Njeriu duhet t’i kërkojë ndihmë Allahut të Madhëruar për ta falënderuar Atë dhe të njëjtën koshjencë duhet të përpiket për t’ua trashëguar brezave pas tij.

Tani dëshirojmë të mendojmë se çfarë mund të bëjmë për t’i dalë zot lutjes:

“O Zot! Më jep mua dhe pasardhësve të mi vazhdimisht prej mirësisë Tënde!”¹

Njeriu në moshën dyzet vjeçare, duhet t’i shohë

1. Për shkak se i kemi shtjelluar më parë dy titujt e parë, për të cilët bëhet fjalë në ajetin fisnik (Shik. *Kirk Yas Muhasebesi*, Cafer DURMUS, *Attnoluk*; nr, 251), këtu do të shtjellojmë vetëm të tretin.

gjithë këto mirësi që i ka dhuruar Allahu Teala dhe duhet t’i bëjë një llogari serioze vetes, në mënyrë që ta kryejë falënderimin për to. Ai duhet ta llogarisë veten e tij, që ka shijuar shumë gjëra në emër të mirësive të kësaj bote. Kjo nuk është llogaria e pasurisë, që të mbajë çetelen e atyre që ka fituar dhe atyre që ka harxhuar deri më tani. Kjo është llogaria e suksesit që ka arritur për t’ua dhënë fëmijëve vlerat që i ka marrë nga gjyshërit.

Sipas komentimit të ajetit, vetëm Hazreti Ebu Bekri (r.a.), e arriti suksesin në kuptimin që flitet në ajetin fisnik prej sahabëve të nderuar. Me përpjekjet, begatinë e lutjeve të tij dhe me mirësinë e Allahut të Madhëruar, e gjithë familja e tij, me në krye prindërit, u nderuan me Islam.

Ajeti fisnik, me metodën koncize të tij, paralajmëron se falënderimi ndaj Zotit (xh.xh.), ka kuptim, aq sa jep filiza të begatshme që shtrihen drejt së ardhmes. Nisur nga kjo, njeriu duhet të bëjë plane të detajuara në lidhje me personat për të cilët është përgjegjës t’i edukojë. Siç na e ka bërë të qartë edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ai duhet “të përpiket t’u lërë një trashëgimi të mirë nipërve të tij.”

Për shembull, le të mendojmë për moshën nga zero në gjashtë vjeç:

Kjo periudhë kërkon interesim të veçantë dhe është shumë e rëndësishme në edukimin e fëmijëve, sepse në këtë periudhë formohet personaliteti dhe merren zakonet. Të gjitha vlerat ngjizen ndërmjet moshës zero deri në gjashtë vjeç, lulëzojnë ndërmjet moshës gjashtë deri në dymbëdhjetë vjeç dhe pastaj japin frytet e tyre përgjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, vitet e para të fëmijërisë janë periudha e mundësive të arta, që fitohen ose humben për një popull apo familje. Nëse e neglizhojmë dhe ia lëmë

dikujt tjetër fushën në të cilën duhet të punojmë në atë periudhë, atëherë nuk do të kemi më mundësi për ta gjetur përsëri të njëjtin shans.

Sa e rëndësishme është që t'ua bëjmë të dashur atyre besimin, ibadetin, Kuranin dhe ndershmërinë, në një periudhë kur janë gati të marrin atë që u jepet. T'i mësojmë si të heshtin dhe të flasin sa duhet kur është e nevojshme... T'ua rregullojmë gabimet pa i lënduar. T'u japim mundësi për t'i rregulluar gabimet e tyre me qortime konstruktive dhe orientuese... T'i ndjekim me durim, rregull dhe dashuri në çështjen e praktikimit të atyre që kanë mësuar... Sa e rëndësishme është që të duan, të duhen dhe t'u afrohen të tjerëve me dashuri, sepse vetëm të dhënat që mbruhën me brumin e dashurisë, janë të qëndrueshme dhe të përhershme. Të mos harrojmë se çdo fëmijë, është i etur për gjërat e pastra që i jepen me dashuri. Ndërsa prindërit, janë të detyruar ta bëjnë këtë.

Nëse njeriu do të ulet dhe të mendojë duke filluar që nga mosha dyzet vjeçare, duhet të shqetësohet për çështjen bazë të llogarisë, e cila është mbartja me dashuri për në të ardhmen e trashëgimisë së marrë nga e kaluara.

Kujt do t'ia lë sexhaden time ditën kur të largohem nga kjo botë? Kujt do t'ia lë amanet tespihet, takijen dhe shaminë time? Kush do të ulet në vendin tim nëpër kuvendet, ku flisja vetëm për mirë dhe për të përkujtuar emrin e Allahut? Njeriu duhet t'i mendojë këto.

A e dëshiron fëmija i tij po aq sa ai të gjendet nëpër vende ku ai gjendej me plot dëshirë? A largohet nga vendet e mëkatit, në të cilat ai nuk dëshironte të gjendej? A përputhet pikëpamja juaj kundrejt jetës me pikëpamjen e tij? Nëse jo, si mund të kompensohet ndryshimi që ka ndërmjet jush? Si mund të orientohen për te e drejta me një metodë të mirëfilltë dëshirat e pasionet që ndiqen pa dijeni dhe pa marrë parasysh parimet fetare?

Nga ajeti fisnik mund të kuptojmë qartë se këto pyetje dhe të tjera si këto, secili prej nesh duhet t'ia bëjë vetes. Nëse baza e të gjitha sukseseve të rëndësishme është një e vërtetë, në të cilën gjendet ndjekje me durim dhe vlerësim i mundësive në kohën e duhur, mund të themi se edhe ajeti fisnik pikërisht këtë tregon.

Ndoshta në disa punë mund të jetë e nevojshme të pritët dhe të gjendet koha e duhur, por përgjegjësia e mbartjes së besimit tonë për te brezat që janë duke u rritur e edukuar, nuk mund ta përballojë një pritje të tillë, sepse jeta nuk ndalon dhe ngjarjet përparojnë me vull në rrjedhën e tyre natyrale, edhe pse ne e kryejmë apo jo detyrën tonë. Ai që lind, rritet...

Aktivitetet e fshehta, që tani po bëhen haptazi për t'i mbajtur larg gjërave të shenjta brezat që po

rriten, e shtojnë edhe një herë më shumë rëndësinë e përpjekjeve me vetëdije për të cilat bëhet fjalë në ajetin fisnik. Nisur nga kjo, ne nuk kemi luksin të humbim asnjë njeri të cilin mund ta arrijmë.

Zemra jonë nuk mund të jetë e kënaqur që ndo njëri prej tyre të shkatërrohet në anaforën e mohimit të fesë. Ne kemi përgjegjësinë t'i shpjegojmë fenë tonë të bukur, ta njoftojmë për moralin e Islamit dhe t'ia bëjmë të dashur Kuranin e ibadetin çdo njeriu që mund të arrijmë. Dhe kjo përgjegjësi, është një proces që nuk mbaron kurrë, sepse ajeti fisnik që shfaq domosdoshmërinë e një llogarie të tillë, nuk i lë pas dore edhe pjesët e tjera të kohës. Kuptimi i kësaj duhet të jetë ky:

Ai që nuk e ka bërë një llogari të tillë deri atë ditë, të paktën ta bëjë në kohën e pjekurisë dhe ta mbajë këtë vetëdije, duke mos e neglizhuar më. Para së gjithash, rëndësi ka që kjo vetëdije, të mbahet e gjallë përgjatë gjithë jetës.

ZBUKUROJE VENDIN TËND

Kurani Fisnik i bën të shikojnë horizontet, ata që lexojnë shembujt e tij. Vendet i fut nëpër zemra dhe zemrat i bën të gjera sa vendet. Ja, në njërin prej tyre, thuhet:

“Toka e mirë jep fruta të mira me lejen e Zotit të saj, ndërsa nga toka e keqe nuk del gjë, përveçse bimë të padobishme. Ja, kështu ua shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve mirënjohës.” (el-A'raf, 58.)

Këtu shprehen dy të vërteta me anë të përngjasimit. Zemra e besimtarit përngjasohet me tokën e mirë dhe pjellore, gjë e cila sjell begati, sepse e pranon të vërtetën kur e dëgjon. Si rezultat i këtij pranimi, nga ajo rrjedhin vepra të mira.

Ndërsa, zemra e politeistit dhe hipokritit përngjasohet me tokën e keqe dhe jopjellore. Ajo është e verbër dhe e shurdhër kundrejt së vërtetës. Te ajo mbijnë vetëm ferra dhe bimë të padobishme. Ajo nuk sjell përfitime, për shkak se është e privuar nga haku dhe e vërteta. Madje, në një lloj mënyre, dëmton çdo njeri. Nga ajo zemër dëgjohe vetëm fjalë lënduese dhe fyese. Ajo shfaq vetëm vepra që i shqetësojnë të tjerët.

Por ti, me besimin që zotëron, ke merituar të përngjasohesh me “beldei tajjibe”. Atëherë duhet t'ia dish vlerën zëmres sate dhe duhet ta zbukurosh vendin tënd. Nga lulishtja jote duhet të përhapen aroma si misk...

Pastërtia dhe ndershmëria jote duhet të dallohet menjëherë. Ti duhet të kesh fryte të begatshme që t'ia shfaqësh njerëzisë në çdo periudhë të jetës tënde.

ÇDO NJERI ËSHTË TREGTAR I VETES

— Naim Drijaj —

Në këtë hutbe do të flasim rreth një hadithi të Pejgamberit (a.s) ku fjalët e këtij hadithi nuk i drejtohen vetëm një grupi njerëzish por u drejtohen të gjithë njerëzve.

Hadithi për të cilin do të flasim do e marrim nga pjesa e fundit dhe pastaj do t'i kthehemi fillimit të tij në mënyrë që ta kemi më të qartë se për çfarë bëhet fjalë. Fjalitë e Profetit (a.s) të përdorura në këtë hadith janë të shkurtra, por secila prej tyre mbart shumë kuptime, komente dhe analiza.

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Çdo njeri e fillon ditën e tij duke qenë tregtar i vetes së vet: ai mund ta çlirojë veten e tij (nga zjarri) ose mund ta shkatërrojë atë (në zjarr).

Në mëngjes të gjithë njerëzit drejtohen për në punët e tyre. Ka prej tyre që drejtohen nga e mira dhe e mbara, por ka edhe prej atyre që drejtohen nga e keqja dhe e mbrapshta. Çdo njeri në këtë botë punon dhe synon të fitojë diçka por dikush me fitimin e tij ngritet dhe lirohet nga përgjegjësia e dikush me fitimim e tij nënçmohet e burgoset. Jeta e kësaj botë i ngjan një tregu ku çdo njeri në këtë treg sjell, prezanton, ofron dhe merr diçka.

I Dërguari i Allahut (a.s) në fillim të hadithit na tregon se me çfarë mallit duhet që ne të dalim në këtë treg. Ebu Malik el-Eshariu (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Pastërtia është pjesë (gjysma) e besimit. Imani është pastërti: nga bestytnitë, veset, risitë, gjynahet dhe zbukurim me virtytet e larta dhe devocion.*

Falënderimi i Allahut (el-hamdu lil-lahi) e mbush peshoren e veprave. Kjo fjali është përgëzuese, sepse e përgëzon besimtarin me shpër-

blimin e madh që e pret, ngase ai e ka falenderuar Allahun.

Lavdërimi dhe falënderimi i Allahut (Subhanall-lahi vel-hamdulil-lahi) e mbushin hapësirën ndërmjet qiellit dhe tokës.

Imam Neveviu thotë: “Ndoshta kjo fjalë e Profetit (a.s) mund të interpretohet, se në qoftë se shpërblimi i fjalës **Subhanall-lahi vel-hamdulil-lahi** do të merrte formën e një trupi, atëherë do ta mbushte hapësirën mes qiejve dhe Tokës. Shkak i këtij shpërblimi kaq të madh është përmbajtja shumë kuptimplotë e këtyre dy fjalëve, sepse kur muslimani thotë: **Subhanallah** e ka madhëruar Allahun dhe kur thotë **El-hamdulilah** e ka falendruar Atë”.¹

Subhanall-lahi dhe el-hamdu lil-lahi janë shprehje dhikri, të cilat kanë shpërblime të mëdha. Këta dy shprehje nënkuptojnë lavdërim, falënderim dhe madhështim të Krijuesit. Nëse njeriu i përkushtohet ibadetit të Krijuesit, Furnizuesit, çlirohet nga dënimi i Allahut. Nëse i përkushtohet nefsit, e humbet veten.

Namazi është dritë. Namazi është dritë që ndriçon zemrën, kthjellon mendjen, pastron shpirtin etj.

Nuk ka përshkrim më të bukur, se përshkrimi që i bën Profeti (a.s) namazit, duke e përshkruar atë si dritë; dritë në këtë botë dhe dritë që ndriçon errësirat në Ditën e Gjykimit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush është i kujdesshëm ndaj namazit, ai do të jetë dritë, argument dhe shpëtim për të në Ditën e Kiamatit...”.²

1. Kannca & Polen Yayınları, Sahih-i Müslim Serhi el-Minhac, 2/408.

2. Ahmedi në Musned, 2/169.

Sadakaja (lëmosha) është dëshmi (e besimit). Sadakaja është argument për sinqeritetin e besimit dhe argument për shfrytëzimin e pasurisë në punë të dobishme. Ditën e Gjykimit, gjithsecili do të pyetet: “Ku e ke fituar dhe ku e ke shfrytëzuar pasurinë?”³

A je në tregun e dhënies apo vetëm në tregun e marrjes dhe të shfrytëzimit?

Durimi është shkëlqim. Të gjitha virtytet dhe punët e mira ndërtohen mbi durimin. Durimi i qartëson gjërat. Durimi është ndriçim dhe udhëzim për:

- a. qëndrueshmërinë në adhurim, qëndrueshmërinë në parimet e Kuranit dhe Sunetit.
- b. vetpërbajtjen dhe kontrollin ndaj haramit.
- c. dorëzimin para caktimit të Allahut gjatë fatkeqësive.

Durimi e ndriçon njeriun atëherë kur mbi të zbrezin vështirësit dhe brengat. Nëse njeriu bën durim, atëherë ky durim do jetë për të dritë që e udhëzon për tek e vërteta.

Ndërsa Kurani është dëshmi e sigurt për ty ose kundër teje. Kjo shprehje e Profetit (a.s) e vendos muslimanin përpara një përgjegjësie shumë të madhe. Nëse muslimani i ka kryer mësimet dhe udhëzimet e Kuranit, atëherë Kurani do të jetë dëshmi pro tij në Ditën e Gjykimit. Por nëse muslimani nuk i ka kryer mësimet dhe udhëzimet e Tij, atëherë ky Libër i Shenjtë do të dëshmojë kundra tij në Ditën e Gjykimit. Kurani është fjala e Allahut drejtuar besimtarëve. Çdo muslimani i kërkohet që të besojë në Kuran, ta lexojë atë, të përpiket për ta kuptuar, të veprojë në përputhje me udhëzimet e tij, të transmetojë mësimet e tij.

Fundi i këtij hadithi e vendos njeriun përballë dy alternativave; ose t’ia shesë shpirtin Allahut dhe kështu ai shpëton dhe e çliron atë, ose mund të zgjedhë rrugën e shkatërrimit të vetvetes.

Çdo njeri e fillon ditën e tij duke qenë tregtar i vetes së vet: ai mund ta çlirojë veten e tij (nga zjarri) ose mund ta shkatërrojë atë (në zjarr).⁴

Ky hadith duhet që të na vetdijësojë që të gjitha veprimet, angazhimet, përpjekjet tona madje e gjithë jeta jonë duhet të jetë e ekspozuar në tregun e ahiretit.

Ibn Hazmi (rahimehullah) ka thënë: “Mos lejo që çmimi i jetës tënde të jetë më ultë se xheneti”.

3. Tirmidhiu, 2416.

4. Muslimi, 223. Tirmidhiu, 3517. Ahmedi, 5/342.

Tregohet se në kohën e Ebu Bekrit (r.a) Medinen e kaploi një thatësi dhe një krizë e madhe. Njerëzit shkuan dhe ju ankuan halifes për gjendjen e tyre, ndërsa ai u tha: “Shpresoj që Allahu (xh.sh) deri në fund të ditës do të na sjellë një zgjidhje”. Në fund të ditës arriti karvani i Othmanit (r.a) me njëqind deve nga Shami. Tregtarët e asaj kohe menjëherë shkuan te Othmani (r.a) dhe i thanë: “Do të japim dy dirhem për atë që ti e ke paguar me një, vetëm na e shit mallin e këtij karvani! Ai u tha: Dikush më jep më tepër sesa ju. Ata i thanë: “Do të japim 3, 4, 5 dirhem. Othmani (r.a) u thoshte: Dikush më jep më tepër sesa ju. Tregtarët i thanë: Ne nuk mund të të japim më shumë se 7 dirhem. Othmani (r.a) u tha se mallin do t’ia jap atij që jep më shumë sesa ju. Tregtarët i thanë: Ne nuk dimë ndonjë tregtar që mund të të japë më tepër nga ajo që ne të ofruam!? Atëherë Othmani (r.a) u tha: “Allahu është Ai që jep më tepër sesa ju! Ai për një dirhem më jep dhjetë deri në shtatëqindfish e më tepër! ⁵ O tregtarë, jini dëshmitarë se karvanin tim me gjithë ç’ka ka do ta shpërndaj sadaka për muslimanët fukara të Medines.” Othmani (r.a) me këtë veprim dëshiroi që të rriste pazarin e ahiretit tek njerëzit.

Prandaj të shikojmë se në çfarë tregut po shitemi kush po na jep më shumë? Mos harro se gjithmonë Allahu i Madhëruar të paguan më shumë se çdokush tjetër. Allahu (xh.sh) thotë:

“Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasuritë e tyre, në këmbim të Xhenetit”. ⁶

DISA MËSIMET QË NXJERRIM NGA KY HADITH:

1. Vlera e pastërtisë.
2. Vlera e falenderimit dhe lavdërimit të Allahut.
3. Vlera e namazit.
4. Vlera e sadekasë.
5. Vlera e durimit.
6. Vlera e zbatimit të Kuranit dhe rrezikshmëria e moszbatimit të Tij.
7. Motivimi dhe qortimi.
8. Dhënia e shembujve.
9. Vlera e punëve të mira.
10. Nxitja për të bërë punë të dobishme.

5. Ebu Hurejra (r.a) tregon se i Dërguari i Allahut (a.s) ka rrëfyer: “Allahu (xh.sh) thotë: Në qoftë se robi im bën një vepër të mirë, atëherë ia shkruan atë me vlerë nga dhjetë deri në shtatëqindfish më të madhe”. (Buhariu, 1057). Kufiri minimal i shpërblimit të Allahut është dhjetëfishi i veprës. Veprat mund të shpërblehen deri në shtatëqindfish, por edhe më shumë, në varësi të sinqeritetit.

6. Et-Teube, 111.

Si e ndryshuan botën PATATET?

Kur lulëzojnë bimët e patates, fushat duken sikur janë plot me yje të purpurt. Mesa duket Marie Antoinette-s i kanë pëlqyer aq shumë lulet, sa që i ka vënë në flokë.

Ato i vendosi edhe bashkëshorti i saj, mbreti Louis XVI i Francës, duke filluar një trend në mesin e aristokracisë franceze për të dekoruar rrobat e tyre me lule patate. Ishte një përpjekje për të bindur fermerët francezë të mbjellin dhe restorantet franceze për të shërbyer këtë lloj të ri të çuditshëm ushqimi.

Sot, patatet janë kultura e pestë më e rëndësishme në botë, pas grurit, misrit, orizit dhe kallam sheqerit. Por në shekullin e XVIII-të ky zhardhok ishte një risi befasuese, për disa e frikshme, për të tjerët konfuze – pjesë e konvulsionit ekologjik global të nisur nga Christopher Columbus.

Udhëtimet e Kolombit çuan në faktin se ekosistemet e veçanta të botës përzihen papritur në një kërcim biologjik, i cili është sfondi i pjesës më të madhe të historisë që mësojmë në shkollë. Krahasuar me drithërat, zhardhokët janë në thelb më produktivë. Nëse koka e një bime gruri ose orizi rritet shumë, bima do të bjerë dhe do të thahet. Duke u rritur nën tokë, zhardhokët nuk kufizohen nga pjesa tjetër e bimës. Në vitin 2008, një fermer libanez nxori një patate që peshonte gati 12 kilogramë. Ishte më e madhe se koka e tij, shkruan smithsonianmagazine.

Shumë studiues besojnë se ardhja e patates në Evropën veriore nënkuptonte fundin e urisë. Misri, një tjetër kulturë amerikane, luajti një rol të ngjashëm, por më të vogël në Evropën Jugore. Siç ka argumentuar historiani William H. McNeill, patatja dërgoi në ngritjen e perandorive evropiane “Duke ushqyer popullsitë në rritje të shpejtë, patatja u mundësoi kombeve evropiane të vendosnin dominimin mbi pjesën më të madhe të botës midis viteve 1750 dhe 1950”.

Me fjalë të tjera, patatja nxiti ngritjen e Perëndimit.

PELTE ME PATATE

Po kështu, pranimi i patates në Evropë dhe Amerikën e Veriut vendosi shabllonin për bujqësinë moderne – të ashtuquajturin kompleks agro-industrial. Me patatet, plehrat e parë intensive në botë – guano peruane – doli përtej Atlantikut. Dhe kur patatet u sulmuan nga një tjetër i sapoardhur – plaga e patates, fermerët në panik iu drejtuan pesticidit të parë artificial – një përbërje arseniku.

Konkurrenca për prodhimin e përzierjeve gjithnjë e më të fuqishme të arsenikut nisi industrinë moderne të pesticideve. Në vitet 1940 dhe 1950, të korrat e përmirësuara, plehra me intensitet të lartë dhe pesticidet kimike ndezën Revolucionin e Gjelbër, një shpërthim i produktivitetit bujqësor që

transformoi fermat nga Illinois në Indonezi.

Merita më e madhe për zhvillimin dhe përhapjen e patates sigurisht që u takon popujve të Andeve. Duke folur gjeografikisht, Andet janë një vendlindje e pamundur për të korrat kryesore. Zinxhiri më i gjatë malor në planet formon një pengesë akulli në bregun e Paqësorit të Amerikës së Jugut, 8,800 kilometra i gjatë dhe në shumë vende më të larta se 6,000 metra. Vullkanet aktive të shpërndara përgjatë zinxhirit lidhen me defekte gjeologjike, të cilat shtyhen kundër njëri-tjetrit dhe shkaktojnë tërmete, përmbytje dhe rrëshqitje të dheut. Edhe kur vendi është sizmik i qetë, klima e Andeve është aktive.

Temperaturat në male mund të ndryshojnë me 30 gradë Celsius në disa orë, sepse ajri është shumë i hollë për të mbajtur nxehtësinë.

Një nga traditat kulturore më të mëdha botërore doli nga ky terren jopremtues. Ndërsa egjiptianët po ndërtonin piramidat, Andet po ndërtonin tempujt e tyre monumentalë dhe sheshet ceremoniale. Për mijëra vjet, popujt grindavec kanë luftuar për pushtet nga Ekuadori në Kilin verior. Më të famshmit sot janë inkasit, të cilët morën pjesën më të madhe të Andeve në një pushtim të dhunshëm, ndërtuan autostrada të mëdha dhe qytete që shkëlqenin me ar, dhe më pas u shembën për shkak të sëmundjes spanjolle dhe ushtarëve spanjollë. Kulturat malore ishin jashtëzakonisht të ndryshme nga njëra-tjetra, por të gjitha ushqeheshin me kultura tuberoze dhe rrënjë, më e rëndësishmja prej të cilave ishte patatja.

PATATE TË EGRA

Patatet e egra janë të mbushura me solaninë dhe domatinë, përbërës helmues që besohet se mbrojnë bimët nga sulmet e organizmave të rrezikshëm si kërpudhat, bakteret dhe njerëzit. Gatimi shpesh thyen mbrojtje të tilla kimike, por solanina dhe domatina nuk ndikohen nga nxehtësia.

Toksinat ngjiten në grimcat e imta të argjilës në stomakun e kafshës, duke kaluar nëpër sistemin tretës pa e ndikuar atë. Duke imituar këtë proces, popujt malësorë me sa duket mësuuan të zhysin patatet e egra në një "salcë" të bërë nga balta dhe uji. Ata përfundimisht edukuan patate më pak helmuese, megjithëse disa nga varietetet e vjetra, helmuese mbetën të njohura për shkak të rezistencës së tyre ndaj ngricave. Pluhuri i argjilës shitet ende në tregjet peruane dhe boliviane si shtesë për patatet, transmeton Telegrafi.

Edhe sot, disa fshatarë Ande përgatisin patatet në të njëjtën mënyrë si paraardhësit e tyre. Menjëherë pas gërmimit të patateve nga toka, familjet në fusha përdorin furra dheu, rreth gjysmë metri të lartë. Furrat futen në kërcell, si dhe në kashtë, shkurre, mbeturina druri dhe bajgë lope. Kur furrat zbardhen nga zjarri, kuzhinierët vendosin mbi hi patate të freskëta për pjekje. Avulli nga ushqimi i nxehtë rrotullohet në ajrin e pastër dhe të freskët. Njerëzit i zhysin patatet e tyre në kripë të trashë dhe argjilë të ngrënshme.

Patatet e Andeve të pjekura para kontaktit me evropianët nuk ishin patate moderne. Varietetet e



ndryshme u rritën në lartësi të ndryshme. Rezultati ishte një shumëllojshmëri kaotike. Patatet në një fshat në një lartësi mund të duken krejtësisht të ndryshme nga patatet në një fshat tjetër në një lartësi tjetër. Qendra Ndërkombëtare e Patates në Peru ka ruajtur pothuajse 5000 varietete.

RRITJA E PATATEVE

Spanjollët e parë mbërritën në këtë zonë në 1532, të udhëhequr nga Francisco Pizarro. Ata vunë re se indianët po hanin këto objekte të çuditshme, të rrumbullakëta dhe i imituan ato, megjithëse shpesh me ngurrim. Lajmet për ushqimin e ri u përhapën shpejt. Brenda tre dekadave, fermerët spanjollë po eksportonin patate në Francë dhe Holandë. Përshkrimi i parë shkencor i patates u shfaq në vitin 1596, kur natyralisti zviceran Gaspard Bauhin e quajti atë *Solanum tuberosum esculentum*.

Ndryshe nga çdo plantacion i mëparshëm evropian, patatet nuk rriten nga farat, por nga copa të vogla zhardhokësh – të quajtur gabim “patate farore”. Fermerët kontinental e shihnin këtë ushqim me dyshim; disa e konsideronin atë si afrodiziak, të tjerë shkaktar të etheve ose lebrës.

Me një mbështetje kaq të vakët, patatet përhapen ngadalë. Kur uria goditi Prusinë në 1744, Mbreti Frederiku i Madh, një dashnor i patates, duhej të urdhëronte fshatarësinë të hanin zhardhokët. Në Angli, fermerët në shekullin e XVIII-të e shënuan pataten si një paraardhëse të katolicizmit të urryer romak. “Pa patate të skuqura, pa pop!” ishte slogani zgjedhor në 1765.

Franca ishte veçanërisht e ngadaltë në adoptimin e patateve. Dhe pastaj u shfaq farmacisti Antoine-Augustin Parmentier. Ai shërbeu në ushtri gjatë Luftës Shtatëvjeçare dhe u kap pesë herë nga prusianët. Gjatë qëndrimit të tij të shumëfishtë në burg, ai hëngri vetëm patate, të cilat e mbajtën atë në gjendje të mirë shëndetësore. Befasia e tij për këtë rezultat e bëri atë të bëhej një pionier ushqimor pas përfundimit të luftës. Ai ia kushtoi pjesën tjetër të jetës promovimit të patateve.

Koha e Parmentierit ishte e mirë. Pas Louis XVI-të i kurorëzuar në 1775, ai hoqi kontrollin e çmimeve të grurit. Çmimet e bukës u rritën, duke shkaktuar trazira civile në 82 qytete franceze. Parmentier vuri në dukje pa u lodhur se Franca do të pushonte së luftuari për bukën nëse qytetarët e saj do të hanin patate. Në të njëjtën kohë, ai përdorte truket reklamuese. Ai përgatiti një darkë të bërë tërësisht me patate për mysafirët e shoqërisë së lartë. Historia thotë se Thomas Jefferson, një nga të ftuarit, ishte



aq i kënaqur sa solli patate të skuqura në Amerikë. Thuhet se Parmentier e bindi mbretin dhe mbretëreshën të vishnin lule patate. Në periferi të Parisit, ai mbollti 40 hektarë patate, duke e ditur se njerëzit e thjeshtë të uritur do t'i vidhnin.

PARMENTIER PA E DITUR I NDRYSHOI PATATET

Duke promovuar pataten, Parmentier padashur e ndryshoi atë. Të gjitha patatet evropiane e kanë origjinën nga disa zhardhokë të dërguar përtej oqeanit nga spanjollët kureshtarë. Kur fermerët mbjellin copa zhardhokësh në vend të farave, bimët që rezultojnë janë klone. Duke inkurajuar kultivimin masiv të patateve, Parmentier padashur promovoi



idenë e mbjelljes së zonave të gjera me klon – një monokulturë e vërtetë.

Efektet e këtij transformimi ishin vërtet mbresëlënëse dhe ndryshuan historinë e Evropës. Uria ishte një dukuri e zakonshme në Evropë në shekujt 17 dhe 18. Qytetet ishin kryesisht të furnizuara relativisht mirë, por fshatarët jetonin në varfëri. Franca pati 40 zi buke në të gjithë vendin midis viteve 1500 dhe 1800. Anglia pati 17 zi buke kombëtare dhe të mëdha rajonale ndërmjet viteve 1523 dhe 1623. Kontinenti thjesht nuk mund të ushqej në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Patatja ndryshoi gjithçka. Tani pronarët e vegjël mund të rritnin patate edhe në tokë djerrinë. Për shkak se patatja ishte shumë produktive, rezultati

për sa i përket kalorive ishte një dyfishim i furnizimit me ushqim në Evropë. Nga fundi i shekullit të XVIII-të, patatet ishin bërë në pjesën më të madhe të Evropës ajo që kishin qenë në Ande – një ushqim kryesor. Përafërsisht 40 për qind e irlandezëve në atë kohë hanin vetëm patate. Uria ishte zhdukur plotësisht në një zonë që shtrihej nga Irlanda në perëndim deri në Uralet ruse në lindje.

Para shfaqjes së patateve dhe misrit dhe para plehërimit intensiv, standardi evropian i jetesës ishte afërsisht i barabartë me Kamerunin dhe Bangladeshin e sotëm. Mesatarisht, fshatarët evropianë hanin më pak në ditë sesa komunitetet e gjuetarëve- mbledhësve në Afrikë ose në Amazonë. Monokultura industriale lejoi miliarda njerëz të shpëtonin nga varfëria. Revolucioni i nisur nga patatet, misri dhe plehurat, bëri të mundur dyfishimin ose trefishimin e standardit të jetesës në të gjithë botën, kështu që numri i banorëve të Tokës u rrit nga më pak se një miliard në 1700 në 7.7 miliardë të sotëm.

NJË ZBULIM I RI

Nëse arseniku vret brumbujt e patates, pse të mos e provoni në dëmtuesit e tjerë? Në mesin e viteve 1880, një studiues francez zbuloi se spërkatja me një tretësirë të sulfatit të bakrit dhe gëlqeres largoi gjithashtu mykun e ujit. Kështu filloi industria moderne e pesticideve.

Megjithatë, qysh në vitin 1912, plaga e patates filloi të shfaqte shenja imuniteti ndaj pesticideve të mëparshme. Fermerët nuk e vunë re sepse industria e pesticideve vazhdonte të dilte me komponime të reja arseniku që vrisnin brumbujt e patates. Nga vitet 1940, kultivuesit në Long Island zbuluan se duhej të përdornin sasi në rritje të arsenatit të kaliumit. Pas Luftës së Dytë Botërore, një lloj pesticidi krejtësisht i ri – DDT – hyri në përdorim të gjerë. Fermerët blenë DDT dhe u gëzuan për zhdukjen e insekteve nga fushat e tyre. Ajo u përshtat brenda shtatë viteve. Kultivuesit e patates po kërkonin kimikate të reja.

Kultivuesit e patates tani i trajtojnë të korrat e tyre një duzinë ose më shumë herë në sezon me një koktej substancash vdekjeprurëse që ndryshon vazhdimisht. Përkundër kësaj, dëmtuesit vazhdojnë të kthehen. Studiuesit u tmerruan në vitet '80 kur zbuluan se llojet e reja të mykut kishin gjetur rrugën e tyre drejt Evropës dhe Amerikës. Ato ishin më virulente dhe rezistente ndaj metalaksilit, aktualisht trajtimi kryesor kundër mykut të ujit. Një zëvendësues i mirë nuk është shfaqur ende.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar


5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Ai ua pranoi pendimin
edhe atyre të treve,
që mbetën prapa atëherë,
kur toka, sado e gjerë,
iu duk e ngushtë dhe
iu shtrënguan shpirtrat,
aq sa u bindën
se nuk ka strehim tjetër
përveç Allahut e pastaj
Allahu u dha mëshirë
që të pendohen. Me të vërtetë,
Allahu pranon pendimin
dhe është Mëshirëplotë.”

(Teube, 118)